



**PËRMBLEDHJE E
VENDIMEVE TË
KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

2022

PËRMBAJTJA

I.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS.....	6
1.	A.R., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë 6	
2.	Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, kundër Bashkisë Elbasan	8
3.	Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, kundër opinionistit A.M., në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga A.D., në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus	10
II.	ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE	13
4.	S.S., kundër Njesisë së Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Fier	13
5.	P.P., kundër Bashkisë së Vau i Dejës	15
6.	A.A., kundër Bashkisë Shkodër	17
7.	M.D., kundër Bashkisë Mat	20
8.	F.O., kundër Bashkisë Kukës.....	23
9.	E.H., kundër Bashkisë Kamëz	26
10.	A.V., kundër Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat (NJVKSH Berat)	29
11.	V.M., kundër Bashkisë Mat	31
12.	D.N., kundër Bashkisë Vau Dejës.....	34
13.	K.K., kundër Bashkisë Berat.....	36
14.	A.T., kundër Bashkisë Kavajë.....	39
15.	Gj.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.	41
16.	Z.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.	45
17.	J.A., kundër Bashkisë Devoll.....	47
18.	J.K., kundër Bashkisë Mat	49
19.	A.L., kundër Bashkisë Lezhë	51
20.	K.K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.....	52
21.	D.B., kundër Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit	54
22.	A.K., kundër OSHEE sh.a.....	57
23.	F.J., kundër Bashkisë Vau i Dejës dhe Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.	60
24.	D.K., kundër Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njesisë Administrative Lis.....	63
25.	T.M., kundër Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., (OSSH sh.a.).....	67

III.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL	71
26.	J.M., kundër Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., dhe P.K., Team Leader pranë Shoqërisë Fiber Group sh.p.k.....	71
IV.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE	75
27.	Qendra “T’Reja” kundër Këshillit të Ministrave	75
28.	T.B., kundër Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a.	78
V.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË	83
29.	Zh.L., kundër shtetasit O.J.	83
30.	XH.B., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH)	85
VI.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS	88
31.	N.Sh., kundër Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Fier.....	88
32.	J.L., kundër Ministrisë së Brendshme	91
VII.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJES FETARE.....	94
33.	I.B., kundër Shkollës Jo Publike Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër	94
VIII.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE	98
34.	O.K., kundër E.B., Drejtore pranë Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë.....	98
35.	A.P., kundër Akademisë së Sigurisë	101
IX.	ÇËSHËTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR	105
36.	A.Z., kundër Shkollës së Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër	105
37.	Fondacioni “Së bashku” kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale....	109
38.	Fondacioni “Së bashku” kundër Bashkisë Kavajë	112
39.	Fondacioni “Së bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Hardhisht)	116
40.	Fondacioni “Së bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Qendër Durrës) 120	
41.	Fondacioni “Së bashku” kundër Bashkisë Durrës, Bashkisë Shijak, Bashkisë Krujë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).....	123
42.	Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë kundër Bashkisë Tiranë	127
43.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP)	130
44.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Bashkisë Shijak	133

45.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Njësisë Administrative Sukth.....	135
46.	E.L., kundër Shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako”, Divjakë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Divjakë (ZVAP Divjakë).....	138
47.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz	140
48.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a.	143
49.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë.....	145
50.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë.....	147
51.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës Postare Kamëz	150
X.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR.....	154
52.	A.B., kundër E.H., Drejtore e Shkollës 9 vjeçare Dora D’Istria, Tiranë.....	154
53.	E.H., kundër Urdhrit të Psikologut (UP).....	157
54.	K.F., kundër Ministrisë së Mbrojtjes (MM).....	162
55.	L.D., kundër Drejtorit të Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina”, Lushnje...	166
XI.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN E SHUMEFISHTË DHE NDËRSEKTORIALE	170
56.	P.B., kundër Bashkisë Tiranë.....	170
57.	M.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a	173
58.	F.N., kundër Shoqërisë “Albcontrol” sh.a.....	177
59.	A.F., kundër Shoqërisë “Albcontrol” sh.a.....	181
60.	Z.Ll., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a	186
61.	36 familjet që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane të qytetit të Kavajës, të cilët përfaqësohen nga Shoqata “Drejtësi Sociale”, kundër Bashkisë Kavajë.....	189
62.	B.K., kundër Bashkisë Berat.	192
63.	M.N., kundër Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit të Bashkisë Tiranë	196
XII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË.....	199
64.	F.K., kundër Universitetit të Mjekësisë Tiranë.....	199

Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit nr.10221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrijnë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që ti shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për ta udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që ta japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen *web* të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendimarrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit. Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

PhD Robert Gajda

I. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS¹

1. A.R., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë

VENDIM NR. 103, DATË 07.06.2022

Shkaku: Etnia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me punonjës të tjerë (kolegë të tij), gjatë marrëdhënieve të punës, duke e vënë në pozita diskriminuese për shkak të etnisë.

FAKTET

Ankuesi, në vitin 2015, ka lidhur marrëdhëniet financiare të punësimit me Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 2 të Qytetit, Bashkia Tiranë, në pozicionin e punës “Punëtor zgarash”. Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Qytetit, ka ndryshuar emërtesën dhe strukturën duke u ndryshuar në Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (në vijim DPRRNP).

Në ambientet e punës, gjatë një kontrolli të ushtruar nga punëdhënësi, punëtorët I.Xh., R.R., S.B., dhe ankuesi janë gjendur nga punëdhënësi duke luajtur. Menjëherë nga punëdhënësi kanë nisur propozimet për fillimin e procedurave disiplinore për punonjësit e sipërpërmendur. Nga ana e punëdhënësit të tij, është pretenduar se ankuesi kishte shkelur detyrimet kontraktuale për shkak të thyerjes së përsëritur të disiplinës në punë dhe braktisjes së vendit të punës, duke e justifikuar me faktin se brenda një afati 6-mujor, ndaj tij është marrë masa disiplinore e mëparshme “Vërejtje”, si dhe ai ka munguar në punë.

Edhe pse ai ka qenë në të njëjtat kushte me kolegët, vetëm ndaj tij është marrë masa disiplinore e largimit nga puna, kur nga aktet dhe provat e administruara nuk rezulton në asnjë moment që ai të ketë qenë i vetmi punonjës i gjetur në shkelje.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

¹ Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI (2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b)).

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar faktit se procedimi disiplinor, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, ka nisur vetëm ndaj subjektit ankues, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, ndodhej në kushtet që kishte barrën e provës të provonte se trajtimi i diferencuar i konstatuar më sipër, nuk është diskriminues. Ndërkohë, për të justifikuar trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik pretendoi se shkak i largimit nga puna të ankuesit ka qenë thyerja e përsëritur e disiplinës dhe braktisja e vendit të punës.

Duke qenë se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është vlerësuar se shkelja e kryer nuk ka qenë e një niveli të rëndë sa për të iniciuar një ecuri disiplinore edhe për punonjësit/kolegët e ankuesit, mund të ishte mbajtur në vëmendje ky trajtim edhe për A.R.. Pavarësisht këtij fakti, shkelja është konsideruar vetëm për ankuesin si e rëndë në rastin konkret, ndërsa për kolegët e tij, nuk është konsideruar si e tillë. Komisioneri vlerësoi se, sa kohë punëdhënësi nuk filloi ecuri disiplinore kundrejt tre punonjësve të tjerë, shkelja e konstatuar nuk ka qenë e një niveli të tillë sa të justifikonte ndërmarrjen e procedurave disiplinore përkatëse. Kjo qasje e aplikuar ndaj tre punonjësve nuk është zbatuar në të njëjtën mënyrë edhe ndaj ankuesit. Pra, në të njëjtën situatë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është mbajtur një qëndrim i ndryshëm.

Siç u konstatua nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, krahasuar me kolegët e tij, i kanë ardhur vetëm subjektit ankues.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se A.R., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, trajtim i cili ka ardhur si pasojë përkatësisë së tij në minoritetin egjiptian.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit A.R., në të drejtën për punësim, për shkak të etnisë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë.

2. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, kundër Bashkisë Elbasan

VENDIM NR. 214, DATË 07.12.2022

Shkaku: Etnia dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Fëmijët që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian janë diskriminuar nga ana e Bashkisë Elbasan përmes mosveprimit për miratimin e përgjashtimit nga pagesa e kopshteve dhe çerdheve me drekë, për shkak të etnisë dhe gjendjes ekonomike.

FAKTET

Organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome” (LRER) në funksion të aktivitetit të saj mbështet dhe nxit fëmijët e minoritetit rom dhe egjiptian të ndjekin arsimin parashkollor.

LRER, ka orientuar rreth 25 fëmijë të regjistruhen në kopshtet publike në Bashkinë Elbasan, mirëpo ata janë përballur me kërkesën e kopshteve respektive për kryerjen e pagesës së përcaktuar nga Bashkia.

Bashkia Elbasan, nuk është ndërmarrë një veprim konkret, ndërkohë që prindërit e fëmijëve janë duke u përballur me pamundësinë financiare për pagesën e tarifës për regjistrimin në kopshte dhe çerdhe me drekë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, e ratifikuar nga Shqipëria me Ligji Nr. 7531/1991, datë 11 Dhjetor 1991;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e ratifikuar nga Shqipëria me Ligji Nr. 7768, datë 09 Nëntor 1993;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015;
- Plan i ri Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve² (2021–2025);
- Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan.

² Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.11.2021.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak Elbasan nuk kanë parashikuar si një kategori përfituese, kategorinë e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, për përshtimin nga tarifat e regjistrimit në kopshte dhe çerdhe me drekë, bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare, duke i vënë këta të fundit në kushte të pabarabarta dhe të pafavorshme në raport me kategori të tjera të cilat nuk ndodhen në të njëjtat kushte.

KMD vlerësoi se Bashkia Elbasan ka diskriminuar kategorinë e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, duke dështuar të krijojë përjashtim nga rregulli për fëmijët rom dhe egjiptian edhe pse është në dijeni të situatës aktuale të këtyre komuniteteve si dhe është angazhuar për integrimin e këtyre komuniteteve bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se praktika e ndjekur nga Bashkia Elbasan, duke mos përfshirë si kategori të veçantë rregjistrimin në kopshte të fëmijëve të komunitetin rom dhe egjiptian, i ka trajtuar të gjitha familjet njëjloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të etnisë³ dhe gjendjes ekonomike, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së arsimit të fëmijëve të familjeve të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të etnisë dhe gjendjes ekonomike, të kategorisë së fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, nga ana e Bashkisë Elbasan.
- Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, Bashkia Elbasan, të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, si kategori që përfiton rregjistrimin në kopshte (me apo pa drekë) pa pagesë.

³ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

3. Rrjeti i Organizatave R/E, Korçë, kundër opinionistit A.M., në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga A.D., në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus

VENDIM NR. 100, DATË 23.05.2022

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Gjuhë urrejtje
Statusi: Plotësuar nga Televizioni Vizion Plus, Gjobë për A.M., në gjykatë

Opinionisti A.M., ka përdorur gjuhë urrejtje ndaj komunitetit rom dhe Komisioneri ka konstatuar diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të racës, të komunitetit rom si dhe diskriminim nga Televizioni Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga A.M., në emisionin *Spot LIGHT*, për mosdistancimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në titullin e emisionit *Spot LIGHT*, të publikuar në faqen www.youtube.com.

FAKTET

Rezulton se në datën 21.01.2022, në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga A.D., në Televizionin Vizion Plus, gjatë diskutimeve të zhvilluara në studio, opinionisti A.M., ka përdorur shprehjen “*si arrixhinjtë në rrugë me trastën në kurriz*” duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Redaksia e emisionit i ka vënë titullin “*Spotlight - Shpërthen A.M.: Grupi i Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, lajmit të hedhur në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>.

Rrjeti i Organizatave R/E në qytetin e Korçës shprehen indinjatën e thellë për këtë shprehje të përdorur nga opinionisti A.M., pasi dëmton imazhin e komunitetit rom dhe e diskriminon hapur këtë pakicë kombëtare.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015, i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës;
- *Féret k. Belgjikës*, (2007) dhe *Vejdeland dhe Të Tjerë k. Suedisë*, (2012), *Garaudy kundër Francës*, (2003);
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizën që KMD i ka bërë gjuhës së përdorur në Emisionin *Spot Light*, ka vlerësuar se përdorimi i saj konsiderohet në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë kontekst, KMD i është referuar kufizimeve që parashikon KEDNJ për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çënojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se “fjalimet e urrejtjes” kundër personave që i përkasin komunitetit rom, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të bëra publike nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtij komuniteti. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Komisioneri është i vetëdijshëm se, liria e fjalës në median kombëtare televizive është e një rëndësie të veçantë, por, rëndësia që merr liria e fjalës e ngarkon këtë media me një përgjegjësi akoma më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin ndaj pakicave të caktuara kombëtare. (*shih Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ*).

Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit nëse shprehja e përdorur nga ana e A.M., në emisionin *Spot LIGHT*, mund të mos ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes apo diskriminimin e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, të gjithë anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotype negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Komisioneri thekson faktin se Televizioni Vizion Plus ka përforcuar dhe vijimësuar diskriminimin, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes së pakicës kombëtare romë, duke mosmbajtur një qëndrim kritik ndaj përdorimit të shprehjes së opinionistit, as gjatë emisionit dhe as në vijim të tij, për t’u distancuar nga sa më sipër.

Përpos kësaj, ky televizion ka përforcuar diskriminimin ndaj këtij komuniteti, duke publikuar në faqen Youtube, emisionin *Spot LIGHT* dhe duke i vënë si titull shprehjen e përdorur nga ana e z.

A.M. Pozita e këtij subjekti rëndohet gjithashtu, pasi ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionerin, duke mos dhënë prapësimet e tij lidhur me sa më sipër, në kushtet kur në bazë të nenit 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, ka patur barrën e provës në këtë proces hetimi administrativ.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e A.M., si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emissionin *Spot LIGHT*, të datës 21.01.2022, në televizionin Vizion Plus.
- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e Televizionit Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga A.M., në emisionin *Spot LIGHT*, për mosdistancimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në titullin e emisionit *Spot LIGHT*, të publikuar në faqen www.youtube.com.
- Referuar pikave 1 dhe 2 të këtij Vendimi, A.M., dhe Televizioni Vizion Plus të shprehen me deklaratë publike (verbale apo të shkruara) me anë të së cilave të kërkojnë falje ndaj pakicës kombëtare rome.
- Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Vizion Plus të marrë masa të menjëherëshme për të ndryshuar titullin e emisionit *Spot LIGHT*, të datës 21.01.2022, si dhe eliminimin/mbulimin e frazës diskriminuese të përdorur nga A.M., në përmbajtjen e këtij emisioni, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijeni mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome.

II. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

4. S.S., kundër Njësisë së Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Fier

VENDIM NR. 108, DATË 07.06.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Veprimet dhe mosveprimet e pushtetit lokal ndaj fatkeqësisë së ndodhur ankuesit e kanë vënë atë në pozita të pafavorshme dhe diskriminuese që kanë lidhje me bindjen e tij politike.

FAKTET

Në datën 13.11.2020, rreth orës 18:20, banesa e ankuesit, një shtëpi dykatëshe e ndërtuar me gurë, e ndodhur në fshatin Gorishovë, në Njësinë Administrative Cakran, është djegur. S.S., sqaron se pavarësisht se u lajmërua zjarrfikësja, si pasojë e largësisë dhe konstruksionit të brendshëm të banesës, shtëpia është shkruar tërësisht dhe veç saj ankuesi pretendon se janë djegur edhe 500.000 lekë që i ndodheshin në banesë.

Një ditë më pas, përkatësisht në datën 14.11.2020, pranë banesës së djegur janë paraqitur oficerë të policisë gjyqësore Fier, për kqyrjen e vendit të ngjarjes, ndërkohë që S.S., thekson faktin se asnjë përfaqësues i pushtetit vendor nga Njësia e Emergjencave Civile nuk u është gjendur pranë familjes së tij në këtë fatkeqësi. Në këto kushte në datën 17.11.2020, është paraqitur pranë Bashkisë Fier dhe ka depozituar një kërkesë me shkrim, nëpërmjet së cilës ka kërkuar ndihmë financiare për të përballuar këtë fatkeqësi, duke depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Në vijim, pranë banesës së tij është paraqitur një komision i kryesuar nga drejtuesi i Njësisë së Emergjencave Civile të Bashkisë Fier, me qëllim kryerjen e konstatimit të dëmeve të shkaktuara nga djegia e saj.

Drejtuesi i këtij komisioni i e ka pyetur se ku ndodheshin trarët e katit të dytë, tjegullat e dritaret e banesës, ndërkohë që ajo ishte e shkruar. S.S., sqaron se pyetjet e tij ishin fyese, çnjerëzore dhe diskriminuese dhe se ai i është përgjigjur se fjalët e tij po e cënonin më shumë se fatkeqësia e ndodhur.

Ankuesi ka bindje të djathta dhe është aktivist i forcës së djathtë, që nga fillimi i demokracisë e në vijimësi, deri në zgjedhjet kombëtare të datës 25.04.2021. Një fakt i tillë është i ditur nga njësia e qeverisjes vendore.

S.S., kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit të tij për shkakun e sipërcituar, apo edhe për çdo shkak tjetër që do të rezultojë si rrjedhim i hetimit administrativ të KMD-së, trajtimin e tij, në bazë të dispozitave të Vendimit Nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për

kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ngritjen e një komisioni tjetër për evidentimin, pasqyrimin dhe vlerësimin real të dëmeve të objektit, orendive dhe pajisjeve të tjera, si dhe dëmshpërblimin nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore, për raste të fatkeqësive të kësaj kategorie.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14, si dhe Protokolle 12 i saj);
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Bashkisë Fier, pasi nuk janë kryer verifikimet përkatëse nga ana e strukturave përgjegjëse të këtij institucioni, për sa i përket mosdakordësive të ankuesit ndaj procesverbalit të vlerësimit të dëmeve të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, si dhe nuk është vepruar për kryerje të rivlerësimit dhe rivlerësimit të objekteve dhe orendive në shtëpinë e djegur në 13.11.2020.

KMD ka konstatuar se Bashkia Fier nuk ka marrë asnjë masë për t’i dhënë ndihmë emergjence në strehim dhe ushqim, familjes së S.S., pas djegies së shtëpisë së tij edhe pse ekziston një detyrim i këtij institucioni në bazë të parashikimeve të VKM-së Nr. 329/2012.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, rezulton se S.S., është i angazhuar me strukturat e Partisë Republikane që në fillimet e saj dhe ka qenë mjaft aktiv në shpалosjen e programit të Partisë Republikane në çdo fushatë. Ka qenë pjesë e Komisioneve Zgjedhore si Komisioner”. Komisioneri çmoi se Bashkia Fier ka patur dijeni mbi përkatësinë politike të ankuesit, pasi fshati Gorishovë, i Njësisë Administrative Cakran, ka numër të vogël banorësh dhe banorët kanë dijeni mbi bindjet politike të njërës tjetrit, aq më tepër kur ankuesi është aktivist i hershëm i Partisë Republikane.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Bashkia Fier, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të bindjes politike ankuesin S.S.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të “bindjes politike” të S.S., nga ana Bashkisë Fier.

- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Fier të marrë të gjitha masat për ngritjen e një komisioni tjetër që të kryejë edhe një herë vlerësimin e banesës së shkatërruar nga djegia, në bashkëpunim me të dy familjet që kanë banuar në të.
- Komisioni i Vlerësimit të Dëmit të marrë të gjitha masat e nevojshme për verifikimin e të gjitha pretendimeve të S.S., lidhur me objektet, orenditë dhe materialet ndërtimore të banesës që rezultojnë të papërfshira në procesverbalin e konstatimit të dëmit të datës 24.11.2020.

5. P.P., kundër Bashkisë së Vau i Dejës

VENDIM NR. 15, DATË 13.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Vau i Dejës, në detyrën “Vrojtues në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”. Vetëm pak muaj pas ndërrimit të kryetarit të Bashkisë, atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Vau i Dejës për një periudhë 3 vjeçare, në detyrën “Vrojtues në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”.

Me ardhjen në detyrë të Kryetarit të ri të këtij Institucioni, ndaj tij është iniciuar procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Ankuesi nuk ka patur asnjë masë disiplinore apo vërejtje për mosrealizim detyrash apo ndonjë shkelje tjetër nga ana e punëdhënësit. Sjelljet diskriminuese kundrejt tij e kanë motivin tek bindjet e tij politike, pasi ka bindje të kundërta me ato të Kryetarit aktual të Bashkisë, ndërsa personalisht është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12 i saj;

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia/punëdhënësi, nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës. Bashkia nuk arriti të provojë para Komisionerit se, kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesin, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, apo që t’i kishte krijuar mundësinë këtij të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e tij të ligjshëm.

Komisioneri vlerëson se, shkaqet e shtuara në shpjegimet e sjella para KMD-së nga ana e Bashkisë, nuk janë cituar në asnjë nga shkresat në procedurën e ndjekur prej saj, për largimin e ankuesit nga puna. Ato janë shtuar si argumenta shtesë gjatë prapësimeve para Komisionerit, për rrjedhojë nuk mund të kenë shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna. Komisioneri vëren se, edhe për argumentat e përdorura nga Bashkia lidhur me pretendimin e saj për mospërbushje të detyrimeve të kontratës individuale nga ana e ankuesit, ajo nuk arriti të provojë apo dokumentajë me prova apo dokumentacion, se cilat detyra nuk kishte përbushur konkretisht, cilat ishin masat e ndërmarrë prej saj në kuadër të këtij konstatimi, apo që ndaj ankuesit të ishte ndërmarrë ndonjë masë disiplinore lidhur me këto pretendime.

Komisioneri vëren gjithashtu, se, nëse pretendimet e Bashkisë kundrejt ankuesit, lidhur me mosmarrjen e masave prej tij për ndalimin e aktivitetit të paligjshëm në zonat pyjore në ngarkim, duke cituar fenomenin e kultivimit të bimëve narkotike apo prerje të lëndës drusore pa leje; do të ishin të drejta dhe të faktuara, atëherë vetë Bashkia, do të duhej që të kishte ndërmarrë veprime konkrete, kryesisht, lidhur me raportimin e këtij fakti në organet kompetente përgjegjëse, pasi lejimi i kultivimit të bimëve narkotike apo prerje të lëndës drusore pa leje, përbëjnë elementë të veprës penale dhe do të duhej të hetoheshin nga organet përkatëse.

Bashkia jo vetëm që nuk ka vepruar lidhur me sa më lart, por nuk ka dokumentuar as të ketë ndjekur ndonjë procedurë administrative lidhur me dhënien e ndonjë mase kundrejt ankuesit për moszbatim të detyrave të tij funksionale.

Rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike.

Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar, aktivist dhe pjesë e strukturave drejtuese të subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që Bashkia Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht. Në mungesë të një justifikimit ligjor dhe objektiv lidhur me veprimet e Bashkisë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për skualifikimin mbetet shkak i diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

Komisioneri konstaton se Bashkia Vau i Dejës, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi largimi i tij nga detyra, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të ankuesit, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri ka kërkuar nga Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

6. A.A., kundër Bashkisë Shkodër

VENDIM NR. 219, DATË 13.12.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është larguar nga puna, pasi Kryetari i Bashkisë Shkodër ka patur preferencë të emërojë në vend të saj, një person me bindje politike të krahut të tij. A.A., nuk është e angazhuar në asnjë forcë politike, por ka punuar si tekniciene dhe është vlerësuar pozitivisht nga kryetarët e tjerë të Bashkisë Shkodër.

FAKTET

Ankuesja ka punuar pranë Bashkisë Shkodër, prej muajit mars 2005, në pozicionin e specialistes së buxhetit. Në vitet në vijim, ajo ka punuar në pozicione të tjera pune dhe është rritur në detyrë dhe përgjegjësi. Gjashtë vitet e fundit ka punuar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, institucion ky në varësi të Bashkisë Shkodër.

Pas procesit të parë të primareve në Shqipëri B.S., i cili përfaqëson subjektin politik Partia Demokratike e Rithemelimit, është zgjedhur kryetar i Bashkisë Shkodër dhe ka marrë zyrtarisht detyrën me 31 mars 2022.

Vetëm 3 (tre) javë pas ardhjes së tij në detyrë, ankuesja A.A., lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike e Arsimit, të Bashkisë Shkodër, nëpërmjet Urdhërit Nr. 228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të ri të Bashkisë. Duke iu referuar këtij urdhëri rezulton se lirimi nga detyra është i menjëhershëm dhe ankuesja nuk ka marrë asnjë njoftim paraprak nga Bashkia Shkodër për shkarkimin e saj. Njëkohësisht, rezulton se në këtë akt nuk është përmendur motivacioni i lirit nga detyra të ankueses, e cila është në padijeni të plotë në lidhje me arsyet e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për shkarkimin e saj, në mënyrë të menjëhershme.

Në vend të saj është emëruar një person me bindje politike dhe mbështetës i kryetarit në fushatën elektorale për zgjedhjen e tij. Personi në fjalë, është kandidat nga Komisioni i Rithemelimit, për Kryetar të Partisë Demokratike Shkodër, fakte këto, të cilat janë të bëra publike në media dhe dihen botërisht.

A.A., nuk është e angazhuar në asnjë forcë politike, por ka punuar si teknikene dhe është vlerësuar pozitivisht nga kryetarët e tjerë të Bashkisë Shkodër.

Gjithashtu personi nga i cili është zëvendësuar në pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit të Bashkisë Shkodër, nuk ka as përvojën dhe as kualifikimet e ankuesës në punë në profilin ekonomik. Drejtuesi i ri i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ka arsim juridik.

Gjatë hetimit administrativ të KMD-së, Bashkia Shkodër ka deklaruar se ankuesja A.A., ka shkëlur parimin e mirëbesimit, të parashikuar në nenin 153, të Kodit të Punës dhe si rrjedhim ajo është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj;
- *Karta Sociale Evropiane* në nenin 1, pika 2;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri çmoi se Bashkia Shkodër, në referencë të Kodit të Punës, në asnjë rast nuk ka evidentuar shkeljet me faj të rëndë ose të lehtë, në mënyrë të përsëritur që A.A., supozohet që ka kryer, si dhe asnjëherë nuk e ka njoftuar me shkrim paraprakisht ankuesen mbi shkeljet e konstatuara në punën e saj. Në momentin e shkarkimit të saj nga detyra Njësia e Auditit të Bashkisë Shkodër ende nuk kishte nxjerrë Projekt-Raportin e Auditit, pasi afati i auditimit pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ishte deri në datën 25 prill 2022. Në këto kushte, Bashkia Shkodër nuk kishtë asnjë fakt dhe provë për të justifikuar “shkaqet e justifikueshme” të parashikuara në nenin 153 të Kodit të Punës, fakt që reflektohet edhe në mungesën e motivacionit në urdhërin e lirit nga detyra.

Rezulton se shkarkimi nga detyra i ankuses është bërë pa shkaqe ligjore, të justifikuara. Bashkia Shkodër nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës. Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara.

Përveç sa më sipër, Komisioneri konstatoi gjithashtu se në të njëjtën datë, kur ankuesja është liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit, të Kryetarit të Bashkisë, në këtë pozicion pune është emëruar E.I. Një fakt i tillë përforcon idenë, se ankuesja është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Shkodër, për të emëruar dikë tjetër në pozicionin e punës Drejtor pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit. Referuar provave të depozituara nga ankuesja, si dhe në bazë të verifikimeve të kryera nga KMD, rezulton se E.I., është anëtar i Partisë Demokratike të Rithemelimit, si dhe ka qenë kandidat në primaret e zhvilluara në këtë parti së bashku me kryetarin aktual të Bashkisë Shkodër⁴. Në vijim, rezulton se E.I., është tërhequr nga gara në primaret e Partisë Demokratike, duke i dhënë mbështetjen dhe votën e tij, kandidatit B.S., aktualisht Kryetar i Bashkisë Shkodër. Ankuesja është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, pa respektuar asnjë procedurë të parashikuar në dispozitat e Kodit të Punës e pa asnjë shkak të arsyeshëm dhe në vendin e saj është emëruar E.I., që është anëtar, aktivist i subjektit politik Partia Demokratike e Rithemelimit, ku aderon Kryetari i Bashkisë Shkodër, si dhe është mbështetës i këtij të fundit.

Për sa më sipër, KMD gjykon se Bashkia Shkodër e ka diskriminuar ankuesen A.A., për shkak të bindjes politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike të A.A., nga ana e Bashkisë Shkodër.

⁴<https://www.faxweb.al/4-kandidatet-e-mbetur-ne-gare-jane-me-te-miret-e-qytetit-ivziku-hoqi-dore-nga-gara-per-kreun-e-pd-se-ne-shkoder-ja-arsyeja/>
<https://opinion.al/te-rinjte-ne-politike-fasade-apo-modele-te-gabuara-flasin-aktivistet/>
<https://www.youtube.com/watch?v=5z3sCwxLZ34> - U terhoq nga gara per kreun e PD dega Shkoder, E.I.
<https://www.youtube.com/watch?v=ms15dNa09CE>-Takimi i Berishës në Shkodër/ E.I.,: Demokratët shkodranë janë të karikuar – Fax News Albania.

- Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të gjendjes arsimore dhe gjinisë të A.A., nga ana e Bashkisë Shkodër.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Shkodër të marrë masa për të rikthyer ankuesen A.A., në vendin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

7. M.D., kundër Bashkisë Mat

VENDIM NR. 125, DATË 20.06.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Mat. Pas emërimit të Kryetarit të ri të Bashkisë është larguar nga puna, duke u diskriminuar në formën e shoqërimit, për shkak të bindjeve politike të vëllait të tij.

FAKTET

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mat dhe ka mbajtur detyrën e policit bashkiak deri në momentin kur i është zgjidhur marrëdhënia e punës, me motivacionin se ai nuk ishte pajisur me vërtetim besueshmërie nga ana e Policisë së Shtetit. Vërtetimi i besueshmërisë për të është marrë për shkak të një ngjarjeje, për të cilën Prokuroria ka realizuar një hetim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat është shprehur nëpërmjet vendimit të saj, duke vendosur ndaj tij pushimin e procedimit penal.

Motivacioni i përdorur nga ana e Bashkisë për largimin e tij nga puna (lidhur me vërtetimin e besueshmërisë) është i pavërtetë dhe i pabazuar, dhe trajtimi i padrejtë ndaj ankuesit nga ana e punëdhënësit ka ardhur vetëm për shkak të bindjeve politike të vëllait dhe të familjarëve të tij, të njohura prej të gjithëve, gjithashtu dhe prej punëdhënësit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12 i saj;

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- “Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Mat nuk arriti të provojë se kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesin, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënies të punës me të, apo që t’i kishte krijuar mundësinë këtij të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e tij të ligjshëm.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë e rregullt ligjore, Bashkia, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t’i ishin krijuar mundësitë për t’u mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

Komisioneri vlerëson se, shkak i zgjidhjes së marrëdhënies të punës me ankuesin nuk qëndron pasi motivacioni i përdorur nga ana e Bashkisë, nuk bën pjesë tek rastet e parashikuara në dispozitat ligjore e nënligjore që normojnë marrëdhënin e punës mes ankuesit e Bashkisë (*referuar këtu edhe neneve 16 e 17, të Kontratës Individuale të Punës*) dhe nuk bazohet në asnjë referencë ligjore.

Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se, argumentimi i Bashkisë bazuar në sa më sipër, nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi vërtetimi i besueshmërisë nuk përbën shkak për zgjidhjen e marrëdhënies të punës.

Vërtetimi i besueshmërisë për subjektin ankues është lëshuar negativ nga ana e Komisarariatit të Policisë Mat, me arsyetimin se ai, në periudhën kur ishte kërkuar të lëshohej ky dokument ka qenë person nën hetim nga organi i Prokurorisë. Në momentin kur është iniciuar procedura për ndërprerjen e marrëdhënies të punës më të (*bazuar në këtë motivacion*) ankuesi ishte person nën hetim, pra lidhur me të kishte një proces penal për të cilin organi kompetent ende nuk ishte shprehur me një vendimmarrje lidhur me të.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, për më tepër nuk kishte ende një vendim të formës së prerë të gjykatës, lidhur me fajësinë apo pafajësinë e ankuesit, gjë që e prezumon të pafajshëm atë deri në provimin e të kundërtës (*gjithmonë me një vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore*).

Bashkia Mat, ka konsumuar edhe një shkelje tjetër ligjore, duke cënuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi ka paragjykuar dhe marrë të mirëqenë faktin se ankuesi ka cënuar besimin e punëdhënësit për shkak të mosplotësimit të kriterëve për lëshimin e vërtetimit të besueshmërisë nga organi kompetent.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të vëllait të ankuesit si anëtar, aktivist dhe drejtues i organeve politike të Partisë Demokratike, Seksioni Nr. 3, Dega Mat.

Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit/Bashkisë, në dëm të subjektit ankues, kanë ardhur 4 muaj pas ndërrimit të titullarit të Bashkisë, pas zgjedhjeve vendore 2019, pasi ka marrë drejtimin e Bashkisë Mat.

Në mungesë të një justifikimit ligjor dhe objektiv lidhur me veprimet e Bashkisë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për skualifikimin mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike të vëllait dhe shoqërimi i tij me të.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Mat, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi largimi i tij nga detyra, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve politike të vëllait të tij.

Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga shoqërimi i ankuesit me vëllain e tij (*i cili ka bindje të kundërta politike me punëdhënësin e ankuesit*), dhe se ankuesit i është cënuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e ushtrimit të profesionit.

VENDIMI

- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit, *në formën e shoqërimit*, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vëllait të tij, nga ana e Komisarariatit të Policisë Mat.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Mat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

8. F.O., kundër Bashkisë Kukës

VENDIM NR. 238, DATË 29.12.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Nuk janë dhënë rekomandime

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Bashkinë Kukës dhe ka mbajtur detyrën e shoferit/zjarrëfikës. Pas emërimit të Kryetarit të ri të Bashkisë është larguar nga puna, duke u diskriminuar, për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Bashkinë Kukës prej më shumë se 3 vitesh dhe ka mbajtur detyrën e shoferit/zjarrëfikës, deri në momentin kur atij i është njoftuar largimi nga detyra.

Largimi i ankuesit nga puna, pavarësisht se në urdhrin e lirimit nga detyra nuk ka të përcaktuar arsye, faktikisht është bazuar në këtë “Vërtetim besueshmërie” të Policisë Kukës, dhe ky veprim lidhet ngushtësisht me periudhën përgatitore për fushatën elektorale për zgjedhjet vendore 2023, pra me bindjet e tij politike, të cilat janë të kundërta me ato të titullarit të Bashkisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H., and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007);
- Karta Sociale Europiane;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 8577/200 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”;
- VKM Nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”;
- VKM Nr. 895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të SHBMZSH”.

KONKLUZIONE

Rezultoi se zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kukës nuk arriti të provojë se kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesin, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, apo që t’i kishte krijuar mundësinë këtij të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e tij të ligjshëm.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë e rregullt ligjore, Bashkia, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t’i ishin krijuar mundësitë për t’u mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

Së dyti, Komisioneri vlerëson se, shkak i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin nuk qëndron pasi motivacioni i përdorur nga ana e Bashkisë, nuk bën pjesë tek rastet e parashikuara në dispozitat ligjore e nënligjore që normojnë marrëdhënien e punës mes ankuesit e Bashkisë dhe nuk bazohet në asnjë referencë ligjore.

Komisioneri vlerëson se, argumentimi i Bashkisë nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi vërtetimi i besueshmërisë nuk përbën shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Vërtetimi i besueshmërisë për subjektin ankues është lëshuar negativ nga ana e Komisarariatit të Policisë Kukës, me arsyetimin se ai, në periudhën kur ishte kërkuar të lëshohej ky dokument ka qenë person nën hetim nga organi i Prokurorisë. Në momentin kur është iniciuar procedura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës më të (*bazuar në këtë motivacion*) ankuesi ishte person nën hetim, pra lidhur me të kishte një proces penal për të cilin organi kompetent ende nuk ishte shprehur me një vendim-marrje lidhur me të.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, për më tepër nuk kishte ende një vendim të formës së prerë të gjykatës, lidhur me fajësinë apo pafajësinë e ankuesit, gjë që e prezumon të pafajshëm atë deri në provimin e të kundërtës (*gjithmonë me një vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore*).

Bashkia Kukës, ka konsumuar edhe një shkelje tjetër ligjore, duke cenuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi ka paragjykuar dhe marrë të mirëqenë faktin se ankuesi ka cenuar besimin e punëdhënësit për shkak të mosplotësimit të kriterëve për lëshimin e vërtetimit të besueshmërisë nga organi kompetent.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike dhe aktiviteti politik i tij, si mbështetës në aksionet politike të organizuara nga PD, si në nivel kombëtar dhe lokal. Madje pikërisht për shkak të pjesëmarrjes së tij në këto protesta është ndaluar nga Policia e Shtetit.

Komisioneri vëren se, në nenin 19, të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe në nenin 78 të VKM-së Nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, parashikohen kufizimet e të drejtave politike dhe të drejtës së grevës, ku theksohet se: “Punonjësi me grada i shërbimit të MZSH-së: a) nuk ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo të shprehë publikisht bindjet dhe preferencat e tij politike; b) nuk mund të jetë anëtar i një partie apo organizate politike dhe me veprimtarinë e tij nuk duhet të cenojë natyrën e depolitizuar të institucionit ...”.

Lidhur me analizën e legjislacionit të mësipërm, Komisioneri vëren se, Bashkia Kukës në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, në asnjë moment nuk është udhëhequr nga dispozitat e mësipërme, të cilat ia ndalojnë ankuesit pjesëmarrjen në veprimtari të politike, apo shprehjen publikisht të bindjeve apo preferencave të tij politike. Në rast se Bashkia, do të ishte motivuar nga zbatimi i dispozitave të mësipërme ligjore, në procedurën e largimit të ankuesit nga puna, atëherë dhe largimi do të kishte qenë i justifikuar bazuar pikërisht në këtë ndalim ligjor.

Mirëpo, duke analizuar procedurën dhe motivacionin e përdorur nga Bashkia, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore që mund të kishin qenë të justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, por Bashkia ka deklaruar motivacion tjetër, për të cilin nuk ka provuar se është i justifikuar dhe i ligjshëm. Duke iu referuar faktit se ankuesi është aktivist i subjektit politik Partia Demokratike dhe faktit që Bashkia Kukës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një motiv të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Në mungesë të një justifikimit ligjor dhe objektiv lidhur me veprimet e Bashkisë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për largimin nga detyra mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike. Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore, pasi në mungesë të një justifikimi për ligjshmërinë e veprimeve nga ana e Bashkisë në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të punës, shkaku i mbrojtur, pra bindjet politike të ankuesit dhe ekspozimi publik i tyre, mbeten i vetmi shpjegim i arsyeshëm për largimin e tij nga puna.

Komisioneri vlerëson se, *në parim*, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit të subjektit ankues nga detyra, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Mirëpo, *bazuar në rastin konkret*, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ndodhemi në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara konstatohet se, nga ana e Bashkisë Kukës është konsumuar sjellje diskriminuese kundrejt ankuesit, Bashkia si punëdhënësi, nuk mund të ngarkohet

me detyrimin për ta rikthyer në detyrë atë, përsa kohë shkak i provuar e faktuar nga ankuesi, është shkak për të cilin ka ndalim ligjor për ekspozimin e shprehjen e tij publikisht.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të të subjektit ankues, në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Kukës, për shkak të bindjeve të tij politike.

9. E.H., kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 181, DATË 19.09.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankueja E.H., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi është transferuar dhe më pas është larguar nga puna për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të babait të saj.

FAKTET

E.H., është emëruar “Specialiste Juriste” pranë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kamëz.

Më pas është transferuar nga detyra “Specialiste Juriste” pranë IVMT-së në “Asistente e Policisë Bashkiake”.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kamëz është ngritur grupi i punës për verifikimin e respektimit të orarit zyrtar të punës si dhe mbarëvajtjen e punës së Policisë Bashkiake.

Në zbatim të urdhërit të mësipërm, grupi i punës ka konstatuar se në vendshërbimin në liqenin e Paskuqanit, ankuesja nuk ka qenë në vendin e punës duke braktisur detyrën pa shkaqe të arsyeshme dhe pa njoftuar eprorin, gjithashtu nuk ishte prezent dhe punonjësi B.N., por që kishte njoftuar për një rast familjar dhe i ishte dhënë leje.

Me anë të një relacioni, Kryeinspektorja e Policisë Bashkiake ka kërkuar që punonjëses E.H., ti jepet masa “Largim nga detyra” me motivacionin “Braktisje e vendit të punës pa shkaqe të arsyeshme duke mos lajmëruar eprorët”.

Në vijim grupi i punës ka mbajtur disa procesverbale me data të ndryshme, ku ka konstatuar se në vendshërbimin në liqenin e Paskuqanit, punonjësja E.H., dhe B.N., nuk kanë qenë në vendin e punës duke braktisur detyrën pa shkaqe të arsyeshme dhe pa njoftuar eprorin.

Në dy prej procesverbaleve grupi i punës ka konstatuar se në vendshërbimin në liqenin e Paskuqanit, punonjësja E.H., dhe S.L., nuk kanë qenë në vendin e punës duke braktisur detyrën pa shkaqe të arsyeshme dhe pa njoftuar eprorin.

Në vijim, Kryetari i Bashkisë Kamëz ka urdhëruar largimin nga detyra të E.H., me motivacionin “*Braktisje të detyrës pa shkaqe të arsyeshme*”.

Referuar dokumentacionit rezultoi se grupi i punës i Policisë Bashkiake Kamëz në procesverbalet e mbajtura ka evidentuar se dhe punonjësi B.N nuk ka qenë në vendin e punës për një periudhë prej 5 ditësh, si dhe punonjësi S.L nuk ka qenë në vendin e punës për 2 ditë.

Referuar listë prezencës së Policisë Bashkiake Kamëz, rezulton se punonjësi B.N., ka qenë prezent në punë gjatë gjithë muajit dhe punonjësi S.L rezulton se ka munguar për një periudhë disa ditore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Social Evropiane, e rishikuar;
- Shtojca e Kartës Social Evropiane;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Kodi i Punës, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”;
- Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr. 69, datë 16.10.2000;
- Ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”;
- VKM-së Nr. 750, datë 16.09.2015, është miratuar Rregullorja e Policisë së Shtetit;
- Çështja e Coleman kundër Studiove Ligjore Attridge dhe Steve, GJED.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve, rezulton se ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me dy punonjësit e sipërcitur, për të cilët Bashkia Kamëz jo vetëm nuk ka marrë masë disiplinore, por punonjësit B.N i ka dhënë dhe pagën e plotë, ndryshe nga punonjësit E.H., dhe S.L., të cilëve nuk i është dhënë paga për ditët që kanë munguar.

Komisioneri vlerëson se argumenti i parashtruar nga ana e Bashkisë Kamëz, për braktisje të vendit të punës nga ana e ankueses është i pabazuar dhe nuk qëndron, për arsye se:

Së pari, ankuesja nuk ka asnjë njoftim për detyra të porealizuara apo mungesa në punë, përkundrazi në një prej procesverbaleve të mbajtur nga grupi i punës rezulton se ankuesja ka komunikuar me eprorët dhe ka marrë leje për katër orët e para të ditës së punës.

Së dyti, me relacionin e hartuar, nga ana e Kreyinspektores së komanduar është kërkuar largimi nga puna i ankueses, menjëherë pas ditës së parë që është konstatuar mungesa në punë e ankueses, ndërkohë që nuk është kërkuar largim nga puna për punonjës të tjerë që kanë munguar në punë.

Së treti, nga ana e Bashkisë Kamëz, nuk është menduar që masat disiplinore të jepen duke u përshkallëzuar, nga një masë më e lehtë në një masë më të rëndë, por për ankuesen është propozuar dhe marrë menjëherë masa disiplinore më e rëndë, ajo e largimit nga puna.

Së katërti, Bashkia Kamëz nuk arriti të provojë para Komisionerit se, kishte zhvilluar një takim paraprak me ankuesen, në të cilin ta kishte njohur me arsyen dhe motivin mbi të cilin bazohej zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, apo që t'i kishte krijuar mundësinë kësaj të fundit të dëgjohej dhe të mbronte interesat e saj të ligjshëm.

Rezultoi se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, njëkohësisht duke iu referuar faktit se pasojat negative ndaj ankueses janë kryer në periudhën përpara dhe pas zgjedhjeve të datës 25.04.2021, Komisioneri krijon bindjen se transferimi i ankueses dhe procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për largimin nga puna të ankueses. Duke iu referuar faktit se ankuesja është vajza e U.H, i cili është anëtar dhe përfaqësues në procesin e administrimit zgjedhor të subjektit politik Partia Demokratike, dhe faktit që Bashkia Kamëz, nuk arriti të provojë se transferimi dhe largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Kamëz, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e saj për punësim, pasi transferimi dhe më pas largimi i saj nga detyra, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve politike të babait të saj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses E.H., në të drejtën për punësim, *në formën e shoqërimit*, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të babait të saj, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kamëz, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

10. A.V., kundër Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat (NJVKSH Berat)

VENDIM NR. 20, DATË 18.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Trajtimi i pafavorshëm dhe diskriminues për shkak të bindjeve politike, gjatë procedurave të konkurimit për pozicionin e Shefit të Shërbimit në NJVKSH Berat.

FAKTET

Ankuesi është emëruar me transferim nga pozicioni mjek, në pozicionin “*Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare*”. Me vendim të Këshillit të Ministrave, është krijuar NJVKSH Berat dhe është kryer ristrukturimi i institucionit të DRSH Berat. Ankuesi është njoftuar për ndryshimin e pozicionit të punës në bazë të organikës së re të institucionit dhe kalimin e tij nga “*Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare*” në pozicionin e punës “*Specialist Mjek*” në Sektorin e Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

NJVKSH Berat, ka informuar DROSHKSH Elbasan se është hapur vendi vakant në pozicionin e punës, “*Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor*” dhe ka kërkuar lejimin e kryerjes së të gjitha procedurave të punësimit për vendin vakant.

NJVKSH Berat ka dërguar në DROSHKSH Elbasan kriteret për punësim për pozicionin e punës, “*Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor*”. Në kërkesat dhe kriteret për pozicionin ka kërkuar: - Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik. Të interesuarit në mes të tjerash duhet të paraqesin: - Diploma dhe listë notash master profesional/shkencor.

Nëpërmjet njoftimit, DQOSHKSH ka shpallur procedurën për plotësimin e pozicionit vakant të Shefit të Shërbimit pranë NJVKSH Berat. Referuar këtij njoftimi, në kriterin e arsimit rezulton se është kërkuar: “*Arsim i Lartë, Universiteti i Mjekësisë (Mjekësi/Shëndet Publik). Niveli minimal i arsimit: Master Shkencor*”.

Në vijim, DROSHKSH Elbasan, ka urdhëruar krijimin e komisionit të vlerësimit për procedurat e punësimit për pozicionin “*Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor*”.

Përsa më sipër, NJVKSH Berat ka kërkuar miratimin e punësimit të D.C., në pozicionin Shef i Sektorit të Shërbimit Parësor në NJVKSH Berat. Në këtë shkresë NJVKSH Berat ka informuar DROSHKSH Elbasan se ka përfunduar procedura e konkurimit, në të cilin janë paraqitur pesë kandidatë, dy nga të cilët janë skualifikuar për shkak se nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë në Mjekësi/Shëndet Publik, ndërsa kandidatët e tjerë janë renditur me pikët si më poshtë: 1. D.C., – 87 pikë. 2. A.V., – 81 pikë. 3. D.M .,– 73 pikë.

A.V., pasi është vënë në dijeni të rezultateve të konkursit, është ankuar lidhur me rezultatin e konkurimit.

NJVKSH i ka kthyer përgjigje ankuesit, në të cilën në mes të tjerash e ka informuar se, NJVKSH ka kërkuar si kriter punësimi arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik dhe diplomën e listën e notave të masterit shkencor/profesional, por nuk ka përcaktuar si kriter minimal masterin shkencor.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe Protokolli 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM-së Nr. 419, datë 04.07.2018 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor*”;
- Udhëzimi Nr. 673, datë 02.10.2019 “*Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH*”, i ndryshuar, të MSHMS.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se NJVKSH Berat, nuk arriti të faktonte përpara Komisionerit se:

Propozimi i kriterit të arsimit, për pozicionin shef shërbimi, ishte i përfshirë në detyrat e NJVKSH Berat.

Kishte autoritet për të ndryshuar kriterin e arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për të vlerësuar kriterin e arsimit.

Kishte njoftuar autoritetin përgjegjës për gabimin e konstatuar.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se A.V., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike, dhe faktit që komisioni i vlerësimit nuk arriti të provojë se mosrespektimi i kriterit të arsimit ka ndodhur për një shkak të ligjshëm, Komisioneri gjykon se, mosrespektimi i kriterit të arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e komisionit të vlerësimit, nuk motivohet nga shkaqe ligjore.

Në përfundim, Komisioneri krijoi bindjen dhe vlerëson se shtetasi A.V., është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e NJVKSH Berat, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike të ankuesit.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të vlerësimit të kriterit të arsimit, duhet të jetë ndreqja e pasojave, lidhur me procesin konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike të shtetasit A.V., nga ana e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e OSHKSH Elbasan dhe NJVKSH Berat, sipas kompetencave ligjore, të marrin masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me procesin konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

11. V.M., kundër Bashkisë Mat

VENDIM NR. 25, DATË 24.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mat. Për shkak të ristrukturimit të institucionit ankuesja është transferuar në mënyrë të përsëritur në pozicione të ndryshme pune duke u vënë në kushte të pafavorshme dhe diskriminuar për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Mat.

FAKTET

V.M., është emëruar nëpunëse civile, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel.

Tre vite më vonë ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të ristrukturimit të pjesshëm të institucionit. Në vijim, ankuesja është transferuar nga pozicioni Përgjegjëse e Sektorit të

Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel, kategoria e pagës III-b, në pozicionin Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel, kategoria e pagës IV-a.

Vetëm 5 ditë nga transferimi për shkak të ristrukturimit, ankuesja është njoftuar se do të fillojë procedura e transferimit në pozicionin, Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan.

Më pas, V.M., ka konkuruar për lëvizje paralele për pozicionin e specialistit për Mbrojtjen e Fëmijës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes së Shtresave në Nevojë, të Bashkisë Mat. Në përfundim të procedurave të konkurimit për lëvizje paralele, ankuesja është emëruar nëpunëse civile në pozicionin, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes së Shtresave në Nevojë, Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake.

Disa muaj më vonë, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të transferimit në pozicionet e reja të parashikuara në strukturën e re për vitin 2021. Në vijim është transferuar nga pozicioni Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës, në pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njësisë Administrative Derjan.

Rezulton se Bashkia Mat nuk ka bërë asnjë vlerësim të punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin dhe të kriterit të arsimit për pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 125, datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

KONKLUSIONE

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezultoi se nga Bashkia Mat nuk është bërë asnjë vlerësim i punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin. Duke pasur barrën e

provës për të provuar arsyet e transferimit e përkohshëm të ankueses, Bashkia Mat në cilësinë e autoritetit përgjegjës, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion që të kishte bërë një vlerësim të tillë dhe në përfundim të vlerësimit, V.M., ishte përzgjedhur si punonjësja që përmbushte kushtet më të mira për tu transferuar.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar rezultoi se V.M., është diplomuar në Institutin e Lartë Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, në Degën Financë.

Rezultoi se për pozicionin e Specialistit të Kadastrës së Tokës Bujqësore, kërkohet si kriter specifik Master Shkencor në fushën e Agronomisë apo Shkencave Bujqësore.

Rezulton se nga ana e Komisionit të Ristrukturimit nuk është bërë vlerësimi i kriterit specifik të pozicionit, sipas kriterit ligjor, për të cilin kërkohet Master Shkencor në fushën e agronomisë apo shkencave bujqësore, por është argumentuar se punonjësja V.M., ka mbaruar Universitetin Bujqësor dhe plotëson kriterin specifik. Rezulton se ankuesja është diplomuar në degën financë dhe arsimimi i saj nuk ka krahasim me kriterin specifik të kërkuar për pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore.

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se:

Bashkia Mat nuk ka bërë asnjë vlerësim të punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin.

Bashkia Mat nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, gjatë procesit të plotësimit të pozicionit të Specialistit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms, duke emëruar A.L.

Bashkia Mat nuk ka vlerësuar si duhet kriterin specifik të arsimit për pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Derjan, duke transferuar V.M., dhe duke mos i ofruar një pozicion tjetër sipas parashikimeve ligjore.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezultoi se ankuesja brenda një periudhe prej më pak se një viti, i është nënshtruar një transferimi të përkohshëm për nevoja të institucion dhe një transferimi të përhershëm si rezultat i ndryshimit të strukturës të institucionit dhe në të dy rastet ankuesja është transferuar në një distancë prej 18 kilometrash nga vendi i banimit, duke mos dhënë një justifikim të arsyeshëm për këto transferime. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të ndryshimit të vendit të punës.

Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat për shkak të bindjes politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses V.M., për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Mat.

- Në referim të pikës 1, Bashkia Mat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në një pozicionin që përshtatet me arsimin e saj, pranë Njesisë Administrative Burrel.

12. D.N., kundër Bashkisë Vau Dejës

VENDIM NR. 89, DATË 20.05.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka filluar marrëdhëniet e punës në Bashkinë Vau Dejës në vitin 2015 në pozicionin si “Inspektor zhvillimi”. Një vit më vonë është liruar nga detyra e inspektorit të zhvillimit dhe është emëruar në pozicionin “Specialist IT Web”. Në vitin 2018 është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë”. Gjatë vitit 2017, rezulton se ankuesi ka ushtruar për pak kohë detyrën e Nënkryetarit të Bashkisë Vau Dejës.

M.B., është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në vijim, nga ana e Bashkisë Vau Dejës, ankuesi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, brenda dy muajve nga data e marrjes dijeni të këtij njoftimi, duke argumentuar se, arsyet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ishin për shkak se në pozicionin që mbante ankuesi duhet të kishte nivelin arsimor “Master Shkencor”, ndërkohë që D.N., kishte nivelin e arsimit “Bachelor”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Jurisprudenca e GJEDNJ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: Nr. 2, datë 03.02.2010, Nr.1, datë 12.01.2011, Nr. 23, datë 08.06.2011;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Deklarata ILO-s mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Vau Dejës, nuk arriti të provonte përpara Komisionerit se:

Veprimet e saj në drejtim të ndërprerjes së kontratës së punës me ankuesin ishin të drejta dhe të justifikuara.

Kishte zëvendësuar ankuesin në pozicionin që mbante, me një punonjës që plotësonte kriterin e arsimit.

Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Vau Dejës, të konstatuar nga Komisioneri në këtë vendim.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se Bashkia Vau Dejës gjatë vitit 2020, ka emëruar me komandim në detyrë punonjësen L.M., në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë”. Referuar nivelit arsimor të L.M., rezulton se ajo zotëron Diplomë Bachelor në Financë-Kontabilitet dhe Master Profesional në Financë-Bankë, pra dhe punonjësi i komanduar nga Bashkia Vau Dejës në pozicionin që mbante ankuesi, nuk plotëson nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin e përgjegjës të sektorit.

Bazuar në konstatimet dhe vlerësimet e sipërcituara, Komisioneri krijoi bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës nuk motivohet nga një shkak ligjor për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Njëkohësisht duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike, si dhe duke patur parasysh se Bashkia Vau Dejës, që është edhe subjekti që ka barrën e provës në këtë proces administrativ, në asnjë rast, nuk ka arritur të provojë se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm apo të justifikojë se ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, por ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv, Komisioneri del në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës së D.N., është kryer për motive politike.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykoi se Bashkia Vau Dejës, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit D.N., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Vau Dejës.

13. K.K., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 135, DATË 05.07.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Berat. Veprimet e ndërmarra nga punëdhënësi lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të, janë bërë për shkak të bindjes politike, duke e diskriminuar atë në fushën e punësimit.

FAKTET

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Berat, prej datës 09.05.2016 deri me datë 26.02.2021. Ankuesja është liruar nga Shërbimi Civil me motivacionin e ristrukturimit të institucionit dhe pamundësisë së risistemimit të saj në një pozicion të përshtatshëm, në përputhje me arsimimin dhe pozicionin e mëparshëm të punës. Motivacioni i vërtetë që ka shërbyer për lirim të saj nga Shërbimi Civil, janë bindjet e saj politike që janë të ndryshme nga ato të punëdhënësit, gjë që ka shërbyer si motivacion edhe për mossistemimin e saj në një pozicion tjetër të përshtatshëm bazuar në arsimimin dhe pozicionin që ajo kishte para ristrukturimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;

- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen Bączkoëski dhe të tjerët kundër Polonisë (Bączkoëski and others v. Poland),/ çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga Shërbimi Civil”, e ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se, nga ana e punëdhënësit/Bashkisë Berat, është vlerësuar që ankueses i është ristrukturuar pozicioni i punës dhe nuk ka asnjë pozicion të lirë në shërbimin civil, në të cilin ky nëpunës civil, plotëson kushtet e kriteret për t’u transferuar. Bashkia ka deklaruar se me punonjësen janë larguar dhe 5 punonjës të tjerë, nëpunës civilë për të njëjtën arsye si ankuesja. Nga situata krahasimore e dy strukturave, pozicioneve të punës specialist si dhe arsimimit të kërkuar për secilin pozicion, Komisioneri vëren se, argumenti i Bashkisë Berat, lidhur me pamundësinë e sistemimit të ankueses në një nga pozicionet e krijuara pas ristrukturimit të Institucionit, nuk qëndron, është i pabazuar e i pavërtetë.

Kjo për shkak se:

Së pari, argumenti i Bashkisë se ankuesja nuk mund të transferohej në asnjë nga pozicionet e reja të punës për shkak se këto pozicione janë për nëpunës civil të kategorisë III-b, ndërsa ankuesja i përkiste një kategorie më të ulët IV-a; nuk është i vërtetë dhe nuk provohet shkresërisht. Bazuar në aktin e emërimit në detyrë të ankueses, si dhe referuar strukturës (emërtesës së pozicionit të ankueses në të), konstatohet se ankuesja ishte emëruar në pozicionin “Specialist Turizmi”, kategoria III-b, me arsim të lartë, të paspecifikuar.

Së dyti, nga 6 (gjashtë) pozicionet e krijuara për Specialist, në Drejtori të ndryshme të Bashkisë, 3 (tre) nga këto kishin të përcaktuar kërkesën e arsimit të lartë në Shkenca ekonomike/Financë: (*Specialist Auditi, Specialist i Planifikimit Strategjik, Analizave Ekonomike dhe Riskut Financiar dhe Specialist i të Ardhurave*).

Bazuar në dokumentacionin e dosjes personale të ankueses depozituar pranë Bashkisë Berat, kjo e fundit dispononte dokumentacionin provues lidhur me arsimimin e ankueses, dhe ishte në dijeni të faktit që ajo zotëronte diplomë në shkencat ekonomike, përveç diplomës në shkencat juridike. Bashkia, në momentin e ristrukturimit të saj, kishte 3 (tre) vende/pozicione të lira pune, që përshtateshin me formimin arsimor të ankueses dhe që mund e duhej t’i ofroheshin asaj në përputhje me mbrojtjen ligjore si nëpunës civil në rastet e ristrukturimit të Institucionit.

Bazuar në aktet e administruara, Bashkia Berat nuk paraqiti asnjë dokument apo akt shkresor nëpërmjet të cilit të provonte se ishte në kushtet e parashikukuara në nenin 66, të Ligjit Nr.

152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, lidhur me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet liritimit, të nëpunësit civil, K.K.

Në këto kushte provohet se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, dhe se masa e marrë për lirimin e saj nga shërbimi civil, është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, si dhe në shkelje të plotë të procedurës dhe të garancisë ligjore që Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i jep nëpunësit civil.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesen dhe lirimi i saj nga shërbimi civil, nuk rezultoi që këtë ndodhur në përputhje me motivacionin e deklaruar nga punëdhënësi. Nga dokumentacioni i sjellë nga Bashkia, rezulton se faktet e disponuara janë në kundërshtim me deklaratimet e saj edhe lidhur me faktin se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me punonjësit e tjerë përsa i takon liritimit nga shërbimi civil bazuar në shkakun e bindjeve politike, pasi njëherësh me ankuesen janë liruar nga shërbimi civil edhe 4 (katër) punonjës të tjerë. Kjo, për shkak se nga dokumentacioni i sjellë, rezulton se të gjithë këta punonjës (M.K., B.K., G.Gj., E.E.) janë anëtarë të LSI-së dhe se ata kanë marrë pjesë në fushata zgjedhore dhe procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë dhe Zgjedhjet Vendore për periudhën nga 2016-2021. (Pothuajse të gjithë kanë qenë subjekte ankues pranë KMD-së, me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike kundër Bashkisë Berat). Pra, në këtë rast, ankuesja dhe punonjësit e tjerë të larguar nga puna nga ana e Bashkisë posedojnë të gjithë të njëjtin shkak dhe për këtë arsye ata nuk mund të shërbejnë si krahasues në këtë rast.

Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin/Bashkinë me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për lirimin e ankueses nga shërbimi civil, rezultuan të paprovuara. Në këto kushte provohet se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Berat, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën për punësim, pasi largimi i saj nga detyra (*lirimi nga Shërbimi Civil*), nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues K.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Berat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

14. A.T., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 221, DATË 20.12.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Kavajë, në detyrën e “Edukatores” në një nga kopshtet e qytetit Kavajë. Pas ndërrimit të Kryetarit të Bashkisë, asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës nga ana e punëdhënësit/Bashkisë, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Kavajë dhe për një periudhë 15 vjeçare ka mbajtur detyrën “Edukatore”.

Me ardhjen në pushtet të Kryetarit të Bashkisë, përfaqësues i PS, dega Kavajë, ndaj ankuseses kanë nisur problematikat në marrëdhënien e punës, duke i komunikuar disa herë verbalisht në formë presioni që nga 2019 e në vijm urdhra të Kryetarit për transferim, kërcënime këto të cilat u konkretizuan në vitin 2022, duke u formalizuar me largimin e saj nga puna.

Hakmarrja ndaj saj në formën e diskriminimit ka ardhur për shkak se ajo ka bindje të djathta të njohura botërisht nga i gjithë komuniteti i Kavajës, si dhe punëdhënësi gjithashtu, bindje të kundërta këto me Kryetarin e Bashkisë/ish-Punëdhënësin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj);
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;
- “*Karta Sociale Evropiane*” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Kavajë, nuk vuri në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, duke mos arritur të provonte përpara Komisionerit se:

Ankuesja nuk ka kundërshtuar dhe ka pranuar urdhrin e transferimit, ndërkohë që faktohet e kundërta, që e ka kundërshtuar shkresërisht (*administrativisht dhe gjyqësisht*) këtë akt administrativ.

Transferimi i saj ishte i ligjshëm, i justifikuar dhe në përputhje me kushtet e kontratës individuale të punës me të.

Transferimi i saj nuk ka sjellë ndryshim të kushteve të kontratës individuale të punës dhe nuk ka qenë në dëm të saj si punëmarrëse.

Se transferimi ishte bërë si rezultat i një studimi apo planifikimi të mirëmenduar e të studiuar paraprakisht nga ana e Bashkisë, apo të kishte ardhur si rezultat i nevojave konkrete e specifike të dokumentuara me prova e fakte për cilësinë e kopshteve të fshatrave e qytetit Kavajë.

Se cila ishte cilësia e kopshteve të fshatrave Kavajë dhe atyre të qytetit Kavajë, në kuadër të ushtrimit të detyrës nga ana e edukatoreve të tyre apo profesionaliteti e kualifikimet e tyre.

Sa edukatore të tjera përveç ankueses ishin transferuar nga kopshtet e qytetit Kavajë në kopshtet e fshatrave Kavajë në kuadër të përmirësimit të cilësisë së përkujdesjes së tyre ndaj fëmijëve, në mënyrë që të dëshmonet se trajtimi i saj nuk ka qenë diferencues dhe i pafavorshëm krahasuar me punonjëset e tjera/edukatorët e kopshteve të qytetit Kavajë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi transferimi i saj është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesja si aktiviste e përkrahëse e Partisë Demokratike, Dega Kavajë.

Transferimi i ankueses, kosideruar si ndërprerje e marrëdhënieve të punës me të, jo vetëm që nuk rezultoi që ketë ndodhur për ndonjë shkak ligjor apo të ishte i justifikuar, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se Bashkia Kavajë, deklaroi motivacione dhe shkaqe të pabazuara dhe të paprovuara që kanë shërbyer për të justifikuar transferimin e saj (*njëherësh dhe përfundimin e marrëdhënies së punës*).

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se transferimi i ankueses, nuk motivohet nga shkaqe ligjore dhe nuk është i justifikuar objektivisht apo të jetë mbështetur në fakte e prova shkresore. Duke iu referuar faktit se ankuesja aktiviste dhe mbështetëse e ekspozuar publikisht e subjektit politik Partia Demokratike/Dega Kavajë dhe faktit që Bashkia Kavajë, nuk arriti të provojë se transferimi ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit/Bashkisë në dëm të subjektit ankues kanë ardhur pas ndërrimit të titullarit të Bashkisë.

Në mungesë të një justifikimit ligjor dhe objektiv lidhur me veprimet e Bashkisë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për skualifikimin mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja, pra bindjet politike.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u arrit të provohej një përlligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankueses, lidhur me transferimin e saj, që në fakt ishte njëherësh dhe zgjidhje e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi i saj se transferimi i saj nga qyteti Kavajë është i përkohshëm dhe është realizuar për përmirësimin e cilësisë në ushtrimin e detyrës së edukatores pranë Kopshtit Karpën, në fshatin Karpën, rezulton i pa vërtetë, i pabazuar në prova, i padrejtë dhe i paligjshëm; për sa kohë mungon dokumentacioni provues apo fakte e prova të tjera që të mbështesin e legjitimojnë veprimet e Bashkisë.

Në kushtet kur, nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u arrit të provohej që transferimi i ankueses ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se kjo masë ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; dhe nga ana tjetër ankuesja provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të saj politike.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të të ankueses, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Kavajë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës (*Edukatore në Kopshtin Nr. 1, Kavajë*).

15. Gj.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.

VENDIM NR. 136, DATË 06.07.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi është liruar nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit, në UK Vau i Dejës sh.a., duke u diskriminuar për shkak të bindjes dhe aktivitetit të tij politik.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Ujësstellës Kanalizime sh.a (UK) Vau i Dejës, dhe ka mbajtur pozicionin e përgjegjës në Sektorin e UK Hajmel, pranë UK Vau i Dejës, deri me datë 22.01.2020, kur është liruar nga detyra. Lirimi nga detyra është i pamotivuar, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mospërbushje të detyrës nga ana e tij. Largimi ka ndodhur vetëm pak pas largimit të Administratores së mëparshme dhe zëvendësimit të saj me Administratorin aktual, I.B., i cili, është përfaqësues politik i PS në Vau i Dejës, dhe ka bindje të kundërta politike me të, pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: Vendimi Nr. 31/2021, i Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se UK Vau i Dejës:

Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se cilat detyra funksionale të ankuesit si Përgjegjës i Sektorit të UK Hajmel, nuk ishin përmbushur konkretisht.

Nuk paraqiti asnjë dokument ku të evidentohet performanca e tij në punë apo ndonjë vlerësim pune, as nga eprori direkt i tij, Drejtori Teknik, as nga punëdhënësi.

Nuk paraqiti asnjë dokument apo provë tjetër ku të evidentohet mungesa e bashkëpunimit nga ana e ankuesit me titullarin e Institucionit, apo refuzimi i tij për të përmbushur ndonjë urdhër a udhëzim konkret.

Për më tepër, megjithëse në parashtrimet para KMD-së, UK Vau i Dejës citon se largimi i ankuesit nga puna është bërë edhe në kuadër të ristrukturimit të Shoqërisë, UK Vau i Dejës, nuk depozitoi asnjë akt shkresor për të provuar se: ristrukturimi i Shoqërisë do të ishte strukturor apo do të prekte edhe organikën e Shoqërisë duke shkurtuar numrin e punonjësve dhe për më tepër sa do të ishte numri i punonjësve që do të largoheshin nga puna; cilat do të ishin kriteret mbi bazët e të cilave do të realizohej ristrukturimi dhe përzgjedhja e punonjësve të cilët do të vazhdonin punën dhe atyre që do të largoheshin nga puna; cila ishte procedura, afatet dhe strukturat/personat e ngarkuar

me procesin e ristrukturimit; dhe si ishte vlerësuar përmbushja e kriterëve, kualifikimi dhe performanca në punë e paditësit në raport me personat e tjerë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se nevoja për rivlerësimin e marrëdhënies së punës me ankuesin kishte si shkak ristrukturimin e Shoqërisë.

UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij se shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ankuesin ishte ristrukturimi.

Komisioneri vlerëson se, shkak i shtuar në shpjegimet e sjella para KMD-së nga ana e punëdhënësit, ai i ristrukturimit të Shoqërisë, nuk është cituar në asnjë nga shkresat në procedurën e ndjekur prej saj, për largimin e ankuesit nga puna. Ato janë shtuar si argumenta shtesë gjatë prapësimeve para Komisionerit, për rrjedhojë nuk mund të kenë shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna.

Lidhur me këtë motivacion të cituar nga punëdhënësi, i cili sipas tij ka shërbyer për të larguar ankuesin nga puna, Komisioneri vëren se, UK Vau i Dejës, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë për t'u dëgjuar, parashtruar argumentat e tij e mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

UK Vau i Dejës, ka parashtruar si argumenta para Komisionerit se, arsyet për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin, ishin për shkak të *performancës së dobët në punë, mungesës së bashkëpunimit me titullarin, si dhe ristrukturimi i ndërmarrjes*; ndërkohë që, punëdhënësi, nuk arriti t'i provojë e faktojë pretendimet e veta kundrejt ankuesit.

Komisioneri vlerëson se, referuar pozicionit të ankuesit si Kryetar i PD, Seksioni Hajmel, (*që nga viti 2008 e aktualisht*), i cili është një pozicion drejtues në strukturat e subjektit politik PD, ky fakt e bën atë të ekspozueshëm dhe identifikueshëm si pjesë e këtij subjekti edhe nga publiku apo persona të tjerë jashtë këtij subjekti politik.

UK Vau i Dejës, në cilësinë e punëdhënësit të ankuesit është një shoqëri aksionere, me aksioner të vetëm Bashkinë Vau i Dejës. Rezulton se, M.B., është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste e Shqipërisë. Pas konstituimit të Këshillit Bashkiak, ai ka bërë betimin si Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës më datë 09.08.2019. Gjithashtu, bazuar në jetëshkrimin e publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me aktivitetin politik të M.B., rezulton që ai ka mbajtur pozicionin e koordinatorit elektoral të PS, në Bashkinë Vau i Dejës, aktiviteti politik i të cilit është i njohur. Kompetencën për të emëruar dhe liruar nga detyra, Administratorin e UK, e ka Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme që në rastin e Shoqërive Aksionere Ujësjetllës Kanalizime është Kryetari i Bashkisë. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për vetqeverisjen vendore.

Bazuar në të dhenat e pasqyruara në ekstraktin historik të shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a., pak kohë pas emërimit të tij në detyrë në shoqërinë UK Vau i Dejës, kanë ndodhur disa ndryshime në organet e saj drejtuese dhe ndër të tjera, në pozicionin e Administratorit të UK Vau i Dejës, me datë 10.10.2019, është emëruar I.B.

Administratori i ri, një muaj pas emërimit në detyrë ka filluar procedurën e për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.

Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit/Shoqërisë në dëm të subjektit ankues kanë ardhur menjëherë pas zgjedhjes dhe emërimit të Administratorit të Shoqërisë.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se UK Vau i Dejës deklaroi motivacione dhe shkaqe të ndryshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Nga dokumentacioni i sjellë nga UK Vau i Dejës, rezulton se vendi i punës së ankuesit nuk është shkurtuar dhe pas largimit të tij nga puna ky vend pune është plotësuar me punonjës Z.K., i cili, nga të dhënat e disponuara rezulton se, i ka të ekspozuara bindjet politike si përfaqësues i PS, si kandidat dhe anëtar i Këshillit Bashkia Vau i Dejës (*në vitet paraardhëse*).

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përse i takon procedurës së ndjekur për largimin e tij nga puna, si dhe shkaqeve bazuar mbi të cilat i është zgjidhur marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim, trajtimi i pabarabartë ka nisur menjëherë një muaj pas emërimit në detyrë të Administratorit të UK Vau i Dejës dhe 4 muaj pas emërimit të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës. Komisioneri gjykon se largimi i punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës, të cilët kishin të ekspozuara bindjet e kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, ka ndikuar në veprimet e ndërmarra nga ana e Administratorit të UK Vau i Dejës.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar, aktivist dhe pjesë e strukturave drejtuese të subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që UK Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Kjo bindje përforcohet më shumë, pasi punëdhënësi ka zëvendësuar ankuesin me një punonjës tjetër, bindjet e majta të të cilit, si pjesë e strukturave të PS/Vau i Dejës janë të ekspozuara e të njohura botërisht.

Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga bindjet politike të ankuesit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit *në formën e udhëzimit për diskriminim*, të ankuesit Gj.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjetës Kanalizime Vau i Dejës.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga UK Vau i Dejës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

16. Z.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.

VENDIM NR. 134, DATË 05.07.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Udhëzim për diskriminim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi është liruar nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit, në UK Vau i Dejës sh.a., për shkak të bindjeve e aktivitetit të tij politik duke u diskriminuar në të drejtën për punësim.

FAKTET

Subjekti ankues ka qënë në marrëdhënie pune me Ujësjetllës Kanalizime sh.a (UK) Vau i Dejës, dhe ka mbajtur pozicionin e Magazinierit, pranë UK Vau i Dejës, deri me datë 22.12.2019, kur është liruar nga detyra. Lirimi nga detyra i ankuesi ishte i pamotivuar, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mospërbushje të detyrës nga ana e tij.

Gjithashtu, largimi i tij nga puna ka ndodhur vetëm pak pas largimit të Administratores së mëparshme dhe zëvendësimit të saj me Administratorin e ri, I.B., i cili, është përfaqësues politik i PS në Vau i Dejës, dhe ka bindje të kundërta politike me të, pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: Vendimi Nr. 31/2021, i Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996);
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se UK Vau i Dejës:

Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se cilat detyra funksionale të ankuesit si Magazinier i UK Vau i Dejës, nuk ishin përmbushur konkretisht.

Nuk paraqiti asnjë dokument ku të evidentohet performanca e tij në punë apo ndonjë vlerësim pune, as nga eprori direkt i tij, as nga punëdhënësi.

Nuk paraqiti asnjë dokument apo provë tjetër ku të evidentohet mungesa e bashkëpunimit nga ana e ankuesit me titullarin e Institucionit, apo refuzimi i tij për të përmbushur ndonjë urdhër a udhëzim konkret.

Nuk paraqiti asnjë dokument apo provë tjetër ku të evidentohet mungesa e etikës së ankuesit, apo braktisja e vendit të punës.

Lidhur me këtë motivacion të cituar nga punëdhënësi, i cili sipas tij ka shërbyer për të larguar ankuesin nga puna, Komisioneri vëren se, UK Vau i Dejës, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë për t'u dëgjuar, parashtruar argumentat e tij e mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

Komisioneri vërejt se veprimet e Administratorit të UK Vau i Dejës, kundrejt ankuesit, kanë ardhur menjëherë pas emërimit të tij në detyrë dhe pas nisjes së procedurave të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, për largimin e punonjësve të cilët kishin bindje të kundërta politike me të. Bazuar sa më sipër, Komisioneri gjykoi se largimi i punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës, të cilët kishin të ekspozuara bindjet e kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, ka ndikuar në veprimet e ndërmarra nga ana e Administratorit të UK Vau i Dejës.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike, Dega Vau i Dejës.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstatoi se UK Vau i Dejës, deklaroi motivacione të pambështetura në prova e fakte, si dhe deklaroi shkaqe të tjera, të ndryshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijoi bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar e aktivist i subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që UK Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Komisioneri, gjykoi se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga bindjet politike të ankuesit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “udhëzimit për diskriminim” të ankuesit Z.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjetës Kanalizime Vau i Dejës.
- Në referim të pikës 1, UK Vau i Dejës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

17. J.A., kundër Bashkisë Devoll

VENDIM NR. 5, DATË 06.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është larguar nga detyra menjëherë pas përfundimit të Zgjedhjeve Parlamentare, për shkak të anëtarësimit në subjektin politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

FAKTET

Ankuesja ka filluar punë në pozicionin Punonjëse e Policisë Bashkiake Devoll, në vitin 2017. Më pas ka nënshkruar Kontrata Individuale e Punës me afat të pacaktuar, mes saj dhe Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Në pozicionin e punonjësës së Policisë Bashkiake, ankuesja ka punuar nga viti 2017 deri në vitin 2021, kur i është zgjidhur kontrata e punës, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Devoll, me motivacionin “*moszbatim të detyrave funksionale, thyerje e disiplinës në punë dhe paaftësi në kryerjen e detyrës funksionale*”.

Ndërprejra e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ajo është mbështetëse dhe anëtare e Partisë Demokratike (PD).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁵ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Social Evropiane, ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme e Bashkisë Devoll.

KONKLUZIONE

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se:

Masat disiplinore të propozuara nga Drejtori i Agjencisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, kanë nisur pak kohë pas anëtarësimit të ankueses në Partinë Demokratike;

Në raport me punonjësit e tjerë, për të njëjtat sjellje, vetëm për ankuesen është propozuar menjëherë masa disiplinore e largimit nga puna, pa marrë parasysh nëse ka qenë apo jo rast i përsëritur;

Nga aktet e administruara evidentohet se qëllimi i punëdhënësit ka qenë të largojë ankuesen nga puna, duke gjetur arsye të paargumentuara dhe të pambështetura në prova;

Bazuar në konstatimet e bëra, Komisioneri krijoi bindjen se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në procedurën e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës. Duke iu referuar faktit se, ankuesja është anëtare e subjektit politik Partia Demokratike dhe Kryetari i Bashkisë Devoll, ka patur një aktivitet të njohur politik, si pjesë e strukturave të Partisë Socialiste të Shqipërisë, prezumimit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet e saj politike, dhe faktit që Bashkia Devoll nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe se zgjidhja e kontratës ka patur një shkak të ligjshëm, u krijua dyshimi se veprimet e Bashkisë Devoll kanë qenë të motivuara politikisht.

Komisioneri konstatoi se largimi i ankueses nga pozicioni i punës si punonjëse e Policisë Bashkiake Devoll, nuk ka ardhur për arsye të justifikuara. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Devoll për shkak të bindjes politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses J.A., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Devoll.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Devoll, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

⁵ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

18. J.K., kundër Bashkisë Mat

VENDIM NR. 23, DATË 24.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Për shkak të bindjeve të kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Mat, si dhe faktit që nuk ka marrë pjesë në votime, ankuesi është diskriminuar nga Bashkia Mat/punëdhënësi, fillimisht duke e transferuar në një tjetër pozicion pune e më pas duke e larguar nga detyra.

FAKTET

Ankuesi në vitin 2017, është emëruar në pozicionin e punës “Specialist i Zyrës me Një Ndalesë”, pranë Njesisë Administrative Rukaj, Bashkia Mat.

Pas zgjedhjeve vendore të zhvilluara më datë 30.06.2019, në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Mat është emëruar A.M., propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Sapo A.M., ka nisur ushtrimin e detyrës, ankuesi fillimisht është transferuar në Njësinë Administrative Macukull, në një zonë malore, e cila ndodhej rreth larg nga vendbanimi i tij. Pavarësisht largësisë dhe vështirësive të transportit, ka vijuar të ushtrojë detyrën në Njësinë Administrative Macukull. Dy muaj pas transferimit në këtë detyrë, ndaj ankuesit ka filluar procedura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me arsyetimin e mungesave në pozicionin e punës dhe vërejtjeve të marra ndaj tij, për të cilat ai nuk ka patur dijeni në asnjë moment.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁶ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Social Evropiane, ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

⁶ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

KONKLUSIONE

Bazuar në konstatimet e bëra, Komisioneri konstatoi se:

Pavarësisht se nuk ishin bërë më parë vlerësime pune në Njësinë Administrative Rukaj, në rastin konkret ishte bërë vetëm për ankuesin, duke e vlerësuar me “Dobët”, me synimin e marrjes së masës disiplinore ndaj tij;

Edhe pse Bashkia Mat, referonte se ankuesi e nje punën dhe detyrat funksionale, e emëruan në një njësi tjetër administrative dhe i dhanë më pas masë disiplinore me motivacionin: *“Mungesë efiçence në përmbushjen e detyrave funksionale”*;

Masat disiplinore të propozuara nga Administratori i Njësisë Administrative Rukaj, kanë nisur pak kohë pas emërimit të kryetarit të Bashkisë Mat;

Më pas, pa arsye të justifikuara, ndaj tij janë dhënë masa disiplinore dhe transferimi në një njësi administrative, larg vendbanimit. Pra, përsa më sipër arsyetuar, u konstatua se ndaj ankuesit janë marrë dy masa njëkohësisht, dhënia e masës disiplinore dhe transferimi në një njësi administrative, larg vendbanimit;

Pa marrë parasysh asnjë fakt, ndaj ankuesit është propozuar dhe marrë menjëherë masa disiplinore e largimit nga puna, pa marrë parasysh nëse ka qenë apo jo rast i përsëritur. Për të përmbushur këtë detyrim, punëdhënësi ka konsideruar si rast të përsëritur një masë e cila ishte parashkruar;

Nga aktet e administruara evidentohet se qëllimi i punëdhënësit ka qenë të largojë ankuesin nga puna, duke gjetur arsye të paargumentuara dhe të pambështetura në prova.

Komisioneri konstatoi se largimi i ankuesit nga pozicioni i punës si Specialist i Zyrës me Një Ndalesë në Njësinë Administrative Macukull, nuk ka ardhur për arsye të justifikuara. Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, vërehet se nga Bashkia Mat, ka patur edhe punonjës të tjerë të larguar nga puna të cilët kanë pretenduar largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat për shkak të bindjes politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit J.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Mat.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Mat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

19. A.L., kundër Bashkisë Lezhë

VENDIM NR. 26, DATË 24.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Lezhë në pozicionin Drejtorit të Arsimit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve. Kryetari i ri i Bashkisë Lezhë ka diskriminuar ankuesin, në të drejtën për punësim, duke e transferuar atë në një tjetër pozicion pune e më pas duke e larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Subjekti ankues, bazuar në vendimin e Bashkisë Lezhë, në vitin 2016, është emëruar në detyrën e Drejtorit të Arsimit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, të cilën e ka ushtruar deri më 2019. Me tej, me vendimin “Për transferim në detyrë”, ankuesi është emëruar Përgjegjës i Sektorit të Arsimit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Arsimit dhe Rinisë, pranë Bashkisë Lezhë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në 2021. Mbështetur në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të emërimit të tij në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Karta Social Evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se:

Transferimi i ankuesit nga pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Arsimit dhe Rinisë, ka nisur pak kohë pas emërimit të kryetarit të Bashkisë Lezhë;

Më pas, pa arsye të justifikuara, është larguar nga detyra pa shkaqe objektivist të justifikuara, duke u trajtuar në mënyrë të pafavorshme në raport me drejtuesit e drejtorive të reja të sapoformuara;

Është bërë largimi i ankuesit nga detyra me justifikimin e emërimit në paligjshmëri të tij, ndërkohë që anëtarë të Partisë Socialiste të Shqipërisë, kanë vijuar marrëdhëniet e punës normalisht edhe pse kanë qenë në të njëjtat kushte me të;

Procedurat e largimit të ankuesit nga puna kanë ardhur gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, në shkelje të Kodit Zgjedhor;

Nga aktet e administruara evidentohet se qëllimi i punëdhënësit ka qenë të largojë ankuesin nga puna, duke gjetur arsye të paargumentuara dhe të pambështetura në prova;

Komisioneri konstatoi se largimi i ankuesit nga puna, nuk ka ardhur për arsye të justifikuara. Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, vërehet se nga Bashkia Lezhë, ka patur edhe punonjës të tjerë të larguar nga puna të cilët kanë pretenduar largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se A.L., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Lezhë, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjes politike të tij.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit A.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Lezhë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Lezhë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

20. K.K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

VENDIM NR. 85, DATË 16.05.2022

Shkaku: Bindjet politike dhe aktiviteti politik i motrës së tij

Forma: Në formën e shoqërimit

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është larguar nga detyra që mbante pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të bindjeve politike, menjëherë pasi është bërë publik fakti se e motra, është emëruar në funksionin e Kryetares së LSI-s dhe ka kandiduar për deputete në zgjedhjet parlamentare, për këtë subjekt politik, për Qarkun e Durrësit.

FAKTET

Ankuesi, ka filluar punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve më 2016 dhe ka mbajtur detyrën e Inspektorit në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior në DPT.

Mbështetur në denoncimin e një qytetari të paignifikuar, nëpërmjet kontaktit telefonik, është kontaktuar Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, dhe është pretenduar se inspektori K.K., abuzon me detyrën. Për këtë, ndaj K.K., është iniciuar nga punëdhënësi procedim disiplinor, me pretendimin se në cilësinë e përgjegjësit të grupit ka kryer shkeljet e pretenduara nga qytetari. Ndërkohë, kjo përgjegjësi i është ngarkuar me të vetmin synim për ta larguar nga puna, pasi edhe pse ka qenë në të njëjtat kushte me të paktën një prej kolegëve, vetëm ndaj tij është marrë masë disiplinore e largimit nga puna, për shkak të bindjeve politike. Kjo, ka ardhur menjëherë pasi është bërë publik fakti se e motra, është emëruar në funksionin e Kryetares së LSI-s dhe ka kandiduar për deputete në zgjedhjet parlamentare, për këtë subjekt politik, për Qarkun e Durrësit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Social Evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar faktit se procedimi disiplinor ndaj ankuesit, ka nisur pak kohë pas bërjes publike të faktit që e motra e ankuesit është emëruar Kryetare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për qarkun e Durrësit dhe duke qenë se në raport me punonjësit e tjerë, për të njëjtat sjellje, vetëm për ankuesin është propozuar masa disiplinore e largimit nga puna, pa marrë parasysh vlerësimin vjetor të punës apo faktin nëse ka patur masa disiplinore të tjera në fuqi, Komisioneri krijoi dyshimin e arsyeshëm se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahasuar me

kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore.

Ndërkohë, për të justifikuar trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore, DPT pretendoi se shkak i largimit nga puna të ankuesit ka qenë mospërmbushja e detyrave funksionale në cilësinë e përgjegjës të grupit, fakt i cili nuk u konstatua dhe nuk u provua në asnjë moment gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës që ankuesi të ketë mbajtur në ndonjë moment këtë pozicion pune, atë të përgjegjës të grupit.

Nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i kanë ardhur menjëherë pasi është bërë publik fakti se e motra, është emëruar në funksionin e Kryetares së LSI-s dhe ka kandiduar për deputete në zgjedhjet parlamentare, për këtë subjekt politik, për Qarkun e Durrësit.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se K.K., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjeve dhe aktivitetit politik të motrës së tij.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit K.K., në të drejtën për punësim, *në formën e shoqërimit*, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të motrës së tij, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

21. D.B., kundër Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

VENDIM NR. 13, DATË 11.01.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Nuk janë dhënë rekomandime

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim pasi lirimi nga detyra ka lidhje të drejtpërdrejtë me bindjet e tij politike, pasi ai ka marrë pjesë në mbledhjet e kryesisë së një force politike, si dhe shpeshherë është shfaqur në kronikat e edicionit të lajmeve në mbledhjet e kryesisë së kësaj force politike.

FAKTET

D.B., është emëruar në detyrën e specialistit (inspektor), në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së. Marrëdhënia e punës rregullohej nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës me afat të caktuar (3 muaj), Në vijim D.B. lirohet nga detyra, me motivacion moskryerje të detyrave pa shkaqe të arsyeshme. Ankuesi sqaron se në datën 27.06.2020 (ditë e shtunë) ka qenë në detyrë, si dhe ka marrë pjesë në takim të realizuar nga Ministri i Brendshëm në Bulqizë, takim në të cilin ka qenë e pranishme edhe Kryeinspektorja e IKMT-së. Në datën 29.06.2020 (ditë e hënë), pas komunikimit paraprak me Përgjegjësën e Sektorit ku punonte, D.B., e mori ditë pushimi. Një fakt i tillë është përdorur nga IKMT, si motivacion për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Ankuesi ka marrë pjesë në mbledhjet e kryesisë së një force politike, si dhe shpeshherë është shfaqur në kronikat e edicionit të lajmeve në mbledhjet e kryesisë së kësaj force politike.

Ankuesi, në asnjë moment, nuk ka kryer një shkelje të rëndë të përsëritur të detyrimeve kontraktore apo të atyre të parashikuara në legjislacionin në fuqi, përkundrazi të gjitha detyrat i ka kryer me korrektësi.

Në këtë kontekst, ankuesi pretendon diskriminim për shkak të bindjes politike nga ana e IKMT-së.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimit të GJEDNJ, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012);
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e IKMT, pasi atij i është zgjidhur kontrata e punës me afat të caktuar, para plotësimit të këtij afati, pa motivacion të provuar. Ankuesi është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme dhe duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar observacionet e tij, lidhur me shkeljet që IKMT pretendon se ai ka kryer. Sikurse është përmendur edhe më sipër, shkeljet e z. D.B. nuk rezultojnë të evidentuara dhe të dokumentuara në asnjë akt administrativ të IKMT-së Tiranë.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike. KMD ka krijuar dyshimin e arsyeshëm që lirimi i tij nga detyra ka motive të

ndryshme nga ato të përcaktuara në urdhërin e lirimit nga detyra dhe IKMT në cilësinë e subjektit që ka barrën e provës i takon të vërtetojë të kundërtën.

Komisioneri çmon se fillimisht IKMT në nivel qendror nuk ka patur dijëni mbi bindjet politike, të djathta të ankuesit dhe ka kryer emërimin e tij në pozicionin e specialistit (inspektor) në Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, në Drejtorinë Rajonale Dibër, të IKMT-së. Në datën 30.06.2020, ankuesi ka marrë pjesë në mbledhjen e kryesisë së subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë. Kjo mbledhje është pasqyruar në median televizive lokale dhe në një televizion kombëtar. Vetëm 8 ditë pas kësaj mbledhjeje, ankuesi është liruar nga detyra, nëpërmjet Urdhrit të Kryeinspektorit, me motivacion “moskryerje e detyrave pa shkaqe të arsyeshme”.

Komisioneri gjykon se në kushtet kur Bulqiza, që është edhe vendbanimi i ankuesit është një qytet i vogël⁷, me numër të vogël banorësh⁸, është mëse e kuptueshme që bindjet politike të ankuesit të jenë të njohura nga banorët e tjerë, aq më tepër kur aktiviteti politik i D.B., është bërë evident edhe në mediat televizive. Përcjellja e informacionit mbi këto bindje politike pranë IKMT-së në nivel qendror, ka ndikuar në marrëdhënien e punësimit të D.B.

Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove nga të dyja palët, Komisioneri ka konstatuar se shkeljet e këtij punonjësi dhe “shkaqet e arsyeshme” që janë cituar si motivacion i lirimit të tij nga detyra nuk janë të dokumentuara në asnjë akt zyrtar të IKMT-së.

IKMT nuk i ka bërë të ditura Komisionerit se cilat janë këto shkelje që ka kryer D.B., dhe cilat janë provat që vërtetojnë këto shkelje. KMD ka konstatuar se lirimi nga detyra i ankuesit nga ana e Kryeinspektorit është kryer në mënyrë të menjëherëshme dhe pa zbatuar asnjë nga procedurat e përcaktuara në nenin 89 të Rregullores së Brendshme të IKMT-së, ndërkohë që “shkaqet e arsyeshme” nuk janë të dukshme dhe të arsyetuara.

Komisioneri gjykon se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës nuk motivohet nga shkaqe të arsyeshme, të provuara dhe faktike. Njëkohësisht duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike, si dhe duke patur parasysh se IKMT, që është edhe subjekti që ka barrën e provës në këtë proces administrativ, në asnjë rast, nuk ka arritur të provojë se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë apo të justifikojë se ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, por ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv, Komisioneri del në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës së D.B., është kryer për motive politike.

Komisioneri gjykoj se D.B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e IKMT.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të D.B., për shkak të bindjes politike, nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

⁷ Sipërfaqja e qytetit të Bulqizës është 678.51 km²

⁸ Numri i banorëve është 40.223;

22. A.K.,⁹ kundër OSHEE sh.a.

VENDIM NR. 233, DATË 22.12.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

A.K., është diskriminuar për shkak të bindjes politike në formën e shoqërimit, nga shoqëria OSHEE sh.a duke iu ndërprerë marrëdhëniet e punës.

FAKTET

Rezulton se ankuesi ka filluar punë pranë KESH, Zona e Shpërndarjes Shkodër, në datën 25.01.2006, e në vijim në datën 07.02.2008, ka kaluar në pozicionin e specialistit të përpunimit të të dhënave pranë OSSH sh.a. Zona Shkodër. Në datën 01.10.2010, ankuesi ka kaluar në pozicionin e specialistit pranë CEZ Shpërndarje Shkodër. Në vijim, A.K., ka mbajtur pozicione të ndryshme pune pranë kësaj shoqërie. Në datën 01.01.2020, ai është emëruar në pozicionin data analist pranë OSSH sh.a., Shkodër, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në datën 08.04.2022.

Rezulton se nëpërmjet shkresës Nr. 2605/1, datë 30.03.2022, të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) ankuesi A.K., është njoftuar për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, në mënyrë të menjëherëshme me motivacion *“thyerje e disiplinës në punë”*, duke mos u paraqitur në vendin e punës në datat 07.03.2022, 08.03.2022 dhe 09.03.2022, pa shkaqe të arsyeshme dhe pa vënë në dijeni eprorët, evidente kjo në listëprezencën e vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Shkodër”.

Në shkresë kërkohet që ankuesi duhet të paraqitet në datën 04.04.2022, ora 12:15 pranë OSSH sh.a. për të shprehur pretendimet e tij, lidhur me arsyet e fillimit të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Ankuesi A.K., ka refuzuar nënshkrimin në këtë shkresë.

Rezulton se ankuesi ka paraqitur observacionet e tij zyrtarisht (nëpërmjet shërbimit postar) pranë OSSH sh.a., Drejtoria Rajonale Shkodër dhe me e-mailin e datës 01.04.2022 pranë OSSH sh.a., në Tiranë. A.K., pretendon se është paraqitur në takimim e datës 04.04.2022, por nuk është pranuar në të. Referuar procesverbalit të takimit të datës 04.04.2022, të zhvilluar pranë OSSH sh.a., në Tiranë rezulton se ankuesi nuk ka nënshkruar në të, pra ka qenë në mungesë dhe në këtë procesverbal është shtuar motivacioni i largimit nga puna. Kështu, përpos thyerjes së disiplinës në punë për datat e sipërcituara, referuar Procesverbalit nr. 2605/2, datë 04.04.2022, rezulton se A.K., akuzohet se ka thyer rëndë Kodin e Etikës dhe Sjelljes, pasi në datën 25.03.2022, rreth orës 11:00, punonjësi ka ardhur për të komunikuar me Drejtorin Rajonal për problemin e masës disiplinore të dhënë ndaj tij dhe ka dalë jashtë kornizave të komunikimit. Referuar dokumentacionit të

⁹ Përfaqësuar me Prokurë të Posaçme Nr. Rep., 852, Nr. Kol., 286, datë 22.04.2022, nga Av. Artan Broci.

depozituar në cilësi prove rezulton se A.K., nuk është njoftuar asnjëherë më parë lidhur me një gjë të tillë. Njëkohësisht, ankuesi e kundërshton faktin se ka patur thyerje të etikës si pasojë e komunikimit jo të mirë me eprorin e tij, pasi në datën 25.03.2022, ai nuk është paraqitur në punë, pasi ka qenë në gjendje shëndetësore jo të mirë, fakt që vërtetohet nëpërmjet raportit të paaftësisë së përkohshme në punë Nr. Regj., 2049, Seria A/1, datë 21.03.2022, të lëshuar nga Instituti Shëndetësor nr. 3, Shkodër, ku rezulton se A.K., ka qenë me paaftësi të përkohshme në punë përgjatë datave 21 - 28.03.2022. Raporti i sipërcituar është njohur nga punëdhënësi dhe është i reflektuar në aktin “Zarfi i pagës”, datë 31.03.2022, për A.K.

Mbështetur në përmbajtjen e Procesverbalit Nr. 2605/2, datë 04.04.2022, të mbajtur pranë OSSH sh.a. rezulton se asnjë nga kundërshtimet e A.K., të cilat janë dërguar me e-mail në datën 01.04.2022, në adresë të personave përgjegjës pranë shoqërive OSHEE sh.a., dhe OSSH sh.a., nuk janë marrë parasysh dhe nuk kanë gjetur reflektim në të. Në observacionet e ankuesit kërkohet që për të vërtetuar prezencën e tij në punë në datat 7, 8 dhe 9 mars 2022 mund të shiheshin pamjet filmike të nxjerra nga kamera e sigurisë së Illyrian Guard sh.a.,¹⁰ sikurse edhe të verifikohej informacioni që mund të nxirrej nga sistemi online i OSSH sh.a., Drejtoria Rajonale Shkodër, ku rezulton puna e kryer nga ana e tij për këto ditë. Ai ka sqaruar se për të patur akses në këtë sistem, i cili është i monitoruar dhe on line, duhet të futej kodi i tij personal, të cilin e disponon vetëm ankuesi. Ai ka sqaruar se ka hyrë në sistem dhe ka punuar ato ditë, për të cilat pretendohet se ka munguar.

Paraprakisht, A.K., ka shkëmbyer e-maile në datat 31.03.2022 e në vijim me Illyrian Guard sh.a., ku ka kërkuar të administrojë pamjet filmike të kamerave të tyre të sigurisë, për të vërtetuar prezencën e tij në punë. Shoqëria e sipërcituar e ka informuar se: *“...pamjet filmike të cilat ju kërkonit i përkasin institucionit të Drejtorisë Rajonale Shkodër OSSH sh.a., dhe shoqëria Illyrian Guard sh.a. përpunon imazhet e tyre me qëllim ofrimin e shërbimit të sigurisë dhe publikimi ose shpërndarja e këtyre imazheve do të cënonte kontratën e shërbimit të lidhur midis dy institucioneve. Për t’u pajisur me pamjet filmike të cialt ju kërkonit, ju lutem drejtohuni Drejtorisë rajonale Shkodër OSSH sh.a.”*

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollit 12 i saj);
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: *“Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar”*;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- *“Karta Sociale Evropiane”* e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;

¹⁰Shoqëria Illyrian Guard sh.a., ka lidhur kontratë shërbimi dhe ofron shërbimin e sigurisë së objekteve për Drejtorinë Rajonale Shkodër të OSHSH sh.a., dhe FSHU sh.a.

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Bazuar në rezultatet e hetimit administrativ rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e OSSH sh.a., përsa i takon procedurës së ndjekur për largimin e tij nga puna, si dhe shkaqeve mbi të cilat i është zgjidhur marrëdhënia e punës.

Ankuesi dhe bashkëshortja e tij janë anëtarë të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë. Referuar librezës së anëtarësisë të lëshuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Shkodër, rezultoi se ankuesi është anëtar i kësaj force politike si dhe bashkëshortja e ankuesit A.K., është gjithashtu anëtare e kësaj force politike. Referuar vërtetimit të lëshuar nga Partia Demokratike Dega Shkodër për S.K., rezultoi i pasqyruar me hollësi aktiviteti i saj politik pranë kësaj forcë politike.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se OSSH/OSHEE sh.a., në asnjë rast nuk i ka të provuara shkeljet e kryera nga ankuesi A.K., të cilat ose duhet të jenë shkelje të rënda ose shkelje të lehta në mënyrë të përsëritur, në referencë të nenit 153 të Kodit të Punës, në kushtet kur lirimi i tij nga detyra është bërë në mënyrë të menjëherëshme. Lidhur me shkeljen e pretenduar për mungesë të paarsyeshme në punë në datat 7, 8, dhe 9 mars 2022, rezultoi se punëdhënësi nuk ka zhvilluar një proces të drejtë dhe transparent, për sa kohë që nuk ka marrë parasysh observacionet e dërguara nga ankuesi me e-mail në datën 01.04.2022, ku theksoheshin kërkesat e tij për të kryer verifikime të mëtejshme në lidhje me këto mungesa, të cilat mohohen të jenë kryer nga ana e tij. Ndërkohë që, për shkeljen e dytë të pretenduar nga punëdhënësi, atë të thyerjes së etikës si pasojë e komunikimit jo të mirë me eprorin e tij, në datën 25.03.2022, A.K., nuk është njoftuar asnjëherë paraprakisht nga punëdhënësi dhe nuk ka patur mundësi të parashtrijë observacionet e tij, ku të vërë në dukje faktin se në datën 25.03.2022, ai ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë e në këto kushte ai nuk ka qenë prezent në punë dhe nuk ka qenë e mundur, që ai të kishte patur konflikt verbal me eprorin e tij. KMD gjykon se procedimi i zhvilluar nga punëdhënësi nuk ka patur qëllim zbardhjen e së vërtetës dhe verifikimin e çështjes, por lirimin nga detyra të ankuesit A.K., pavarësisht fakteve që mund të zbardheshin.

Në analizë të gjithë sa më sipër, në rastin konkret, KMD doli në përfundimin se lirimi nga detyra i ankuesit A.K. është bërë pa shkaqe ligjore të justifikuara. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës/marrëdhënies së punës që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës së A.K., OSSH/OSHEE sh.a., nuk depozitoi asnjë nga provat e kërkuara nga Komisioneri dhe nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, edhe pse kishte barrën e provës në këtë proces. Një fakt i tillë i është bërë e ditur zyrtarisht nga ana e KMD-së. Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara.

OSHEE sh.a. është shoqëri ku 100% të aksioneve i zotëron Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës. OSSH sh.a. është shoqëri bijë e OSHEE sh.a., ku edhe aksionet e saj zotërohen nga institucioni i sipërcituar, që është pjesë e qeverisë aktuale, që drejtohet nga përfaqësuesit e subjektit politik në pushtet, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se gjatë hetimit administrativ, nga ana e OSSH sh.a., nuk u arrit të provohej që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar, që është bindja politike, (mbi pretendimin e ankuesit për diskriminim në formën e shoqërimit) dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm të A.K.

Për sa më sipër, KMD krijoi bindjen se zgjidhja e marrëdhënies së punës së A.K., me OSSH sh.a., ka qenë pasojë e aktivitetit politik të bashkëshortes së tij dhe ai është diskriminuar nga ky subjekt për shkak të bindjes politike, në formën e shoqërimit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike, në formën e shoqërimit, të A.K., nga ana e OSSH sh.a.
- Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të bindjes politike, në formën e shqetësimit, veçimit dhe viktimizimit, të A.K., nga ana e OSSH sh.a.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, OSSH sh.a., të marrë masa për të rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

23. F.J., kundër Bashkisë Vau i Dejës dhe Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.

VENDIM NR. 143, DATË 19.07.2022

Shkaku: Bindjet Politike
Forma: Udhëzimit për Diskriminim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është larguar nga puna për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

FAKTET

F.J., ka punuar pranë Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a., në pozicionin e lexuesit të aparateve matëse. Marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës të lidhur ndërmjet punëdhënësit F.J., dhe Administratorit të kësaj shoqërie.

Ankuesi është njoftuar për takim për të diskutuar mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së punës. Në vijim të takimit, ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës. Referuar shkresës, rezulton se zgjidhja e kontratës së punës është kryer me motivacion *“moskryerje rigoroze e detyrave sipas nenet 4 dhe 16 të kontratës së punës”*.

Ankuesi pretendon se largimi nga puna ka lidhje të drejtpërdrejtë me bindjen e tij politike, pasi ai është anëtar i subjektit politik *“Partia Demokratike”*. F.J., sqaron se pas ardhjes në detyrë të Kryetarit aktual të Bashkisë Vau i Dejës, i cili është përfaqësues i Partisë Socialiste, ky i fundit ka filluar një fushatë spastrimi ndaj punonjësve, që janë anëtarë të Partisë Demokratike. Këto largime, sipas ankuesit, kanë ardhur pas zëvendësimit të Administratores së Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës, me administratorin aktual. F.J., sqaron se largimin e tij nga puna e ka kundërshtuar gjyqësisht dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është shprehur në favor të tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.);
- *“Karta Sociale Europiane”* e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹¹ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- *“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”*¹²;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar);
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri konstatoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike, Seksioni Hajmel, Dega Vau i Dejës.

Ndërprejra e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për shkaqe të arsyeshme, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se UK Vau

¹¹ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹² Ratifikuar me Ligjin Nr. 7511 datë 08.08.1991

i Dejës, deklaroi motivacione të pambështetura në prova e fakte, si dhe deklaroi shkaqe të tjera, të ndryshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar, aktivist dhe pjesë e strukturave drejtuese të subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që UK Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi relativisht të vogël në numër, siç është qyteti i Vau i Dejës¹³, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri-tjetrin, lidhje shoqërore, krushqie e farefisnore, si dhe të kenë dijeni edhe lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Subjekti ankues ka provuar e dokumentuar bindjet dhe angazhimin e tij politik në këtë subjekt (PD), si dhe faktin që është pjesë e strukturave drejtuese të këtij subjekti që nga 2008 e aktualisht. Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit, UK Vau i Dejës, në dëm të subjektit ankues kanë ardhur pas ndërrimit të titullarit të Shoqërisë, pas zgjedhjeve vendore 2019, vetëm 1 (një) muaj pasi ka marrë drejtimin e UK Vau i Dejës.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, duke vërtetuar që largimi nga puna është kryer për motive politike. Në këto kushte punëdhënësi kishte barrën e provës që të provonte ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e UKVD, i vetmi shpjegim për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar prej tij, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “*udhëzimit për diskriminim*” të ankuesit F.J., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës.
- Në referim të pikës 1, UK Vau i Dejës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

¹³ Të dhënat e marra nga faqja zyrtare: <http://www.vaudejes.gov.al/rreth-nesh/> referojnë se Bashkia Vau i Dejës përbëhet nga 6 njësi administrative, në të cilat përfshihet dhe Vau i Dejës, me rreth 13 035 banorë.

24. D.K., kundër Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njesisë Administrative Lis

VENDIM NR.67, DATË 08.04.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja D.K., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja ka filluar punë pranë Bashkisë Mat më datë 01.07.2016, në pozicionin e specialistes së kadastrës të tokës bujqësore, pranë Njesisë Administrative Lis. Ankesja është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin specialiste e kadastrës së tokës bujqësore pranë Njesisë Administrative Lis, Bashkia Mat. Rezulton se marrëdhëniet e punës midis ankuseses dhe Bashkisë Mat kanë vijuar normalisht dhe ndaj saj nuk rezulton që të jenë marrë masa disiplinore apo vlerësim negativ në lidhje me performancën e saj në punë.

K.M, Administrator i Njesisë Administrative Lis, në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë, ka bërë vlerësimin e performancës në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, ku ankuesja është vlerësuar me nivelin më të ulët të vlerësimit 4, “Jo kënaqshëm”. Gjatë muajve mars dhe prill 2020, që shënojnë kulmin e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ankuesja është paraqitur çdo ditë në punë, duke udhëtuar nga qyteti i Burrelit, ku ajo është banuese, për në vendin e saj të punës në Njësine Administrative Lis. Në vijim, me vendimin të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mat, ankuesja është transferuar përkohësisht për një periudhë 3 mujore duke filluar nga data 13.07.2020 deri në 13.10.2020, për përmirësimin e rezultateve në punë, në pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësine Administrative Rukaj, Bashkia Mat.

Ndaj ankuseses ka filluar procedimi disiplinor për shkak se ajo nuk ka zbatuar dy urdhra të Kryetarit të Bashkisë. Në përfundim të procesit disiplinor, Komisioni Disiplinor (KD), ka vendosur: “*Marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil për nëpunësen civile znj. D.K me detyrë Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njesisë Administrative Lis, Bashkia Mat*”. Me urdhrin Nr. 54, datë 05.02.2021 “*Për dorëzim detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë Mat, marrëdhëniet financiare kanë përfunduar në datë 12.02.2021.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, duke u ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm: *së pari*, trajtimin e saj gjatë marrëdhënieve të punës, duke përfshirë vlerësimin e rezultave në punë për 6 mujorin e dytë të 2019, kushtet e punës në kulmin e pandemisë, veçanërisht gjatë muajve mars dhe prill dhe transferimin e përkohshëm 3 mujor në Njësine Administrative

Rukaj; dhe *së dyti*, në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të punës dhe largimin nga shërbimi civil.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollu 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji nr. 152/2013 “*Për statusin e nëpunësit civil*”, të ndryshuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Rezultoi se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë marrëdhënieve të punës, duke përfshirë vlerësimin e rezultave në punë për 6 mujorin e dytë të 2019, kushtet e punës në kulmin e pandemisë Covid 19, gjatë muajve mars dhe prill dhe transferimin e përkohshëm 3 mujor në Njësinë Administrative Rukaj, deri në përfundimin e marrëdhënieve të punës dhe marrjen e masës disiplinore për largimin nga shërbimi civil. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankueses dhe fakti se Bashkia Mat, ka patur dijeni për bindjet politike të ankueses.

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimit, të cilat u provuan gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se:

Administratori i Njësisë Administrative Lis, K.M., i cili është emëruar në detyrë në datë 21.10.2019 ka kryer vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, në datën 11.01.2020. Nuk rezultoi e provuar që të jenë bërë përpjekje për të marrë vlerësimin nga ana e ish Administrorit të mëparshëm, U.K., i cili është larguar nga puna në të njëjtën datë dhe ka qenë zyrtari në detyrë për periudhën korrik-21.10.2019. Gjithashtu, megjithëse ka qenë në dijeni për Raport Auditimin (Përfundimtar) të datës 18.12.2020, i mbajtur nga strukturat audituese të bashkisë Mat, Administratori nuk ka mbajtur në konsideratë konstatimet e bëra në këtë raport lidhur me ushtrimin e detyrës nga ana e ankueses për periudhën gjatë të cilës ai nuk ka qenë në detyrë. Administratori i Njësisë Administrative Lis, ka vlerësuar rezultate në punë të ankueses me vlerësimin më të ulët “jo kënaqshëm” për 6 mujorin e dytë të 2019 duke qenë në pozicionin e zyrtarit raportues vetëm në dy muajt e fundit të 2019.

Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat, në cilësinë e zyrtarit konfirmues/autorizues, ka kryer rishikimin e vlerësimit në punë të ankueses pa i dhënë asaj mundësinë që të dëgjohet në lidhje me pretendimet e saj. Bashkia Mat nuk provoi pretendimet se ankuesja nuk kishte pranuar të

bashkëpunonte, për sa kohë nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me faktin se si ishte njoftuar ajo në lidhje me këtë proces. Rezultoi e provuar se, ankuesja nuk ka marrë dijeni në lidhje me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.

Vlerësimi i rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të 2020, është bërë në kundërshtim të plotë me parashikimet ligjore në fuqi dhe ankuesja në asnjë fazë të procesit nuk është bërë me dijeni. Pretendimet se ankuesja nuk ka bashkëpunuar nuk rezultuan të provuara. I takon Administratorit të Njesisë Administrative Lis dhe Bashkisë Mat, të provojnë se kanë respektuar procedurën e vlerësimit dhe kanë njoftuar ankuesen. Ankueses i është mohuar e drejta për të kundërshtuar vlerësimin e punës, pasi ajo nuk ka patur dijeni.

Bashkia Mat pretendoi, por nuk arriti të provojë asnjë nga rastet e punonjësve që sipas saj ndodhen në kushte të ngjashme me ankuesen dhe janë paraqitur çdo ditë në punë gjatë periudhës mars-prill 2020, në kushtet e emergjencës së shkaktuar nuk rezultoi i provuar, duke mbetur në nivel deklarativ nga ana e Bashkisë Mat.

Aryesja e transferimit për të përmirësuar rezultatet në punës, përbën një arsye të ligjshme për transferimin e përkohshëm të një nëpunësi civil. Arsyeja e transferimit nuk duhet të jetë e ligjshme vetëm formalisht, por duhet të provohet. Performanca e dobët në punë e ankueses e pretenduar nga ana e bashkisë, nuk rezultoi e provuar, pasi vlerësimet që i janë bërë ankueses nuk mund të shërbejnë si një tregues objektiv i performancës jo të mirë në punë të ankueses, pasi nuk janë kryer sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Për rrjedhojë transferimi i përkohshëm i ankueses në Njësinë Administrative Rukaj është i pabazuar.

Transferimi i ankueses në Njësinë Administrative Rukaj përkeqësoi kushtet e punës së ankueses, pasi kjo njësi ndodhet në një distancë më të largët se Njësia Administrative Lis dhe nuk rezultoi e provuar që ka transport.

Transferimi i ankueses është bërë për arsye të përmirësimit të performancës në punë, që do të thotë se përzgjedhja e vendit të punës ku ankuesi do të transferohet për të përmirësuar rezultatet e tij në punë duhet të jetë i tillë që të garantojë këtë qëllim të synuar nëpërmjet transferimit. Referuar propozimit që Sekretari i Përgjithshëm ka bërë për Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, ai shprehet se ankuesja ka një performancë jo të kënaqshme dhe ka nevoja emergjente që banorët e Njesisë Administrative Lis të marrin shërbime cilësore. Ankuesja është transferuar nga një njësi administrative në një tjetër njësi administrative të Bashkisë Mat, dhe kjo e fundit nuk ofroi asnjë shpjegim se përse vendi i punës ku ankuesja u transferua do të garantonte përmirësimin e saj në punë për sa kohë që arsyeja e transferimit është përmirësimi i rezultateve në punë të ankueses. Nevoja për ofrimin e shërbimeve cilësore për banorët e Njesisë Administrative Lis, jo vetëm që bie në kundërshtim me arsyen e transferimit, por edhe me faktin se Bashkia Mat nuk shqetësohet në lidhje me cilësinë e shërbimeve që do të marrin banorët e Njesisë Administrative Rukaj ku transferohet ankuesja. Komisioneri vlerëson se arsyetimet e Bashkisë Mat janë kontradiktore.

Referuar Planit të Mobilitetit të vitit 2020, të depozituar nga Bashkia Mat, asnjë nga nëpunësit e tjerë të transferuar nuk ndodhet në të njëjtat kushte me ankuesen, pasi ajo është e vetmja që është

transferuar për përmirësimin e rezultateve në punë, ndërsa nëpunësit e tjerë civilë janë transferuar për nevoja të institucionit.

Faktet e pretenduara për moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Mat, nuk përbëjnë mospërbushje të rëndë të detyrave dhe haptazi në mënyrë të pabazuar, është kualifikuar si shkelje shumë e rëndë, sipas nenit 57/2/a, të Ligjit Nr.152/2013. Kualifikimi i fakteve të pretenduara si shkelje shumë e rëndë, ka si të vetmen pasojë masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil, ndryshe nga kualifikimet e tjera të shkeljeve të cilat parashikohet dhënia e masave më të lehta disiplinore. Marrja e masës më të rëndë disiplinore të parashikuar nga ligji, për largim nga shërbimi civil të ankueses, duke e cilësuar moszbatimin e dy urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Mat si mospërbushje e rëndë e detyrave, është në çënim të parimit të proporcionalitetit.

Të gjitha konstatimet e mësipërme kanë ndodhur pas marrjes së detyrës nga Kryetari i ri i Bashkisë Mat, i zgjedhur në zgjedhjet vendore të qershorit 2019 dhe emërimit të Administratorit të Njesisë Administrative Lis, K.M, në fund të muajit tetor 2019, emëruar pas largimit nga puna të administratorit të mëparshëm. Nuk rezultoi e provuar që përpara këtij momenti, ankuesja të ketë patur problematika në punë.

Pavarësisht ankesave të përsëritura të ankueses, se është duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike, Bashkia Mat në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 13, i LMD-së nuk mori asnjë masë për të trajtuar ankesat për diskriminim.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses D.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Mat dhe Administratorit të Njesisë Administrative Lis.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Mat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer ankuesen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Mat dhe Administratori i Njesisë Administrative Lis, duhet të ndalojnë çdo veprim diskriminues ndaj ankueses në të ardhmen.

25. T.M., kundër Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., (OSSH sh.a.)

VENDIM NR. 205, DATË 23.11.2022

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi T.M., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi T.M., ka qenë i punësuar si elektrikist pranë Shoqërisë OSSH sh.a. Ankuesi ka filluar punës në datën 24.03.1998 dhe pavarësisht transformimeve që ka pësuar kjo shoqëri ndër vite, ankuesi ka vijuar marrëdhënien e punës në mënyrë të pandërprerë pranë këtij punëdhënësi, deri në datën 24.04.2022, kur marrëdhëniet e tij të punës janë ndërprerë për shkak të marrjes së masës disiplinore. Në datë 23.03.2022, ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, në mënyrë të menjëhershme, sipas nenit 153 të Kodit të Punës për këto arsye: *“Moskryerje të detyrës funksionale, konkretisht ju nuk ishit duke kryer detyrat e caktuara nga eprori juaj sipas planit të përcaktuar me datë 08.02.2022 për verifikimin e kabinave dhe ngarkesave në kabinë, por ju ishit duke punuar për llogari të palëvetë tretë, evidente kjo në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Shkodër”*. Në datë 14.04.2022, ankuesit i është njoftuar zgjidhja përfundimtare e marrëdhënieve të punës.

Që prej vitit 2001, T.M., ishte anëtar i Partisë Demokratike (PD), fakt ky që rezultoi i provuar në bazë të kartës së anëtarësisë dhe vërtetimit, të lëshuar nga ky subjekt politik. Në bazë të vendimit të KMCAP Shkodër, Ankuesi T.M., është vlerësuar se përmbush kushtet për të përfituar invaliditet të pjesëshëm.

Shoqëria OSSH sh.a., është një shoqëri aksionare, e cila zotërohet nga aksionari i vetëm, Shoqëria OSHEE GROUP sh.a, kjo e fundit e zotëruar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (emërtimi aktual Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)), si aksionar i vetëm. Pavarësisht se punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a., është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pronari dhe zotëruesi i vetëm, është shteti, përfaqësuar nga MIE.

Ankuesi T.M., ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke e kundërshtuar arsyen e largimit nga puna si të pabazuar, dhe duke pretenduar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është mbështetës dhe anëtar i Partisë Demokratike (PD) dhe aftësisë së kufizuar, pasi ai është person me aftësi të kufizuara dhe gëzon statusin si invalid pune, me shkallë invaliditeti të pjeshme.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolle 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi T.M është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, nga ana e Shoqërisë OSS sh.a, se masa e marrë për largimin e tij nga puna është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, si dhe në shkelje të procedurës ligjore që duhet ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Nga ana tjetër rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit. Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “*aftësisë së kufizuar*”.

Në bazë të provave të administruara Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton të ketë një lidhje shkakësore midis trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe shkakut të aftësisë së kufizuar.

Në bazë të provave të administruara, si dhe kronologjisë së ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Ngjarja e pretenduar nga punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a., si shkelje dhe moskryerje e detyrave funksionale nga ana e ankuesit ka ndodhur në datën 08.02.2022;

Punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a., duke patur detyrimin që të provojë procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, përfshirë këtu edhe motivacionin dhe arsyen e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe pavarësisht se i’u dhanë të gjitha mundësitë për të paraqitur kundërshtimet në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, nuk provoi se zgjidhja e marrëdhënies së punës me ankuesin ka ndodhur për shkakun e pretenduar nga punëdhënësi;

Rezultoi e provuar bazuar në “Zarfin e pagës” për muajin shkurt 2022, se punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a, ka paguar rregullisht ankuesin me pagën për muajin shkurt 2022, për të cilin (ankuesin) nuk rezulton që të ketë patur ditë mungese në punë;

Pavarësisht se shkelja e pretenduar se është konsumuar nga ankuesi ka ndodhur në datën 08.02.2022, punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a., ka filluar procedurën për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin në datën 23.03.2022, pothuajse 1 muaj e gjysëm nga dita eshkeljes së pretenduar dhe pas procesit të zgjedhjeve vendore të zhvilluar në datën 06 mars 2022;

Në bazë të akteve të administruara lidhur me procedurën e ndjekur nga punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a për zgjidhjen e kontratës së punës, ankuesit nuk i është dhënë mundësia që të informohet dhe të njihet me provat në lidhje me shkeljen që i atribuohet, të dëgjohet dhe të mbrojtë të drejtat e tij në mënyrë efektive, lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës. Kjo përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara *krijojnë prezumimin* se, ankuesi T.M., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës, për shkak të bindjeve politike, nga OSSH sh.a. Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, punëdhënësi Shoqëria OSSH sh.a., *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet e tij nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, Shoqëria OSSH sh.a, mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të ankuesit, ose duke provuar semegjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës, është kryer për shkak të bindjeve politike.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, Shoqëria OSSH sh.a., jo vetëm që nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike, por ky subjekt, mbajti një qëndrim plotësisht pasiv gjatë procedurës, duke mos paraqitur asnjë shpjegim apo informacionin dhe dokumentacionin që i'u kërkua zyrtarisht nga Komisioneri. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Shoqërisë OSSH sh.a., i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin T.M., mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me Ligjin Nr. 10 221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi OSSH sh.a ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme largimi nga puna i ankuesit nuk është bërë për shkak të bindjeve politike ose se largimi është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit T.M., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërdarjes sh.a.

- Në referim të pikës 1, Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërdarjes sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer ankuesin T.M., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

III. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL

26. J.M., kundër Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., dhe P.K., Team Leader pranë Shoqërisë Fiber Group sh.p.k.

VENDIM NR. 144 , DATË 21.07.2022

Shkaku: Orientimi seksual
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë; Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi J.M., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, pasi i është cënuar e drejta për të patur një zgjidhje dhe mbrojtje efektive për pretendimet për diskriminim për shkak të orientimit seksual të paraqitura përpara punëdhënësit. Ankuesi është diskriminuar duke e viktimizuar për shkak të ankesës që ai ka paraqitur pranë punëdhënësit, ankesë e cila synon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të orientimit seksual.

FAKTET

Ankuesi J.M., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., me pozicion pune “Operator telefonik”. Ankuesi ka filluar punë pranë Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., në datën 08.09.2021 dhe marrëdhënia e punës është lidhur për një afat 6 (gjashtë) mujor. Në datë 03.12.2021, ankuesi është njoftuar nga punëdhënësi Fiber Group sh.p.k., për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për arsye se nuk ka kaluar afatin e provës.

Në datën 27.11.2021, ankuesi ka depozituar pranë burimeve njerëzore të shoqërisë Fiber Group sh.p.k., një ankesë, në të cilën pretendon përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual në vendin e punës nga ana e P.K., dhe punonjësit J.Q. Në vijim ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje me shkrim në lidhje me trajtimin e ankesës për diskriminim për shkak të orientimit seksual që kishte depozituar pranë punëdhënësit në datën 27.11.2021. Në datën 03.12.2022, ankuesi është njoftuar nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, pasi nuk kishte kaluar periudhën e provës.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, kundër P.K., duke pretenduar se ai ka përdorur kundrejt tij gjuhë urrejtje për shkak të orientimit seksual në vendin e punës dhe kundër punëdhënësit Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., e cila sipas ankuesit nuk ka marrë masa për të hetuar dhe trajtuar në mënyrë efektive ankesën e tij. Ankuesi pretendon se, zgjidhja e marrëdhënies së tij të punës nga ana e punëdhënësit është pasojë negative që ka ardhur për shkak të ankimit për diskriminim për shkak të orientimit seksual që ai ka paraqitur pranë punëdhënësit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimet e ankuesit lidhur me përdorimin e gjuhës së pretenduar si diskriminuese nga P.K., nuk u arritën të provoheshin për mungesë provash. Komisioneri vlerëson se, konkluzioni i mësipërm që në mungesë të provave nuk është e mundur që të arrihet në një konkluzion në lidhje me përdorimin ose jo të gjuhës së pretenduar diskriminuese nga ana e P.K., nuk e përjashton përgjegjësinë e punëdhënësit për diskriminimin e ankuesit në vendin e punës. Komisioneri gjykon se, edhe nëse do të kishte rezultuar i provuar pretendimi i ankuesit P.K., kishte përdorur gjuhë diskriminuese dhe e kishte shqetësuar atë në vendin e punës për shkak të orientimit seksual, Fiber Group sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit nuk do të mund të konsiderohej automatikisht përgjegjës në rast se, do të provohej se në cilësinë e punëdhënësit, shoqëria Fiber Group sh.p.k., ka marrë të gjitha masat për të trajtuar në mënyrë efektive ankesën për diskriminim të ankuesit.

Duke ju referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes, të cilat u provuan gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, shoqëria Fiber Group sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit, nuk arriti të provojë se ka trajtuar dhe hetuar në mënyrë efektive pretendimin për diskriminim për shkak të orientimit seksual të paraqitur me shkrim nga ankuesi në datën 27.11.2021. Prova e vetme e depozituar nga Fiber Group sh.p.k në lidhje me veprimet e ndërmarra për të verifikuar pretendimin për diskriminim të ankuesit është procesverbali i datës 01.12.2021, i cili është një akt i njëanshëm i punëdhënësit, i cili në mungesë të akteve shoqëruese, nuk provon procedurën e pretenduar se është ndjekur nga punëdhënësi për të verifikuar ankesën. Ky dokument nuk shoqërohet me akte që provojnë pyetjen e punonjësve të tjerë që kanë qenë prezent gjatë ngjarjes së kundërshtuar nga ankuesi dhe deklaratimet e tyre në lidhje me ngjarjen. Nuk rezultoi e provuar se në përfundim të procedurës së pretenduar se është ndjekur nga punëdhënësi për të shqyrtuar ankesën për diskriminim të datës 27.11.2021, punëdhënësi të ketë njoftuar ankuesin në lidhje me konkluzionet përfundimtare të arritura në përfundim të hetimit të realizuar nga zyra e burimeve njerëzore.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se punëdhënësi Fiber Group sh.p.k., nuk i është përgjigjur në mënyrë efektive ankimit për diskriminim në vendin e punës të paraqitur nga ankuesi. Nuk rezultoi e provuar që punëdhënësi Fiber Group sh.p.k., të ketë hetuar

në mënyrë efektive për të përlegjur në këtë mënyrë konkluzionin e arritur se pretendimet e ankuesit për shqetësim në vendin e punës nuk ishin të bazuara. Në këto kushte, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë Fiber Group sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit, pasi i është cënuar e drejta për të patur një zgjidhje dhe mbrojtje efektive për pretendimet për diskriminim për shkak të orientimit seksual të paraqitura përpara punëdhënësit.

Zgjidhja e kontratës së punës gjatë periudhës së provës nuk vendos detyrimin mbi punëdhënësin për të respektuar ndonjë procedurë, përveç afatit 5 ditor të njoftimit, apo për të deklaruar arsyen e zgjidhjes së kontratës. Megjithatë, në kushtet kur ankuesi, në cilësinë e punëmarrësit, pretendon se zgjidhja e kontratës gjatë periudhës së provës është pasojë negative e ankesës për diskriminim që ka paraqitur pranë punëdhënësit, ky i fundit ka detyrimin që të argumentojë të kundërtën, pra që zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkaqe të justifikuara. Gjatë shqyrtimit të ankesës shoqëria Fiber Group sh.p.k., deklaroi se shkak i zgjidhjes së kontratës së punës me ankuesin gjatë periudhës së provës, është performance jo e mirë në punë.

Komisioneri evidenton se, vlerësimi i performancës në punë duhet të hartohet sipas rregullave dhe procedurave të paracaktuara, mirëpërcaktuara dhe transparente, për të cilat punonjësit duhet të jenë plotësisht në dijeni. Bazuar të provat e administruara, rezulton se shoqëria Fiber group sh.p.k nuk e ka të rregulluar procedurën dhe kriteret e vlerësimit të performancës së punonjësve, në një akt të brendshëm të saj. Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Fiber Group sh.p.k., e cila kishte barrën e provës, nuk arriti të provonte se arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me ankuesin J.M., kishte si shkak performancën jo të mirë, pasi dështoi të provojë se vlerësimi i performancës në punë është hartuar sipas rregullave, kriterëve dhe procedurave të paracaktuara, mirëpërcaktuara dhe transparente.

Komisioneri vlerëson se një person që pretendon se është diskriminuar për shkak të “orientimit seksual”, nuk mund të detyrohet që të provojë me prova “orientimin seksual”, pasi një gjë e tillë do të cënonte dinjitetin njerëzor, por një gjë e tillë duhet të bazohet në vetëdeklarimin e personit. Komisioneri thekson se, mbrojtja nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, përfshin jo vetëm situatat kur ankuesi pranon se ka ose ka patur një orientimi të caktuar seksual, por edhe në ato raste kur ankuesi perceptohet nga të tjerët se i përket një orientimi të caktuar seksual.

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë punëdhënësit në datën 27.11.2021 dhe pa marrë ende një vendim lidhur me trajtimin e ankesës së tij, punëdhënësi ka njoftuar ankuesin në datën 03.12.2021 për zgjidhjen e kontratës së punës. Komisioneri vlerëson se, punëdhënësi duhet të kishte garantuar të drejtën e ankuesit për të vazhduar punën sipas parashikimeve kontraktuale, deri në përfundim të trajtimit të ankesës për diskriminim që ankuesi kishte depozituar në datën 27.11.2021 dhe kjo sjellje vjen në kundërshtim me nenin 15, të LMD.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se zgjidhja e kontratës së të punës me ankuesin, është trajtim i disfavorshëm dhe pasojë negative, që ka ardhur si reagim ndaj ankesës për diskriminim për shkak të orientimit seksual që ankuesi ka paraqitur në datën 27.11.2021. Në këto kushte shoqëria Fiber Group sh.p.k., kishte barrën e provës që të provonte ligjshmërinë e veprimeve të saj, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se mospagesa

e raportit mjekësor dhe zgjidhja e kontratës së punës janë pasojë negative dhe trajtim i disfavorshëm që ka ardhur si reagim ndaj ankesës për diskriminim për shkak të orientimit seksual. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm në lidhje me veprimet dhe mosveprimet ana e shoqërisë Fiber Group sh.p.k., i vetmi shpjegim për zgjidhjen e kontratës së punës, mbetet shkak i pretenduar i diskriminimit, orientimi seksual.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Fiber Group sh.p.k., e ka diskriminuar ankuesin duke e viktimizuar atë për shkak të ankesës që ai ka paraqitur pranë punëdhënësit në datën 27.11.2021, ankesë e cila synon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe për rrjedhojë Fiber Group sh.p.k., ka shkelur nenin 3, pika 17 dhe nenin 5, pika 1, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, Fiber Group sh.p.k., ka diskriminuar ankuesin, pasi në cilësinë e punëdhënësit nuk ka përmbushur detyrimin e tij për të mbrojtur nga diskriminimi ankuesin J.M., në cilësinë e punëmarrësit, duke dështuar që të trajtojë dhe të hetojë në mënyrë efektive ankesën për diskriminim për shkak të orientimit seksual të datës 27.11.2021.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit J.M., për shkak të orientimit seksual, në të drejtën për punësim, nga ana e Shoqërisë Fiber Group sh.p.k.
- Shoqëria Fiber Group sh.p.k., duhet të marrë masa për të rishikuar rregulloret dhe aktet e saj të brendshme në mënyrë që ato të parashikojnë procedura konkrete për trajtimin e ankesave për diskriminim që paraqiten nga punëmarrësi.
- Shoqëria Fiber Group sh.p.k., duhet të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për Ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të realizojë trajnime për punëmarrësit për të mundësuar kuptimin e plotë të ligjit.

IV. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

27. Qendra “T’Reja” kundër Këshillit të Ministrave

VENDIM Nr. 148, Datë 22.07.2022

Shkaku: Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

VKM-ja Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, diskriminon fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, duke i vënë në kushte të pafavorshme për shkak të gjendjes ekonomike.

FAKTET

Këshilli i Ministrave për t’u ardhur në ndihmë dhe për t’u siguruar shërbimin arsimor fëmijëve që u përkasin familjeve në nevojë dhe me të ardhura të pakta dhe për të ulur nivelin e braktisjes shkollore, si dhe për të mbështetur financiarisht disa kategori sociale të nxënësve në nevojë për të kryer shërbimin e detyrueshëm arsimor, ka miratuar VKM-në Nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Referuar VKM-së, fëmijët që vijnë nga shtresa më e varfër, që janë familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë të përfshirë në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, ndërkohë që janë parashikuar dhe kategori të tjera, jashtë kriterit ekonomik që përfitojnë bursë për rregjistrimin dhe ndjekjen e shkollës. Midis këtyre kategorive rezulton një ndryshim, pasi për nxënësit që trajtohen sipas kriterit ekonomik, janë vënë kushte shtesë për përfitimin e bursës, ndërsa nxënësit e tjerë e përfitojnë për shkak të statusit të tyre. Në mes të tjerash në këtë vendim, shteti për të ulur nivelin e braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare janë braktisës të shkollës, ka parashikuar trajtimin e këtyre nxënësve me bursë financiare, nga fondet e pushtetit qendror ose nga fondet e njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Sa më sipër, rezultoi se nxënësi sipas kriterit ekonomik, për të përfituar bursë, së pari duhet të ketë distancë nga vendbanimi dhe të akomodohet në konvikte publike, të braktisë shkollën dhe së dyti duhet të plotësojë kriterin ekonomik, që familja e tij/saj të jetë familje në nevojë/pamundësi financiare.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ka identifikuar se për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë duhet të sigurohet mirëqenia sociale, emocionale dhe fizike e të gjithë nxënësve, si dhe vijimi i mbështetjes me bursë nga shteti për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por që, në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerësoi se politikat shtetërore për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, duhet të jenë parandaluese.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës;
- *GJENNJ Çështjet Molla kundër Greqisë, Fábían kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Çështja Thlimmenos kundër Greqisë, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar;*
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012, “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 121/2016, “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, “*Për statusin e jetimit*”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996, “*Për statusin e të verbrit*”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000, “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019, “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10289, datë 17.06.2010, “*Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit*”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, “*Për statusin e invalidëve të punës*”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 18/2017 “*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*”;
- Vkm Nr. 666, datë 10.10.2019, i Këshillit të Ministrave “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”;
- VKM Nr. 866, datë 24.12.2019, ka miratuar *Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020-2023*;
- VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015, ka miratuar *Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020*;
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”.

KONKLUSIONE

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga MAS, rezultoi se, numri i nxënësve që kanë përfituar bursë mbështetje, sipas pikës 4 të VKM-së Nr. 666/2019, i ndryshuar, për vitin shkollor 2020-2021, ka qenë 141 bursa dhe për vitin shkollor 2021-2022 ka qenë 111 bursa, ndërsa rezultojnë se asnjë nga bashkitë, nuk ka miratuar bursë për mbështetje financiare, nga fondet e vetë bashkive, sipas parashikimit të pikës 5 të VKM Nr. 666/2019, të ndryshuar.

Në analizë të statistikave të mësipërme, nuk rezultojnë se politika e trajtimit me bursë të nxënësve braktisës, ka ndihmuar në uljen e braktisjes shkollore. Referuar po këtyre të dhënave, rezultojnë se janë trajtuar me bursë rreth 10% e nxënësve që rezultojnë braktisës. Pra një numër shumë i ulët i nxënësve, kanë përfituar mbështetje financiare për shkak të kriterit ekonomik.

Komisioneri vlerësoi se për të siguruar arsimin gjithëpërfshirës, për të gjithë fëmijët e familjeve në nevojë, shteti nëpërmjet akteve nënligjore duhet të marrë masa për të parandaluar braktisjen shkollore, përpara se ajo të ndodhë dhe jo pasi të këtë ndodhur të trajtojë me bursë, nxënësit që janë braktisës së shkollës.

Në vlerësim të Komisionerit, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë nga VKM-ja Nr. 666/2019, e ndryshuar.

Komisioneri vlerësoi se, fakti që kategori të tjera që përfitojnë për shkak të statusit, janë bërë pjesë e VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, si kategori të veçanta dhe kategoria e fëmijëve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është parashikuar si një kategori përfituese, vetëm duke plotësuar disa kushte shtesë, ka vënë këta të fundit në kushte të pabarabarta me kategoritë e tjera përfituese, si dhe nuk është bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për të siguruar arsimin gjithëpërfshirës dhe krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Komisioneri vlerëson se politika e mbështetjes me bursë e fëmijëve që braktisin shkollën, si me fondet e qeverisë qendrore ashtu dhe asaj vendore, nuk ka rezultuar efikase dhe nuk ka arritur qëllimin për të cilën është hartuar.

Komisioneri vlerëson se fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë vënë në pozitë diskriminuese nga parashikimi i VKM-së Nr. 666/2019, i ndryshuar, pasi si kategori në nevojë për shkak të gjendjes ekonomike, i janë vendosur kriteret shtesë dhe nuk janë parashikuar që të trajtohen me bursë.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se MAS-i, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit të sistemit arsimor, duhet të marrë iniciativën, për përfshirjen e të gjithë nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave.

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

28. T.B., kundër Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a.

VENDIM NR. 38, DATË 11.02.2022

Shkaku: Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira e shërbime
Statusi: Në gjykatë

Praktika e ndjekur nga FSHU sh.a., për ndërprerjen e energjisë elektrike për shkak të mospagesës së detyrimit të energjisë elektrike, në dukje e barabartë, e vendos ankuesin në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike.

FAKTET

Ankuesi T.B., është banor i qytetit të Lushnjës. Ankuesi nuk figuron abonent i shoqërisë dhe kontrata e furnizimit me energji elektrike në banesën ku ai jeton, është në emër të babait të tij, shtetasit Sh.B, i cili ka ndërruar jetë në datën 4.01.2012. Kontrata e furnizimit me energji elektrike, e cila figuron në emër të babait të ankuesit, rezulton me debi në vlerën totale prej 754.660.63 lekë. Kjo debi fillon nga muaji janar 2007. Në datën 30.12.2020 ankuesi ka lidhur me FSHU sh.a., një akt marrëveshje për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike (AKM), në lidhje me kontratën e sipërcituar. Ankuesi ka shlyer rregullisht detyrimet që burojnë nga AKM deri në muajin mars 2021. Rezulton se, ankuesi është debitor ndaj shoqërisë duke mos shlyer faturat për periudhën prill-tetor 2021. Për shkak se ankuesi nuk ka paguar detyrimet, në datën 22.10.2021, FSHU sh.a., ka proceduar me ndërprerjen e energjisë elektrike.

Ankuesi T.B., rezulton punëkërkues i papunë dhe trajtohet me ndihmë ekonomike në shumën 2600 lekë. Në momentin që ankuesi ka nënshkruar AKM për shlyerjen me këste të detyrimit të

energjisë elektrike, ai trajtohej me pagesën si person me aftësi të kufizuar në masën 11.941 lekë. Rezulton se ankuesi minimalisht, përveç faturës mujore të energjisë elektrike është i detyruar që të paguajë edhe 1200 lekë në muaj detyrimet e prapambetura, sipas përcaktimeve në AKM. Pra, ankuesit i mbeten vetëm 1400 lekë për të siguruar jetesën, pasi ka paguar detyrimin sipas AKM. Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar pasi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes së tij ekonomike, ai e ka të pamundur që të paguajë faturat e energjisë elektrike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollu 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.4 (1991) mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe Nr. 7 (1997) mbi dëbimet e detyrueshme, të Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- Rregullorja “Mbikushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 11.12.2018, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë;
- Vendim i Bordit të ERE-s Nr. 15, datë 10.01.2018 “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

KONKLUSIONE

Rezulton se, ndërprerja e energjisë elektrike për ankuesin, i cili për shkak të të ardhurave të ulta që disponon si përfitues i ndihmës ekonomike, përfshihet nga ligji në kategorinë “klientit në nevojë”, nuk është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 dhe Rregulloren e ERE-s. Në këto kushte Komisioneri vlerëson se ankuesi T. B. është trajtuar në mënyrë të padrejtë krahasuar me klientët e tjerë, pasi ankuesi nuk ndodhet në kushte e rrethana të njëjta me ata, pikërisht për shkak të gjendjes së tij ekonomike. Në situatën kur ankuesi rezulton përfitues i ndihmës ekonomike, ai përmbush një nga kriteret thelbësore të përcaktuar nga vetë ligji, atë të të ardhurave të ulta. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, Rregullorja e ERE-së ka fuqi ligjore dhe është e detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e FSHU sh.a. Referuar nenit 83/1 të Ligjit Nr. 43/2015, FSHU sh.a., në cilësinë e furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i

shërbimit publik, është i detyruar të furnizojnë klientët në nevojë, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, mbron familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Ankuesi T.B., është përfitues i ndihmës ekonomike bazuar në këtë legjislacion, por sërish të ardhurat e vetme të tij, të cilat janë si rezultat ndihmës ekonomike, nuk mundësojnë përmbushjen e nevojave më minimale për një jetesë normale. Në këto kushte, ai e ka të pamundur të mbulojë nevojat për energji elektrike dhe pagesën e detyrimeve që burojnë nga furnizimi me energji elektrike.

Komisioneri gjykon se është objektivisht e pamundur që ankuesi T.B., të mund të mbulojë pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe nevojat më minimale për një jetesë normale me 26000lekë, e aq më pak mund ta bëjë me 1400 lekë, që i mbeten pasi ka bërë pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike sipas AKM.

Kriteret thelbësore për të përfituar statusin si “*klient në nevojë*” përcaktohen nga vetë ligji dhe një ndër to, janë të ardhurat e ulta të klientit. Ligji nuk ka përcaktuar sa është vlera e të ardhurave, në mënyrë që një klient të konsiderohet në nevojë. Komisioneri vlerëson se, sa më sipër tregon qartë vulnerabilitetin e ankuesit si konsumator i energjisë elektrike. Të ardhurat e disponuara nga ankuesi janë në atë nivel që nuk i mundësojnë atij përmbushjen e nevojave më minimale për të siguruar jetesën. Ankuesi, si përfitues i ndihmës ekonomike, është vlerësuar nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, si person pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të siguruar plotësimin e nevojave bazë jetike. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se ankuesi vlerësohet si një person me të ardhura të ulëta dhe për rrjedhojë ai mund të pretendojë të drejtat e veçanta që ligji garanton për kategorinë e “*klientit në nevojë*”. Pavarësisht mungesës së hartimit dhe miratimit të aktit nënligjor për “*klientin në nevojë*”, sipas parashikimit të nenit 95/1, të Ligjit Nr. 43/2015, ERE ka përmbushur detyrimin e saj duke përcaktuar kushtet specifike mbi bazën e të cilave furnizuesi i energjisë elektrike që furnizon klientët në nevojë, mund të bëjë ndërprerjen e energjisë elektrike për këtë kategori të veçantë klientësh.

Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës. Ankuesi nuk ka të ardhura të tjera financiare përveç asaj të përfituar nga pagesa e ndihmës ekonomike dhe në këtë kontekst Komisioneri konsideron të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes ekonomike.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar mund të ndodh ndaj një personi që është me aftësi të kufizuara ose ka qenë me aftësi të kufizuara në të shkuarën, që ka predispozicion për të qenë me aftësi të kufizuara në të ardhmen, ose që prezumohet se është me aftësi të kufizuara. Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se ankuesi nuk ka aktualisht statusin si person me aftësi të kufizuara, ai e ka gëzuar këtë status në të shkuarën dhe për rrjedhojë konsideron si të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

diskriminuese vendosen edhe të gjithë personat e tjerë të cilët përshkak të të ardhurave të ulta, gëzojnë të drejtat e veçanta që Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikon për kategorinë e “klientit në nevojë”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shyqrtimi, Komisioneri nuk konstaton veçmas elementë diskriminimi që lidhen me këtë shkak.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të ankuesit T.B., për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., duhet të marrë masa për të rilidhur energjinë elektrike për ankuesin T.B.
- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., duhet të marrë masa për të ndaluar çdo praktikë të ndërprerjes së energjisë elektrike për shkak të mospagesës së detyrimeve të energjisë elektrike nga ana e klientëve të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike nga Shteti.
- Këshilli i Ministrave, duhet të marrë masa urgjente për të hartuar dhe miratuar aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

V. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË

29. Zh.L., kundër shtetasit O.J.

VENDIM NR. 236, DATË 29.12.2022

Shkaku: Gjinia
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Gjuha e përdorur nga shtetasi O.J., në emisionin “Ftesë në 5”, transmetuar në datë 29.09.2022 në Televizionin Top-Channel, përbën diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.

FAKTET

Shtetasi O.J., ka qënë i ftuar në Top Channel, në emisionin “Ftesë në 5”, të moderatores B.S. Emisioni kishte si objekt diskutimi, ligjërimin e poligjinisë diskutuar edhe në një emision të mëparshëm nga bashkëshortja e O.J., avokatja M.B.

Gjatë emisionit, në pjesën e dytë të tij, O.J., i është drejtuar Zh.L., (e ftuar në emision), ndër të tjera duke u shprehur se: “*Ti moj budallaçkë, moj ...*”, “*... një copë injorante, që ka një blog seksi, ajo duhet të bëjë filma pornografikë, jo të vijë të më ofendojë mua këtu.*”, “*Ik martohu gjej një burrë*” ...”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Rekomandimi CM/Rec (2013), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare “*Mbi barazinë gjinore dhe median*”;
- Rekomandimi CM/Rec (2019), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, më datë 27 mars 2019 “*Parandalimi dhe luftimi i seksizmit*”;
- Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015, i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Shprehjet e përdorura, në Emisionin “Ftesë në 5”, të datës 29.09.2022, nga shtetasi O.J., paraqesin rëndësi të veçantë, pasi janë përdorur në një televizion privat kombëtar si Top-Channel, në një orar

dhe në kushtet kur shikueshmëria e këtij emisioni nga publiku është e konsiderueshme. Pavarësisht, se shprehjet e përdorura nga një opinionist i ftuar nga ky televizion dhe përgjegjësia për gjuhën e përdorur është personale, Komisioneri gjykon se përgjegjësia më e madhe është e vetë televizionit, që duhet të mbante një qëndrim kritik të vijim të përdorimit të këtyre shprehjeve në një emision të tij. Ky qëndrim, jo vetëm nuk është mbajtur nga ana e Top-Channel, por për më tepër është bërë një “reklamim” dhe përforcim i shprehjes së përdorur nga O.J., duke e vënë si titull të emisionit të hedhur në Youtube nga ky televizion. Emisioni në fjalë ishte publik dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen youtube, duke bërë të mundur që jehona e shprehjeve të përdorura të ketë një përhapje të gjerë në opinionin publik. Lidhur me sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se në rrjete sociale, janë shfaqur komente indinjuese të personave të tjerë, lidhur me këtë titull dhe shprehjet e përdorura nga O.J.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerësoi se pavarësisht faktit që O.J., (referuar diskutimit të bërë gjatë emisionit) pretendon se është sulmuar nga ana e të ftuarve në emisionin “Ftesë në 5”, kjo nuk justifikon përdorimin e shprehjeve dhe gjuhës seksiste dhe denigruese për shkak gjinie, ndaj Zh.L. Në këtë kuptim, përdorimi i saj e ka vendosur Zh.L., në pozita diskriminuese për shkak të gjinisë, në formën e gjuhës së urrejtjes. Komisioneri thekson faktin se përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, stimulon veprime fyese, denigruese, kërcënuese dhe urrejtje ndaj grave/vajzave, aq më tepër kur përdoret në hapsira mediatike nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike dhe kanë një numër të madh audience.

Dhuna verbale, psikologjike dhe shprehje të gjuhës seksiste dhe denigruese janë të papranueshme dhe për më shumë të dënueshme kur përdoren në hapësira publike mediatike, në emisione me audiencë të gjerë dhe në fasha orare me rezonancë të lartë të popullsisë, ku përfshihen edhe fëmijët dhe të rinjtë.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson hapat e ndërmarrë nga ana e Televizionit Top-Channel dhe moderatores B.S., për heqjen e videos nga të gjitha kanalet e tyre zyrtare dhe jo zyrtare, bashkëpunimin e treguar dhe distancimin e bërë publik në emisionin “Ftesë në 5”, të datës 03.10.2022, nga gjuha e përdorur nga ana e O.J., kundrejtë Zh.L.

VENDIMI

- Gjuha e përdorur nga shtetasi O.J., në emisionin “Ftesë në 5”, transmetuar në datë 29.09.2022 në Televizionin Top-Channel, përbën diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi shtetasi O.J., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e sa

30. Xh.B., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH)

VENDIM NR. 43, DATË 28.02.2022

Shkaku: Gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Trajtimi i pafavorshëm dhe diskriminues i ankuses pas kthimit nga leja e lindjes.

FAKTET

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ankuesja është emëruar në detyrën, Specialist, në Seksionin për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve, në Sektorin për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

Xh.B., ka qenë me leje lindje gjatë vitit 2021. Për shkak të gjendjes shëndetësore të fëmijës së saj, gjatë muajit korrik 2021 ka qenë e pajisur me raport mjekësor.

Në vijim është njohur me Urdhër për transferimin e saj për nevoja pune, nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier.

Xh.B., nëpërmjet dy kërkesave, ka kërkuar rishikimin e urdhrin të transferimit, pasi është nënë e një fëmije, një vjeç dhe largësia nga vendbanimi i ka vështirësuar kujdesin për fëmijën e saj.

DPPSH-së, informoi Komisionerin se në DVP Durrës me gradën policore nënkomisar ishin, 20 punonjëse femra dhe 79 meshkuj.

Komisioneri konstatoi se Xh.B., pas përfundimit të lejes së barrëlindjes, ka pranuar se është kthyer në mjedisin e punës, por nuk ka ushtruar detyrën, pasi ka qenë me raport mjekësor dhe vetëm në dy ditë ka qenë pa raport mjekësor, por nuk i janë ngarkuar detyra nga eprorët, ku menjëherë i është njoftuar urdhri i transferimit për në një qytet tjetër.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Shtojca e Kartës Social Europiane;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW);
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- Kodi i Punës, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;
- VKM-së Nr. 750, datë 16.09.2015, Rregullorja e Policisë së Shtetit;
- Ligji Nr. 8829, datë 05.11.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr.183 “Mbrojtja e Amësisë, 2000”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligji Nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”;
- Çështja e Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar GJED (1985).

KONKLUZIONE

DPPSH-ja, ka informuar Komisionerin se, nënkomisar Xh.B., është transferuar për nevoja pune, dhe se nuk kishte performancë në detyrën që kryente në Departamentin e Policisë Kriminale.

Për të dy këto momente, DPPSH-ja nuk ka sjellë para Komisionerit, asnjë dokument në cilësinë e provës, për të argumentuar arsyen e transferimit të Xh.B., apo për të vërtetuar performancën e saj. Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, DPPSH nuk arriti të provonte përpara Komisionerit se:

Kishte kthyer punonjësen në vendin e mëparshëm të punës apo në një vend të barazvlefshëm me të.

Nuk arriti të tregojë para Komisionerit kush ishin konkretisht nevojat e punës për të justifikuar transferimin si dhe të tregonte që transferimi i ankueses ishte i vetmi mjet efektiv për të plotësuar këto nevoja.

Nuk sollli para Komisionerit fakte dhe prova, sa i takon procedurës së ndjekur për të realizuar vlerësimin performancës së punonjësve me qëllim transferimin për shkak të performancës dhe fakte që një vlerësim i tillë ishte kryer.

Ankuesja ishte punonjëse me performancë të dobët.

Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për të transferuar në një qytet tjetër një punonjëse që sapo ishte kthyer nga leja e lindjes.

Në kushtet kur, nga ana e DPPSH-së nuk u arrit të provohej që vendim-marrja e saj ishte e drejtë dhe e bazuar në ligj, lidhur me transferimin e ankueses menjëherë sapo është kthyer nga leja e lindjes dhe pa kryer një proces vlerësimi të punonjësve që plotësonin kushtet, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e DPPSH-së, pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri gjykoi se subjekti ankues, është diskriminuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Komisioneri sjell në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, faktin që transferimi apo promovimi i punonjësve femra në strukturat e Policisë së Shtetit, të bëhet duke iu

referuar një sërë faktorëve të tjerë plotësues, si për shembull: pasja nën vëmendje e gjendjes familjare të tyre, fakti i të qenit nëna të reja, largësisë nga vendbanimi, etj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses Xh.B., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkak të gjinisë.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në një pozicionin që përshtatet me gradën e saj, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

VI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS

31. N.Sh., kundër Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Fier

VENDIM NR. 190, DATË 11.10.2022

Shkaku: Mosha
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

N.Sh., ka punuar prej 10 vitesh pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, në pozicione të ndryshme pune, të tilla si: punëtor mirëmbajtës qyteti, mirëmbajtës hidraulik fshati, hidraulik pranë zyrës së shitjes, pompist dhe dispeçer. Ai është diskriminuar për shkak të moshës nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, duke iu ndërprerë marrëdhënia e punës.

FAKTET

N.Sh., ka punuar prej 10 vitesh pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, në pozicione të ndryshme pune, të tilla si: punëtor mirëmbajtës qyteti, mirëmbajtës hidraulik fshati, hidraulik pranë zyrës së shitjes, pompist dhe dispeçer. Ai është emëruar në pozicionin “*punëtor mirëmbajtës qyteti*”. Në vijim ankuesi është emëruar në pozicionin “*mirëmbajtës-hidraulik Fshat*”, pranë Drejtorisë Teknike për shkak të ristrukturimit të shoqërisë. Këtë pozicion pune, ankuesi e ka mbajtur deri në muajin mars 2017, pasi nëpërmjet Urdhërit të Administratorit të shoqërisë, Z. N.Sh. është transferuar me detyrë “*pompist*”, në Repartin e Shfrytëzimit Fier, pranë Zyrës Teknike të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier. Në vijim, ankuesi është transferuar në pozicionin “*dispeçer*” në Sektorin e Shfrytëzimit Qytet.

Në datën 02.06.2021, N.Sh., është njoftuar, për të diskutuar për zgjidhjen e kontratës së punës, si pasojë e ristrukturimit të Ujësjetllës – Kanalizime sh.a., Fier. Si pasojë e miratimit të kësaj strukture ka patur ndryshime në organizimin e punës në Sektorin e Shfrytëzimit Qytet dhe konkretisht pozicioni i tij i punës “*dispeçer*” është suprimuar. Në vijim, është zhvilluar takimi i ankuesit me përfaqësues të punëdhënësit, ku atij i është komunikuar vendimi për zgjidhje të kontratës së punës, si pasojë e suprimimit të pozicionit të punës. N.Sh., pretendon se në këtë takim ka kundërshtuar largimin nga puna me arsyetimin se në moshën e tij, askush nuk e punëson më, pasi është në prag pensioni, por përfaqësuesit e punëdhënësit i kanë thënë verbalisht që do të mbaheshin në punë vetëm punonjësit më të rinj.

Në vijim, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjësin N.Sh., për shkak të suprimimit të pozicionit të punës, si pasojë e ristrukturimit të shoqërisë. N.Sh., shprehet se, Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier ka kryer shkelje procedurale, pasi nuk ka zbatuar afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, fakt që është konstatuar edhe nga Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Fier, e cila nëpërmjet vendimit Nr. 62-2022-718 (1350), datë 17.02.2022, ka pranuar në mënyrë të pjesshme padinë e N.Sh.

Ai pretendon se është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- *Parimet e Kombeve të Bashkuara për të Moshuarit (1991) (PKBM)*, miratuar me Rezolutën Nr. 46/91 e datës 16 dhjetor 1991, të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara
- *Plani Ndërkombëtar i Veprimit i Madridit për Moshën (PNVMM) (2002)*;
- *Plani Kombëtar mbi Moshimin 2020-2024*, miratuar me Vendimin Nr. 864, datë 24.12.2019, e Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H., and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri gjykon mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankueses, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier.

Referuar procesverbalit të mbajtur në takimin e datës 04.06.2021, të zhvilluar ndërmjet komisionit të ristrukturimit dhe ankuesit, rezulton se ky komision është shprehur se sistemimi i tij në një detyrë tjetër do të kishte prioritet, në kushtet kur ai pothuajse kishte mbushur moshën për pension pleqërie dhe në krye të disa muajve do të dilte në pension. Pavarësisht sa më sipër, kjo shoqëri ka vepruar në kundërshtim me ato që ka deklaruar, pasi në vakancën e parë të krijuar, ka sistemuar një punonjës tjetër të larguar nga ristrukturimi i shoqërisë.

KMD ka konstatuar se pas mbylljes së procesit të ristrukturimit, 2 prej ish-punonjësve të larguar nga puna si pasojë e suprimimit të pozicionit të punës, janë rikthyer në punë në pozicione të tjera pune. Kështu, vetëm pothuajse 1 muaj më vonë Sh. R., i larguar puna për shkak të suprimimit të pozicionit të punës “hidraulik” është riemëruar në pozicionin e punës “Mirëmbajtës” pranë

Repartit 2 Menaxhim Uji dhe KUZ në Njësinë Administrative Libofshë. Kjo lëvizje është justifikuar me faktin se struktura e sipërcituar, kërkonte punësimin e specialistëve “hidraulikë”.

Punonjësi tjetër, është sistemuar në pozicionin e punës “*Punëtor Zhbllokues*” në datën 16.03.2022, pra pothuaj 7 muaj në vijim të largimit nga puna nëpërmjet ristrukturimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier. Ripunësimi i A.Gj., është justifikuar me faktin se sistemimi i tij është kryer brenda të njëjtit profil pune dhe të njëjtit sektor.

Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier ka theksuar faktin se dy punonjësit e rimarrë kanë patur kualifikimin dhe eksperiencën e kërkuar për ato pozicione pune, për të cilët u punësuan, ndërkohë që nuk kanë depozituar në cilësi prove asnjë prej kualifikimeve që ata plotësonin, për të justifikuar risistemimin e tyre, në krahasim me ish-punonjës të tjerë të larguar nga puna si pasojë e ristrukturimit të shoqërisë.

Gjithashtu rezulton se pavarësisht pozicionit vakant “*mirëmbajtës*” që ishte krijuar pranë Njësisë Administrative Libofshë, Reparti 2 Menaxhim Uji dhe KUZ NJA, Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier ripunësoi Sh.R., i larguar puna për shkak të suprimimit të pozicionit të punës “hidraulik”. Sh.R., është larguar nga puna nëpërmjet ristrukturimit pasi nuk plotësonte kriteret e reja të pozicionit të punës “*hidraulik*” që ishin vendosur me strukturën organike të vitit 2021, ndërkohë që Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Fier e justifikon ripunësimin e tij në pozicionin “*mirëmbajtës*” me arsyetimin se për këtë pozicion pune kërkohet një specialist hidraulik, sikurse e përcaktonte struktura organike e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, miratuar me vendimin Nr. 5, datë 07.05.2021, të Këshillit të Administrimit, e cila përveç pozicionit të punës përmban edhe specialitetin që duhet të këtë punonjësi përkatës.

KMD vë në dukje faktin se N.Sh. ka punuar me parë edhe në detyrën e hidraulikut edhe në atë të mirëmbajtësit hidraulik, pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, fakt që dëshmon se ai i ka plotësuar kriteret dhe kualifikimet e nevojshme për të kryer këtë detyrë, për periudhën kohore kur ka punuar në këtë pozicion pune dhe në këtë kontekst KMD gjykon se ai ka qenë i aftë për të kryer detyrën e mirëmbajtësit pranë Njësisë Administrative Libofshë, ku kërkohet që specialiteti të ishte teknik hidraulik. Por, pavarësisht kësaj, Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier, edhe pse ishte në dijeni të plotë të faktit se ankuesi dilte në pension në krye të disa muajve, pas 10 vitesh që punonte pranë kësaj shoqërie, vendosi të mos e sistemojë në punë për një periudhë 7 mujore derisa të dilte në pension pleqërie edhe pse ekzistonte një mundësi e tillë.

KMD gjykon se kjo shoqëri ka preferuar të sistemojë në punë ish-punonjës të saj, të larguar nëpërmjet ristrukturimit, të cilët kanë moshë më të re sesa ankuesi.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., nuk u arrit të provohej që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar, që është moshë dhe trajtimit të padrejtë e disfavorshëm nga ana e kësaj shoqërie.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se N.Sh., është diskriminuar për shkak të moshës nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Fier.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të moshës, së N.Sh., nga ana e Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Fier.

32. J.L., kundër Ministrisë së Brendshme

VENDIM NR. 48, DATË 09.03.2022

Shkaku: Moshë
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Kriteri i moshës “jo më shumë se 30 vjeç” i vendosur për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë, ka diskriminuar ankuesin J.L., për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion.

FAKTET

Me Urdhrin e datës 15.09.2021 “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurim, për pranim në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë”, të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, janë hapur aplikimet për pranim dhe ndjekjen e studimeve në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2021-2022. Referuar kritereve të përcaktuara në urdhrin e DPPSH, rezultoi se, në pikën 6, germa “b”, të këtij urdhri, përcaktohet se: “Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë aplikanti janë: ... b) të jetë në moshën jo më shumë se 30 vjeç.” Rezultoi se, vendosja e kriterit në lidhje me moshën e aplikantëve, bazohet në urdhrin e Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kritereve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”. Në urdhrin Nr. 107/2020 të Ministrit të Brendshëm, në pikën 2, germa “a” është vendosur: “2. Përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 38, pika 2 e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, kriteret e veçanta për pranimin në Akademinë e Sigurisë, janë si më poshtë: ... a) Të jenë në moshë jo më shumë se 30 vjeç; ...”.

Ankuesi J.L., është i datëlindjes 24.07.1990 dhe është banor i Bashkisë Tiranë. Ankuesi ka aplikuar për konkurim, për pranim dhe ndjekjen e studimeve në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Sigurisë, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës brenda afteve të përcaktuara. Gjatë procedurës për përzgjedhjen e aplikantëve, ankuesi është njoftuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë se, pas verifikimit të dokumentacionit, ankuesi nuk mund të merrte pjesë në procesin e konkurimit për shkak se nuk plotësonte kriterin e moshës. Në momentin që ka aplikuar ankuesi ka qenë 31 vjeç, ndërsa sipas kritereve të vendosura për aplikim përcaktohet se “duhet të jetë në moshën jo më shumë se 30 vjeç”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, Nr. 20, datë 11.07.2006, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar;
- Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 16.09.2015;
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “*Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë*”.
- Çështjet C-258/2015, *Gorka Salaberria Sorondo v. Academia Vasca de Policía y Emergencias*, 15 nëntor 2016 dhe C- 416/13, *Mario Vital Pérez v. Ayuntamiento de Oviedo*, 13 nëntor 2014, të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

KONKLUZIONE

Me vendimin Nr. 189, datë 06.10.2021, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e kategorisë së personave “*mbi 30 vjeç*” për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion, përmes zbatimit të pikës 2 (a), të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “*Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë*”. Konkluzionet e arritura në vendimin Nr. 189, datë 06.10.2021, të Komisionerit do të gjejnë zbatim në rastin objekt shqyrtimi në përputhje me faktet dhe rrethanat e rastit.

Duke vendosur si kriter se, personat mbi moshën 30 vjeç nuk mund të aplikojnë për t’u bërë punonjës policie dhe pjesë e policisë së shtetit, Komisioneri arrin në përfundimin se, kriteri i vendosur nga germa”a”, e pikës 2, të Urdhrit Nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, prek kriteret e përzgjedhjes dhe rekrutimit për këtë kategori punonjësish, të cilët i përkasin sektorit publik.

Ankuesi, është i datëlindjes 24.07.1990 dhe në momentin e aplikimit ka mbushur moshën 31 vjeç, pra është “*mbi 30 vjeç*”. Ankuesi, i cili është mbi 30 vjeç, është në një situatë të ngjashme me atë të aplikantëve të tjerë, të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç dhe marrin pjesë në të njëjtat procedura për pranimin dhe konkurimin në Akademinë e Sigurisë për t’u bërë punonjës të policisë. Ankuesi i cili është mbi 30 vjeç, gjatë fazës së verifikimit të dokumentacionit dhe përzgjedhjen e aplikantëve, nuk është pranuar në konkurim, për shkak të moshës, duke u trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, në raport me kategorinë e aplikantë të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç.

Komisioneri vlerëson se, ankuesi J.L., i cili është “*më shumë se 30 vjeç*” është trajtuar në mënyrë të diferencuar, duke u vendosur në kushte më pak të favorshme në raport me aplikantët e tjerë të

cilët kanë marrë pjesë në të njëjtën procedurë konkurimi, të cilët janë “jo më shumë se 30 vjeç”, si pasojë e zbatimit të kriterit të përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kritereve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”. Qartazi, një kriter/rregullim i tillë, përbën një diferencë në trajtim që bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek mosha.

Në rastin objekt shqyrtimi, ankuesi është më shumë se 30 vjeç dhe për shkak të moshës ai i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm. Komisioneri vlerëson se, ankuesi mbart shkakun e mbrojtur nga diskriminimi, atë të moshës.

Duke zbatuar në çështjen objekt shqyrtimi, konstatimet dhe konkluzionet e vendimit Nr. 189, datë 06.10.2021, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi J.L., është trajtuar në mënyrë të diferencuar, duke u vendosur në kushte më pak të favorshme për shkak se është “më shumë se 30 vjeç” në raport me aplikantët e tjerë të cilët janë “jo më shumë se 30 vjeç” dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Komisioneri konstaton se, ankuesi J.L., është diskriminuar për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion, si pasojë e zbatimit të kriterit të vendosur në pikën 2, germa “a”, të Urdhrit Nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit J.L., për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion, nga pika 2, germa “a”, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr.107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kritereve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”.
- Ministria e Brendshme, të marri masa për rishikimin e Urdhrit Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kritereve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”, duke hequr kriterin kufizues në lidhje me moshën e personave që aplikojnë për pranim në Akademinë e Sigurisë, të vendosur në pikën 2, germa “a”, të urdhrit të sipërcituar.

VII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJES FETARE

33. I.B., kundër Shkollës Jo Publike Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër

VENDIM NR. 159, DATË 15.08.2022

Shkaku: Bindjet fetare

Forma: Viktimizim

Fusha: Punësim

Statusi: Zbatuar

Ankuesi I.B., është diskriminuar duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes së ankesës për shkeje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të bindjeve fetare.

FAKTET

Ankuesi I.B., është i punësuar si mësues i edukimit fizik, pranë Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, që prej datës 01.12.2009. Prej vitit 2015 ankuesi ka kaluar si mësues definitiv pranë kësaj shkolle. I.B., është punësuar si mësues i edukimit fizik, në ciklin 9-vjeçar dhe të mesëm, pranë Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, Dega e Djemve, me një ngarkesë mësimore (maksimale) 21 orë në javë. Kontrata është lidhur për një afat kohor të pacaktuar.

Deri në vitin shkollor 2018-2019, Medreseja “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër ka patur vetëm një mësues të edukimit fizik për Degën e Djemve, dhe ai ka qenë ankuesi. Në datë 12.11.2019, në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër ka filluar punë si mësues i edukimit fizik, në Degën e Djemve, mësuesi K.H. Gjatë vitit shkollor 2019-2020 mësuesi K.H., ka patur 2 (dy) orë mësimore. Gjatë vitit shkollor 2020-2021, ankuesi I.B., ka patur 20 (njëzetë) orë ngarkesë mësimore në javë, ndërsa mësuesi K.H., gjatë këtij viti mësimor ka vazhduar të ketë të njëjtën ngarkesë, 2 (dy) orë mësimore në javë.

Në datën 11 gusht 2021, ankuesit i është komunikuar në mënyrë verbale se për vitin mësimor 2021-2022 ai do të jepte orët e edukimit fizik në gjimnaz 5 (pesë) ose 6 (gjashtë) orë mësimore në varësi të ngarkesës, ndërsa orët mësimore të edukimit fizik në 9-vjeçare, 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore, do ti merrte mësuesi K.H. Gjatë vitit shkollor 2021-2022 dhe pas ndryshimeve në ngarkesën mësimore, ankuesi ka vazhduar punën si mësues i edukimit fizik në gjimnaz, me një ngarkesë prej 5 orë mësimore në javë dhe është paguar me pagë mujore bruto prej 47.700 (dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë në muaj. Ndërsa mësuesi K.H., gjatë vitit shkollor 2021-2022 rezultoi të ketë patur ngarkesë prej 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore në ciklin 9-vjeçar.

Ankuesi ka vazhduar punën sipas ngarkesës së re mësimore të reduktuar, por duke pretenduar se zbritja e ngarkesës së tij mësimore ka ndodhur për shkaqe diskriminuese, ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën e datës 17.01.2022. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 19.04.2022, ankuesi shtoi pretendimet e tij, duke parashtruar se, pas largimit të mësuesit K.H., nga shkolla, kjo e fundit nuk i kishte dhënë orët e lira mësimore të mbetura pas largimit të tij, por ia

kishte kaluar ato një punonjësi i cili ishte jashtë profilit. Sipas ankuesit një gjë e tillë kishte ndodhur pasi ai kishte bërë ankesë për diskriminim pranë Komisionerit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollu 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “*Për Barazinë Gjinore në Shoqëri*”.

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerëson se, ndryshimet në elementë ose kushte të caktuar të marrëdhënies së punësimit, janë procese normale edhe kur nuk ndodhin me dakortësinë palëve, për sa kohë që ndryshimet rezultojnë të kenë ndodhur për arsye ligjore dhe objektive. Në rastin konkret, Komisioneri nuk konstatoi asnjë arsye ligjore ose objektive për zbritjen e ngarkesës mësimore të ankuesit në 5 (pesë) orë mësimore në javë. Komisioneri arriti në përfundimin se, zbritja e orëve mësimore të ankuesit I.B., nuk ka ndodhur bazuar në arsye ligjore dhe objektive. Në këto kushte provohet se ankuesi I.B., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Komisioneri vlerësoi se, orët mësimore të lira pas largimit të mësuesit K.H., duhet t’i kishin kaluar ankuesit I.B., si mësuesi i vetëm i edukimit fizik në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër dhe jo t’i kalonin një mësuesi jashtë profilit. Komisioneri arriti në përfundimin, se ankuesi I.B., i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, duke mos i kaluar orët e lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit të mësuesit K.H.

Komisioneri konstaton se, ankuesi ka filluar punë si mësues i edukimit fizik në Medresenë “Haxhi Shesh Shamia”, Shkodër në vitin 2009 dhe në vitin 2015 ai është promovuar duke u bërë mësues definitiv. Nga viti 2009 deri në vitin 2021, janë rreth 12 vite që ankuesi punon si mësues në këtë shkollë. Komisioneri vlerëson se, gjatë kësaj kohe, Medreseja, ka patur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e ankuesit me institucionin. Gjatë 12 viteve që ankuesi ka qenë i punësuar si mësues pranë Medrese “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, është një kohë e konsiderueshme, gjatë të cilës, nëse Medreseja do të kishte patur rezerva apo perceptimin se ankuesi nuk plotësonte performancën në lidhje me “moralin islam” ka patur gjithë kohën e nevojshme për të ndërprerë marrëdhënien e punësimit me ankuesin përpara se të punësonte mësuesin K.H., apo përpara ndryshimit të ngarkesës mësimore.

Gjatë shqyrtimit të çështjes nuk rezultoi që gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, midis ankuesit dhe Medresesë të ketë patur ngjarje ose rrethana me natyrë ose me kontekst fetar, të cilat mund të kenë penalizuar ankuesin gjatë marrëdhënies së tij me Medresenë, të cilat të mund të ngrenë dyshime se motivet për të cilat është reduktuar ngarkesa mësimore e ankuesit ka për bazë besimin fetar.

Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk rezultoi e provuar që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi nëpërmjet uljes së ngarkesës mësimore nga ana e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër të jetë pasojë e drejtëpërdrejtë e shkakut të pretenduar të diskriminimit “bindjeve fetare”. Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit “bindjet fetare”, nuk mund të çojnë a priori në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk provohet lidhja shkakësore, pra arsyeja për diferencën në trajtim, është shkak i pretenduar i diskriminimit.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se:

- ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, duke mos i kaluar ngarkesën mësimore prej 18 orë të lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit të mësuesit K.H.;
- orët e lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H., i kanë kaluar një punonjësi i cili nuk është i profilit të edukimit fizik, ndërkohë që ankuesi ishte i vetmi mësues i edukimit fizik në shkollë dhe me një ngarkesë të ulët të orëve mësimore;
- kalimi i orëve të lira mësimore është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar, sipas të cilit kërkohet që lëndët mësimore të jepen nga mësues të profilit ose të një profili të përafërt sipas përcaktive në aktet respektive;
- moskalimi i orëve mësimore sjell pasojat të pavaforshme për ankuesin në lidhje me pagën që do të përfitonte po të kishte numër më të lartë të orëve mësimore por edhe në raport me vazhdueshmërinë e marrëdhënies së punës, e cila kushtëzohet nga ngarkesa mësimore që ka një mësues.
- ankuesi ka paraqitur ankesën në datën 17.01.2022 ndërsa pasojat e disfavorshme që i kanë ardhur, nëpërmjet moskalimit të orëve të lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H., kanë ardhur pas datës 15.02.2022, datë në të cilën është larguar mësuesi K.H.
- Medreseja “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër ka marrë dijeneri për ankesën për diskriminim, të paraqitur nga ankuesi në datën 05.02.2022.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se krijohet prezumimi se, moskalimi i orëve të lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H., është pasojë negative që ka ardhur si rezultat i paraqitjes nga ana e ankuesit të ankesës për diskriminim kundër Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, pranë Komisionerit.

Në lidhje me arsyen se, përse orët e lira nuk i kishin kaluar ankuesit, i cili ishte i vetmi mësues mësuesi i profilit në shkollë dhe me ngarkesë të ulët të orëve mësimore (5 orë mësimore), shkolla deklaroi se, kjo gjë kishte ndodhur pasi nga ana e ankuesit ishte bërë një ankesë dhe një gjë e tillë është parë si një lloj krisje e marrëdhënieve midis ankuesit dhe shkollës. Kur kanë marrë dijeneri për

ankesën, janë ndjerë se është bërë pabesisht nga ankuesi, pasi kanë mendur se palët janë dakortësuar me kushtet e reja të punës. Bazuar në deklaratimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, provohet plotësisht se vendimi i Medresesë për të mos i kaluar orët e lira mësimore ankuesit ka ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit. Në këtë mënyrë vërtetohet lidhja shkakësore, pra që trajtimi i disfavorshëm është pasojë e drejtëpërdrejtë që ka ardhur si pasojë e ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesi pranë Komisionerit.

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi I.B., është diskriminuar nga ana e Shkollës Jopublike Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuesit I.B., në lidhje me moskalimin e orëve të lira mësimore ankuesit, pas largimit të mësuesit K.H., nga ana e Shkollës Jopublike Medrese “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër.
- Shkolla Jopublike Medreseja “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër, duhet të marrë masa që orët mësimore të shpërndahen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe të jepen nga mësues të profilit përkatës.
- Shkolla Jopublike Medreseja “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër, duhet të marrë masa që të mos përsëriten në të ardhmen situata të tilla diskriminuuese.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit I.B., për shkak të “bindjeve fetare”, nga ana e Shkollës Jopublike Medreseja “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër, në lidhje me uljen e orëve mësimore në fillim të vitit shkollor 2021-2022.

VIII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

34. O.K., kundër E.B., Drejtore pranë Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë

VENDIM NR. 231, DATË 22.12.2022

Shkaku: Gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij arsimore si infermier nga ana e Drejtoreshës së Spitalit Universitar të Traumës dhe Grupit të Punës të ngritur me urdhër të saj.

FAKTET

Ankuesi O.K., është diplomuar në degën Infermieri e Përgjithshme, pranë Universitetit të Tiranës. Nëpërmjet Urdhërit Nr. 2142/1, datë 02.05.2018, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ankuesi është transferuar nga pozicioni i Kryeinfermierit të Njësisë së Psikiatrisë së Fëmijëve, Shërbimi i Psikiatrisë Poli i Administrimit të Integruar i Spitalit të Neuroshkencës, të QSUT-së, në pozicionin e Kryeinfermierit pranë Shërbimit të Kirurgjisë Nr. 2, në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), Tiranë. Sipas O.K., sqaron se ky transferim nuk është mirëpritur nga ana e ish-Drejtorit të SUT-së, A.Z.,¹⁴, i cili ka krijuar të gjitha kushtet për t'ia bërë punën të pamundur, me qëllim zgjidhjen e kontratës së tij të punës. Pas ardhjes në detyrë të Drejtores aktuale të SUT-së, E.B., kjo e fundit e ka paragjykuar pa të drejtë mbi bazën e masave disiplinore të dhëna nga Drejtori i mëparshëm, masa të cilat janë revokuar nga ish-titullari i SUT-së.

Problematika lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Urdhërin Nr. 769, datë 25.11.2021, e Drejtores së SUT-së, nëpërmjet të cilit ai është zbritur në detyrë, nga pozicioni i Kryeinfermierit, në pozicionin e infermierit. Akti i sipërcituar ka dalë si rrjedhim i një hetimi administrativ që është kryer nga Grupi i Punës së ngritur me urdhër të titullares së institucionit, për të zbardhur konfliktin e ndodhur ndërmjet ankuesit dhe mjekut J.R., O.K., thekson faktin se Grupi i Punës nuk e ka hetuar dhe zbardhur çështjen plotësisht, duke dalë në përfundime të gabuara. Njëkohësisht, ankuesi pretendon se Grupi i Punës ka mbajtur anën e Drejtores së SUT-së, e cila ka dhënë udhëzim për të diskriminuar O.K. Ankuesi pretendon se Grupi i Punës nuk i ka dëgjuar dhe vlerësuar kundërshtimet e tij.

Sipas ankuesit konflikti me mjekun e sipërcituar ka ndodhur, pasi ai nuk ka lejuar në korridorin e Pavionit të Ortopedisë, një person pa maskë mbrojtëse. Ankuesi i ka kërkuar personit të pajiset me maskë dhe e ka pyetur se me ç'mund ta ndihmonte. Në atë moment, i është afruar mjeku ortoped

¹⁴ Referuar Vendimit Nr. 146, datë 17.10.2019, të KMD-së.

J.R., i cili e njihte personin në fjalë, me të cilin janë konfliktuar edhe fizikisht. O.K., ka sqaruar se me mjekun ortoped J.R., ka patur tentativë për konflikte edhe më parë, të cilat ai është munduar t'i shmangë maksimalisht, në ambientet e punës.

Në përfundim të hetimit, Grupi i Punës ka dalë në përfundimin dhe ka propozuar marrjen e masave disiplinore ndaj mjekut J.R., (vërejtje me shkrim) dhe kryeinfermierit O.K., (vërejtje me paralajmërim). Titullarja e institucionit ka marrë masë disiplinore, duke e zbritur në detyrë, ndërkohë që ndaj mjekut të sipërcituar nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolle 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen *Bączkoëski* dhe të tjerët kundër Polonisë (*Bączkoëski and others v. Poland*),/ çështjes *Redfearn* kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i tij nga ana e Grupit të Punës të SUT-së që ka hetuar konfliktin e ndodhur ndërmjet tij dhe mjekut J.R., sikurse dhe nga ana e Drejtores së SUT-së.

Hetimi i Grupit të Punës mbi konfliktin e ndodhur, është mbështetur vetëm në deklaratat e dy palëve në konflikt, dosjet e tyre personale të administruara nga sektori i burimeve njerëzore i SUT-së dhe artikujt e botuar nga portalet mbi konfliktin e ndodhur në SUT.

Gjatë analizimit të Relacionit të Grupit të Punës, Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se në të nuk ka asnjë analizë, lidhur me çështjen e konfliktit të ndodhur. I vetmi përfundim i bazuar i këtij grupi pune është fakti që konflikti ndërmjet mjekut J.R., dhe K/Infermierit O.K., ka qenë real në datën 17.11.2021, ndërkohë që nuk ka hetuar nëpërmjet mjeteve të tjera të disponueshme, për të evidentuar se cili është fajtori në këtë konflikt.

Gjatë seancës dëgjimore rezultoi qartë se dy elementet e konsideruar si rrethana rënduese për O.K., në propozimin e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim” ndaj tij nga Grupi i Punës kanë qenë:

- publikimi në portale i konfliktit të ndodhur mes tij dhe mjekut J.R.,

- masat e mëparshme disiplinore të O.K., të cilat në momentin e ndodhjes së konfliktit kanë qenë të shuara.

Komisioneri gjykoi se e ashtuquajtuara rrethanë rënduese për O.K., në propozimin për dhënien e masës disiplinore nga ana e Grupit të Punës rezultoi e paprovuar, e pa analizuar dhe e pa arsyetuar në relacionin e Grupit të Punës së SUT-së.

KMD gjykoi se vlerësimi i grupit i punës i parashtruar në seancë dëgjimore mbi çështjen e sipërcituar është i pambështetur.

Relacioni i këtij grupi punë drejtuar titullares së SUT-së, rezultoi i pa analizuar dhe i pa arsyetuar, për të dalë në propozimet përkatëse në masa disiplinore.

KMD vlerësoi se hetimi i kryer nga Grupi i Punës ka qenë i përciptë dhe jo i thelluar për të hetuar dhe verifikuar elementet e konfliktit të ndodhur dhe për të vënë para përgjegjësisë personat që kanë qenë realisht përgjegjës.

Duke mos dashur në asnjë mënyrë të justifikojë veprimet e të dy palëve në këtë konflikt, KMD gjykoi se mosmarrja parasysh nga ana e Grupit të Punës, të fakteve të sipërcituara, ka ndikuar në zhvillimin e një procesi jo të drejtë për ankuesin. Rekomandimi i masave disiplinore të ndryshme për një konflikt verbal-fizik të ndodhur nga dy palë të përfshira në të, ku njëra palë kryen detyrën e infermierit dhe pala tjetër mban detyrën e mjekut, me gradë shkencore, reflekton pikërisht aplikimin e një standardi të dyfishtë nga ana e Grupit të Punës, ku për infermierin O.K., propozohet vërejtje më e rëndë sesa për mjekun J.R.

Komisioneri çmoi se në kushtet kur, Relacioni i hartuar nga grupi i punës nuk evidentonte se cila prej palëve ishte përgjegjëse në konfliktin e ndodhur, Drejtoresha e SUT-së kishte përgjegjësinë për t'u thelluar personalisht në këto hetime dhe jo të vijonte me veprime të padrejta, duke dhënë për O.K., një masë disiplinore më të rëndë, sesa ajo që kishte propozuar Grupi i Punës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se gjatë hetimit administrativ, nga ana e Drejtoreshës së SUT-së dhe Grupit të Punës të ngritur me urdhër të saj nuk u arrit të provohej, që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar, që është gjendja arsimore dhe trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë të ankuesit O.K.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se mbështetur në të gjithë faktet e analizuar sa më sipër, Drejtoresha e SUT-së dhe Grupi i Punës i ngritur me urdhër të saj, e kanë diskriminuar O.K., në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes së tij, arsimore.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore, të O.K., nga ana e Drejtoreshës së Spitalit Universitar të Traumës dhe Grupit të Punës të ngritur me urdhër të saj.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, Drejtoresha e Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa të menjëherëshme, për të rikthyer ankuesin O.K., në vendin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

35. A.P., kundër Akademisë së Sigurisë

VENDIM NR. 156, DATË 28.07.2022

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore (problemeve me shikimin) nga ana e Akademisë së Sigurisë.

FAKTET

A.P., ka përfunduar në vitin 2018, studimet Bachelor për “Shkenca Juridike në Biznes” pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në vijim, ankuesi ka përfunduar studimet në programin Master Profesional në të Drejtën Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar në muajin korrik të vitit 2021. Mbështetur në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ankuesi ka aplikuar për pranim pranë Akademisë së Sigurisë, si student që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë më mesatare të notave mbi 8 (tetë).

Për sa më sipër, ankuesi i është nënshtruar konkurrencës dhe procedurave përkatëse të parashikuara në aktet nënligjore respektive, sikurse të gjithë aplikantët e tjerë, deri në momentin që i është komunikuar, që Komisioni i Vlerësimit e ka skualifikuar, pasi nuk plotësonte kriterin shëndetësor të shikimit 10/10. A.P., e ka konsideruar të padrejtë dhe diskriminues skualifikimin e tij dhe e ka kundërshtuar këtë vendim pranë Komisionit të Apelit, i cili ka konfirmuar skualifikimin e tij.

A.P., nuk është njoftuar paraprakisht, lidhur me kriterin e shikimit 10/10 para apo edhe gjatë aplikimit të tij për në Akademinë e Sigurisë. Ky kriter nuk është i shënuar as në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Aspa-s dhe as nuk është i parashikuar në Urdhërin Nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”. Githashtu në ndryshim me njoftimin për aplikim për Akademinë e Sigurisë për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, në njoftimin e publikuar për aplikim në Shkollën Bazë të Policisë për Patrullë të Përgjithshme, kriteri i shikimit është i mirëpërcaktuar në rastet e skualifikimit.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore (shikimit) nga ana e Akademisë së Sigurisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj);
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Paktin Ndërkombëtar “Për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”;
- Rekomandimin (2001)10 “Mbi Kodin Evropian të Etikës së Policisë” i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar më datë 19.09.2001;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e këtij subjekti, pasi ankuesit i është cënuar e drejta për arsim, pasi është skualifikuar nga konkurrimi në Akademinë e Sigurisë, nga ana e Komisionit të Kontrollit Shëndetësor, strukturë kjo e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi nuk plotësonte kriterin e shikimit 10/10. Parashikimi lidhur me kriterin e shikimit 10/10, të aplikantëve që konkurrojnë pranë Akademisë së Sigurisë, është parashikuar në pikën 5, të Kriterëve Shëndetësore, tek Procedurat Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”, miratuar me Urdhërin Nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ankuesi A.P., e mbart shkakun e gjendjes shëndetësore, fakt që rezultojnë nga skeda e tij mjekësore, ku rezultojnë i dokumentuar kontrolli mjekësor i shikimit të tij 7/10 në të dy sytë, akt ky i depozituar në cilësi provë nga ana e tij dhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, akte provuese për sa më sipër, janë edhe vendimi Nr. 11, datë 22.12.2021, i Komisionit të Kontrollit Shëndetësor, ku vendoset skualifikimi i aplikantit A.P., pasi konsiderohet si i paafte për të vazhduar Akademinë e Sigurisë, për arsye se ka probleme me sytë OD 7/10 dhe OS 7/10, si dhe vendimi Nr. 322, datë 30.12.2021, i Komisionit të Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë hetimit administrativ të çështjes, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka sqaruar se mbështetur në Urdhërin Nr. 888/1, datë 26.11.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është ngritur Komisioni Shëndetësor, pranë Akademisë së Sigurisë, që ka konstatuar se kandidati për praninë, shtetasi A.P., ka problem me sytë, në vizusin e syrit të majtë, sipas diagnozës (OS 7/10 dhe OD – 7/10 OU 7/10). Mbështetur në Procedurat Standarde të Pranimin në Akademinë e Sigurisë, të miratuara me Urdhërin Nr. 948, datë 17.12.2015, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Komisioni Shëndetësor citon se: “Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy” “Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi si dhe të ketë fushë vizive normale”. Komisioni Shëndetësor, me Vendimin Nr. 11, datë 22.12.2021, vendosi: “Aplikanti A.P., nuk kualifikohet për të vazhduar në fazat e tjera për në

Akademine e Sigurisë, pasi konsiderohet i paaftë për të vazhduar studimet në Akademine e Sigurisë. Gjatë rekrutimit të aplikantëve, ata duhet të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion në sy, të mos kenë shenja, plagë rreth syve dhe të kapakëve të syve.” Në vijim, Komisioni i Apelimit, i ngritur me Urdhërin Nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studentëve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademine e Sigurisë”*, pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur, ka vendosur se: *“Aplikanti A.P., nuk plotëson kriterin e shikimit”*. Në këto kushte, mbështetur në pikën 4/4 të Urdhërit Nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademine e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”*, si dhe Procedurën Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të Policisë”*, miratuar me Urdhërin Nr. 983, datë 17.12.2015, kanë vendosur rrëzimin e ankesës së A.P., pasi nuk plotëson kriteret e mësipërme.

KMD gjykon se pavarësisht se shikimi është një kriter i rëndësishëm përbërës i kriterit të përgjithshëm shëndetësor, për kandidatët që aplikojnë në Akademine e Sigurisë, sërish përcaktimi i tij në standardin 10/10 sipas pikës 5 të Procedurës Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është jo praktik dhe i përshtatshëm. Kandidatët që pranohen në Akademine e Sigurisë me shikim 10/10, mund të kenë rënie të këtij shikimi në vitet vijuese, por nga praktika nuk rezulton se për këtë shkak të jenë liruar nga detyra, por përkundrazi sikurse është pohuar nga përfaqësuesi i subjekteve këta punonjës janë sistemuar në pozicione pune të natyrës administrative. Si pasojë e këtij përcaktimi në Procedurat Standarde, ankuesi A.P., u skualifikua duke patur një shikim 7/10 në të dy sytë, ndërkohë që ka rezultuar kalues në fazat e tjera paraardhëse të Akademisë së Sigurisë. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se kriteri përjashtues i përcaktuar në Procedurat Standarte për Pranimin në Akademine e Sigurisë, Kreu IV *“Kriteret shëndetësore”*, pika 5 *“Kritere Okulistike”*¹⁵, i cili përjashton aplikantët që rezultojnë me shikim më të ulët se 10/10, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit. Komisioneri vlerëson se ky kufizim nuk është një kufizim që ka të bëjë me kritere të meritës apo aftësisë dhe se parashikimi në Procedurat Standarte kanë cënuar aspekte të tilla të rëndësishme si aksesueshmëria dhe parashikueshmëria që duhet të përmbushë akti ligjor që ndërhyr në të drejtat dhe liritë e individit. Në aspektin e së drejtës për arsim, KMD ka analizuar hollësisht Urdhërin Nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademine e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*, nëpërmjet së cilit është kryer shpallja e fazës së aplikimeve për pranimin në Akademine e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë. Në pikën 4 të tij, përcaktohet se: *“Kuotat e pranimit në Akademine e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të Arsimit të lartë, në shkencat juridike, ekonomike ose kompjuterike janë 50”*. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa kohë që për një aplikim të tillë kërkohet që aplikantët të jenë të diplomuar dhe të profilizuar në tre degë të tilla si shkencat juridike, ekonomike dhe kompjuterike, të cilët gjithashtu duhet të jenë studentë ekselence, krijohet bindja se një kategori e tillë punonjësish

¹⁵ Miratuar me Urdhërin Nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

policie, me një nivel të caktuar intelektual, do të shërbejë për rritjen e standardit të institucionit të Policisë së Shtetit, duke kryer kryesisht punë të natyrës administrative. Njëkohësisht, në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk mund të kufizohet e drejta për arsim e aplikantëve të kategorisë së sipërcituar, mbështetur në kriterin e shikimit 10/10, i cili mund të jetë i kriteri i vlefshëm për punësim në Policinë e Shtetit apo për punonjësit e policisë në detyrë, por jo për ata që duan të ndjekin arsimin në këtë Akademi. Në këto kushte, KMD gjykon se kriteri i shikimit 10/10 për këtë kategori aplikantësh passjell cënim të së drejtës për arsim.

E parë në aspektin e punësimit, KMD gjykon se në përfundim të këtij institucioni arsimor, të diplomuarit jo domosdoshmërisht do të punojnë për Policinë e Shtetit, pasi punësimi pranë një institucioni të tillë, mbështetet në një akt ku shprehet vullneti i dyanshëm i palëve. Por, edhe nëse vendosin të aplikojnë për një vend pune pranë këtij institucioni, mund të përzgjedhin aplikim për një pozicion pune me natyrë administrative. Pozicionimi i punonjësve të policisë së shtetit në detyrë në pozicione pune të natyrës administrative, kur shikimi i tyre nuk është në parametrat 10/10 është një fakt i pohuar edhe gjatë seancës dëgjimore që Komisioneri zhvilloi për shqyrtimin e kësaj ankese.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në asnjë rast nuk u arrit të provohej që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankuesit kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprimeve dhe mosveprimeve ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me anë të përcaktimit të kriterit të shikimit 10/10, në Procedurat Standarde, miratuar me Urdhrin Nr. 984 datë 17.12.2015, e Drejtorit të Policisë së Shtetit, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese ankuesin A.P., duke i mohuar të drejtën për arsim, për shkak të gjendjes shëndetësore.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, në të drejtën për arsim, të ankuesit A.P., për shkak të gjendjes shëndetësore, si pasojë e parashikimit të kriterit skualifikues të shikimit 10/10, të parashikuar në Kreun IV, “*Kriteret Shëndetësore*”, “*Kriteret e Përgjithshme për Aplikantët*”, pika 5 “*Kritere okulistike*”, të Procedurave Standarde “*Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë*”, miratuar me Urdhërin Nr. 983, datë 17.12.2015, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, në të drejtën për arsim, të ankuesit A.P., për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Akademisë së Sigurisë.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marri masa për heqjen e kriterit skualifikues të shikimit 10/10 për pranim në Akademinë e Sigurisë, për aplikantët që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë.

IX. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

36. A.Z., kundër Shkollës së Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër

VENDIM NR. 32, DATË 03.02.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Institucioni arsimor profesional refuzon të regjistrojë vajzën e ankuesit, për shkak se është me aftësi të kufizuar, grupi i parë.

FAKTET

Ankuesi është babai i një vajze me aftësi të kufizuar të quajtur F.Z., e datëlindjes 20.10.2002. Bazuar në vendimin e Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), Rrethi Tiranë, Niveli i Parë Neurologji-N/Kirurgji, F.Z., është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, grupi i parë. Referuar këtij vendimi, KMCAP, gjithashtu ka vlerësuar se, F.Z., ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër. Vajza e ankuesit, F.Z., ka përfunduar arsimin 9 vjeçar, në Shkollën 9-vjeçare Speciale “3 Dhjetori”, Shkodër. Me qëllimin që vajza e tyre të integrohej dhe të fitonte aftësi profesionale që mund ti përdorë në të ardhmen, ankuesi ka kërkuar që vajza e tij të regjistrohej në një shkollë profesionale dhe konkretisht në Shkollën e Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, klasa X, dega përpunim druri. Shkolla ka refuzuar të regjistrojë vajzën e ankuesit. Shkolla nuk i ka dhënë ankuesit një përgjigje të arsyetuar dhe në formë shkresore, në lidhje me arsyet e refuzimit të regjistrimit të vajzës në shkollë.

Gjatë shqyrtimit, Shkolla parashtroi disa arsye në lidhje me refuzimin për të regjistruar vajzën e ankuesit, faktin se ankuesi nuk kishte depozituar epikrizën e vajzës; për shkak se vajza e ankuesit nuk plotësonte kriterin e moshës, pasi ishte më e madhe se 18 vjece; shkolla nuk kishte në organikë mësues ndihmës dhe proceset e praktikës në shkollë ishin të rrezikshme për vajzën e ankuesit, pasi ajo kishte nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të një personi tjetër.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzimi Nr. 14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave;
- Udhëzimi N. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

KONKLUZIONE

Komisioneri arrin në përfundimin se F.Z., vajza e ankuesit A.Z., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë, duke iu refuzuar regjistrimi në klasën e X, të arsimit të mesëm profesional, pranë Shkollës së Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, për vitin shkollor 2021-2022. Ligji i posaçëm Nr. 15/2017, që rregullon arsimin e mesëm mesëm profesional, nuk përmban një rregullim të posaçëm lidhur me regjistrimin në shkollë për personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj dhe aktet e tij nënligjore, nuk kanë parashikime të ndryshme për regjistrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, ndërsa rezulton se drejtuesja e Shkollës ka vendosur të mos e regjistrojë vajzën e ankuesit me pretendimin se nuk ishin depozituar të gjitha dokumentat e nevojshme për regjistrimin. Në këtë mënyrë, drejtuesja e Shkollës ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme vajzën e ankuesit, duke kërkuar për regjistrimin e saj në shkollë vendimin e KMCAp, në raport me nxënësit e tjerë që nuk kanë aftësi të kufizuara.

Vajza e ankuesit, F.Z., është vlerësuar si person me aftësi të kufizuara e grupit të parë. Bazuar në mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuara sipas Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të tij, rezulton se vlerësimi si person me aftësi të kufizuara “grupi i parë” tregon një shkallë më të rëndë dëmtimi, në krahasim me vlerësimin si person me aftësi të kufizuara “grupi i dytë”. Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se fakti që nxënës të tjerë janë të regjistruar në shkollë, nuk rrëzon *apriori* pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuara. Zbatimi i trajtimit të barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi garantohet edhe midis llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuara.

Mësuesi ndihmës dhe ndihmësi personal, për personat me aftësi të kufizuara, kanë funksione dhe detyra të ndryshme. Mësuesi ndihmës dhe ndihmësi personal, kanë të përbashkët vetëm faktin se

ato janë forma të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, por rregullohen nga legjislacione të ndryshme, synojnë integrimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në drejtime të ndryshme dhe për rrjedhojë kanë funksione dhe kompetenca të ndryshme, të cilat nuk mund të mbivendosen. Pavarësisht se në shkollë mund të ketë nxënës të tjerë me aftësi të kufizuara të cilët sipas vendimit të KMCAP nuk kanë ndihmës personal, kjo nuk nënkupton që këta nxënës nuk kanë nevojë për mbështetjen me mësues ndihmës.

Komisioneri konstaton se, në radhë të parë Shkolla nuk duhet të refuzonte regjistrimin e F.Z., në shkollë me pretendimin se nuk kishte depozituar vendimin e KMCAP, pasi ky nuk është një dokument që kërkohet për regjistrimin në shkollë. Nga ky moment duke vendosur një kërkesë shtesë ndaj vajzës së ankuesit, por edhe personave me aftësi të kufizuara, Shkolla ka vendosur në kushte të pafavorshme nxënësit me aftësi të kufizuara. Komisioneri vlerëson se, Shkolla me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas akteve në fuqi nga ana e ankuesit duhet të kishte proceduar me regjistrimin e F.Z.

Justifikimi i Shkollës për refuzimin e regjistrimit të nxënëses F.Z., pasi ndjekja e praktikës profesionale nga ana e saj do të përbënte rrezik për jetën dhe shëndetin e saj, në kushtet kur F.Z., është vlerësuar nga KMCAP se ka nevojë për ndihmën personal dhe Shkolla nuk ka në organikë një mësues ndihmës, është i pabazuar. Rrezikshmëria në lidhje me llojin dhe natyrën e aktivitetit që duhet kryer, përbën një qëllim të ligjshëm, për të ndaluar apo për të refuzuar kryerjen e aktivitetit, përfshi këtu edhe ndjekjen e arsimit të mesëm profesional. Siguria e shëndetit dhe jetës së një personi prevalon dhe mund të justifikojë, ndalimin për të ndjekur arsimin e mesëm profesional. Çështja që shtrohet në këtë situatë është, nëse midis këtij qëllimi të ligjshëm dhe mjetit të përdorur, pra refuzimit për të regjistruar në shkollë vajzën e ankuesit, ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të realizohet. Në çështjen objekt shqyrtimi rezulton se, natyra e praktikës profesionale për drejtimin e përzgjedhur nga vajza e ankuesit, rezulton të jetë në përputhje me nivelin e pranueshëm të rrezikut për nxënësit që ndjekin shkollën, për sa kohë ato janë të lejuara të performohen. Praktika profesionale që kryhet pranë kësaj Shkolle, gjithashtu është brenda nivelit të pranueshëm të rrezikut edhe për nxënësit me aftësi të kufizuara, për sa kohë që Shkolla pranon që ka nxënës të tjerë me aftësi të kufizuara. Drejtuesja e Shkollës, ka vlerësuar se, për shkak se vajza e ankuesit sipas vendimit të KMCAP ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi tjetër, kryerja e praktikës profesionale nga ana e vajzës së ankuesit paraqet rrezikshmëri shumë të lartë për aksidente për shëndetin dhe jetën.

Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ndjekjen e arsimit profesional nga personat me aftësi të kufizuara, nuk parashikojnë rregullime të posaçme për të vlerësuar nëse një nxënës me aftësi të kufizuara mundet ose jo të ndjekë arsimin e mesëm profesional. Në rastin e vajzës së ankuesit, ndohemi në një situatë kur sjellja e pretenduar si diskriminuese është konsumuar duke i refuzuar vajzës së ankuesit regjistrimin në shkollë. Drejtuesja e Shkollës, në mungesë të rregullimeve të posaçme dhe pa patur asnjë kompetencë për të kryerë ajo vlerësimin e F.Z., si person me aftësi të kufizuara, ka konkluduar se ndjekja e shkollës nga vajza e ankuesit do të përbënte një rrezik të lartë për të dhe në atë nivel, që në mungesë të një mësuesi ndihmës ose një personi tjetër që mund

ta shoqëronte e kishte të pamundur që të ndiqte shkollën në drejtimin e përzgjedhur. Drejtuesja e institucionit, sikurse rezulton edhe nga informacioni i administruar nuk rezulton që, minimalisht, nëpërmjet një komisioni të brendshëm në shkollë, në kushtet kur nuk ka rregullim ligjor, të ketë vlerësuar në praktikë aftësitë e F.Z., për të ndjekur ose jo praktikën profesionale në shkollë. F.Z., sikurse pretendohet nga Shkolla ka qëndruar në ambientet e Shkollës vetëm për pak orë në ditën e fillimit të vitit shkollor dhe nuk rezulton që të jetë përfshirë në ndonjë praktikë profesionale. Drejtuesja e Shkollës ka arritur në përfundimin se, vajza e ankuesit nuk mund të kryejë praktikën profesionale, jo duke gjykuar në mënyrë konkrete dhe objektive, por duke paragjykuar aftësitë e F.Z., vetëm për faktin se ajo është person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmësin personal, për kapërcimin e pengesave në jetën e përditshme.

Rezulton se, F.Z., i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm e të pabarabartë edhe në raport me nxënësit e tjerë me aftësi të kufizuara të cilët janë regjistruar në shkollë. Kjo diferencë në trajtim midis F. dhe nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollë bazohet në llojin/shkallën e dëmtimit. Ndërsa F.Z., është vlerësuar person me aftësi të kufizuara grupi i parë, nxënësit e tjerë janë vlerësuar si persona me aftësi të kufizuara grupi i dytë. Është pikërisht lloji/shkalla e dëmtimit që kushtëzon edhe nevojën për përfitimin ose jo të ndihmësit personal/kujdestari nga personi me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, vajza e ankuesit në momentin e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022, ka qenë jo më shumë se 18 vjeçe, në përputhje me kriterin e moshës të vendosur nga udhëzimi Nr. 14/2021, duke mos patur pengesa në drejtim të moshës për regjistrimin e saj në klasën X të arsimit të mesëm profesional pranë kësaj shkolle. Komisioneri konstaton se, nëse mosha do të ishte një shkak që pengonte regjistrimin në shkollë, atëherë nuk do të ishte e nevojshme që shkolla t'i drejtohej ZVAP Shkodër për vendosjen në dispozicion të Komisionit Multidisiplinor ose të kërkonte vendimin e KMCAP. Justifikimi i Shkollës se praktika profesionale përbën rrezik për F.Z., në kushtet kur mosha mund të përbente një shkak të bazuar për refuzimin e regjistrimit, është i panevojshëm.

Komisioneri arriti në përfundimin se, nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis qëllimit të ligjshëm të synuar, që është mbrojtja e shëndetit dhe jetës së vajzës së ankuesit dhe mjetit të përdorur në rastin konkret, pra refuzimit për ta regjistruar F.Z., në klasën e X të arsimit të mesëm profesional, pranë kësaj Shkolle. Nuk rezultoi e provuar se është bërë një vlerësim i vërtetë, objektiv dhe i individualizuar për rastin e vajzës së ankuesit. Komisioneri gjykoi se, justifikimi i shkollës për refuzimin e regjistrimit të F.Z., nuk është objektiv dhe i arsyeshëm. Për rrjedhojë, në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, trajtimi diferencues dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar F.Z., përbën diskriminim.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të F.Z., në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuara, nga ana e Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër.
- Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, duhet të marrë masa urgjente për regjistrimin e F.Z., në shkollë.

- Me qëllim parandalimin në të ardhmen të sjelljeve diskriminuuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të marrë masa urgjente për miratimin e aktit nënligjor përkatës për përcaktimin e kritereve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, për personat me aftësi të kufizuara ndjekin arsimin dhe formimin profesional.
- Rekomandohet Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, që të rishikojë mundësinë e mbledhjes dhe vlerësimit nga komisioni multidisiplinar në juridiksionin e saj, të rasteve për të cilat shkolla ka paraqitur kërkesën, deri në rregullimin e posaçëm të situatës lidhur me vlerësimin dhe caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm profesional.

37. Fondacioni “Së Bashku” kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

VENDIM NR. 182, DATË 21.09.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

Diskriminim të personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore, Bashkia Durrës.

FAKTET

Rezulton se godinat ku ofrojnë shërbimet shëndetësore Ambulanca Arapaj 1, Ambulanca Shkallnur dhe Poliklinika e Specialiteteve Durrës nuk përmbushin kriteret e miratuara të aksesueshmërisë që duhet të plotësojnë ndërtesat ku ofrohen këto lloj shërbimesh. Rrjedhimisht personat me aftësi të kufizuara nuk i përfitojnë shërbimet shëndetësore në baza të barabarta me të tjerët për shkak të ekzistencës së barrierave dhe mungesës së aksesueshmërisë fizike në këto godina.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti Nr. 14/2000 *“E drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit”*, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025;
- Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 20.05.2020.

KONKLUZIONE

Duke mbajtur në konsideratë se:

Ambulanca Arapaj 1/Arapaj Poshtë dhe Ambulanca Shkallnur janë ndërtuar para se të jenë miratuar kriteret e detyrueshme në lidhje me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara; Nga momenti i ndërtimit të objekteve të mësipërme shëndetësore, MSHMS nuk ka kryer investime të mëtejshme;

Kriteret e zbatuara në lidhje me përzgjedhjen e QSH/Ambulancave që i nënshtrohen rikonstruksionit gjatë vitit 2022, janë kritere objektive dhe për rrjedhojë është në diskrecionin e MSHMS që duke zbatuar në mënyrë të bazuar këto kritere të përzgjedhë në mënyrën më të mirë objektet shëndetësore;

Ambulanca Arapaj Sipër/Arapaj 2, e cila është përzgjedhur për t’u nënshtuar rikonstruksionit për vitin 2022 është pjesë e Qendrës Shëndetësore Rrashbull, nga e cila varen edhe shërbimet shëndetësore që ofrohen në Ambulancën Arapaj 1/Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur; MSHMS, në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, ka marrë masa duke rikonstruktuar 300 qendra shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë vendin, përgjatë viteve 2018-2021,

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me Ambulancën Arapaj 1/Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur, të dyja objekte shëndetësore në varësi të Qendrës Shëndetësore Rrashbull, të vendosura në Njësinë Administrative Rrashbull, të Bashkisë Durrës, MSHMS arriti të provojë se ka marrë masa për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë e Qendrave Shëndetësore dhe Ambulancave dhe rrjedhimisht, ekziston një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në këto dy objekte shëndetësore.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, MSHMS, nuk ka diskriminuar personat me aftësi të kufizuara të cilët marrin shërbime shëndetësore në Njësinë Administrative Rrashbull.

Duke mbajtur në konsideratë se:

Në Kreun I, pika 16, të VKM Nr. 1074/2015, parashikohet se: *“16. Ndalohet dhënia e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim.”*;

Pavarësisht se godina e Poliklinikës Qendrore të Specialiteteve Durrës, është ndërtuar përpara miratimit të standardeve të detyrueshme të aksesueshmërisë, në godinë janë realizuar investime të cilat nuk kanë adresuar çështjen e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. MSHMS nuk shpjegoi se përse në investimin e kryer në godinën e Poliklinikës në vitin 2016 nuk ishte adresuar çështja e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara apo se cilat ishin shkaqet objektive që e kishin vendosur atë në pamundësi për të adresuar aksesueshmërinë në vitin 2016; Poliklinika Qendrore e Specialiteteve Durrës, ofron shërbime mjekësore për një numër të madh personash dhe mbulon me shërbim jo vetëm qytetin e Durrësit por edhe Njësitë Administrative dhe fshatrat e kësaj bashkie. Në këtë mënyrë, personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në këto zona, nuk kanë alternativa në zona të afërta me vendbanimin e tyre për të marrë shërbimet mjekësore sipas specialiteteve lidhur me nevojat e tyre;

Shërbimi shëndetësor nga mjekët specialistë në katin e parë, duke zbritur nga kati i dytë dhe i tretë i godinës së Poliklinikës, nuk ofrohet në mënyrë dinjitoze dhe në kushte të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstaton se, MSHMS në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve Durrës.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve Durrës, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet shëndetësore që ofrohen në këtë objekt shëndetësor dhe se MSHMS nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt shëndetësor.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara që marrin shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, Durrës, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët që përfitojnë shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, Durrës, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Në referim të pikës 1, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet të marrë masat e mëposhtme:
- Të sigurojë në mënyrë të përsheptuar aksesueshmërinë në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, në përputhje me stadardet ligjore në fuqi.
- Të sigurojë aksesueshmërinë në Ambulancën Arapaj1/Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur, e në vazhdimësi në të gjitha Qendrat Shëndetësore dhe Ambulancat në të gjithë vendin, në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme, në përputhje me stadardet ligjore në fuqi.
- Të udhëzojë të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor, që të sigurojnë rast pas rasti përshtatjen e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuar.
- Të mos ketë pengesa administraive dhe të sigurohen të gjitha lehtësitë në mënyrë që, deri në garantimin e aksesueshmërisë në të gjitha Qendrat Shëndetësore/Ambulancat, personat me aftësi të kufizuar të marrin shërbimin shëndetësor, në ato ambulanca të cilat janë të aksesueshme.
- Në përfundim të procesit të rikonstruksionit të godinës së Ambulancës Arapaj 2/Arapaj Sipër dhe marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar, të depozitojë pranë Komisionerit dokumentacionin e nevojshëm që provon garantimin e standardeve të miratuara në lidhje me aksesueshmërinë.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuar, të cilët marrin shërbime shëndetësore në Njësinë Administrative Rrashbull, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

38. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 189, DATË 10.10.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira e shërbime
Statusi: Në proces

Mospërmbushja e standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Fondacioni “Së Bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në Kavajë.

Bashkia Kavajë informoi Komisionerin se, shkolla nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar dhe problematika ishte konstatuar në vitin 2022. Në lidhje me këtë problematikë, Bashkia ka bërë kërkesë për investim me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUZIONE

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr. 1503/2008. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në arsim në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukurore në ndërtesën e Shkollës 9-vjeçare “Rilindja” në qytetin e Kavajës, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesin në arsim.

Është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore që të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. Objekt i ankesës në shqyrtim është Shkolla 9-vjeçare “Rilindja”, e cila është pjesë e sistemit shkollor parauniversitar dhe është një shkollë në juridiksionin e Bashkisë Kavajë. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e Bashkisë Kavajë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është Shkolla 9-vjeçare “Rilindja”, të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesës së kësaj shkolle. Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa e Shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, në qytetin e Kavajës, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Kavajë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuara.

Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që ndjekin arsimin në këtë objekt arsimor. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, personat me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për arsim. Megjithatë sipas KDPK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv. Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se, Shkolla 9-vjeçare “Rilindja” është rindërtuar në vitin 2017 me një vlerë investimi prej 98.537.415 lekë me TVSH. Pra, pavarësisht se standardet e aksesueshmërisë për institucionet arsimore ekzistojnë që prej vitit 2008, Bashkia Kavajë e cila ka rindërtuar shkollën në vitin 2017, nuk i ka përmbushur këto këto standarde, duke dështuar që të sigurojë aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në këtë institucion arsimor. Bashkia Kavajë ka investuar një vlerë të konsiderueshme duke rindërtuar shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në vitin 2017 në kundërshtim me parashikimin e mësipërm, i cili ndalon çdo financim, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara, për sa kohë që shkolla e rindërtuar nuk përmbush kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë të parashikuara në këtë vendim. Pretendimi i Bashkisë Kavajë se, problematika në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë është konstatuar në vitin 2022, është i papabuar dhe vjen në kundërshtim me detyrimet e mësipërme ligjore.

Bashkia Kavajë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me evidentimin e objekteve ekzistuese arsimore dhe jo vetëm, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Rezulton se, Bashkia Kavajë, nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë e objekteve apo shërbimeve në juridiksionin e saj për personat me aftësi të kufizuara.

Duke mbajtur në konsiderat natyrën dhe llojin e ndërtesës që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një institucion arsimor, Komisioneri vlerëson se, Shkolla 9-vjeçare “Rilindja” është një ndërtesë me frekuencë të lartë të frekuentimit, ndryshe nga ndërtesa të tjera që në varësi të natyrës së shërbimeve që ofrojnë mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Nga ana tjetër, Shkolla “Rilindja” është një shkollë 9-vjeçare, pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe si i tillë ai përbën një nga detyrimet thelbësore të cilat duhet të përmbushen në kuadër të garantimit të drejtës për arsim.

Komisioneri konstaton se, Bashkia Kavajë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” në Bashkinë Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” në Bashkinë Kavajë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshtatshme aksesueshmërinë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

39. Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Hardhisht)

VENDIM NR. 123, DATË 20.06.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mospërmbushja e standardeve të aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a., Hardhisht.

FAKTET

Fondacioni “Së Bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., Hardhisht, diskriminon personat me aftësi të kufizuar. Zyra Postare Hardhisht, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a., Durrës. Rezulton që shërbimet në Zyrën Postare Hardhisht ofrohen në ambientin e një kioske. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a., kioska ka një sipërfaqe 27 (njëzetë e shtatë) m². Posta Shqiptare sh.a., prapësoi duke pretenduar se zyra postare përmbush kërkesat që lidhen me aksesueshmërinë për klientët që janë persona me aftësi të kufizuar, sepse kioska ndodhet rrafsh me tokën. Posta Shqiptare sh.a., deklaroi se kjo zyrë postare është vendosur në vitin 2008 dhe që atëherë nuk është kryer ndonjë investim, pasi ambienti është kioskë, por mirëmbahet çdo ditë dhe është në funksion të plotë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUZIONE

Komisioneri thekson se, garantimi i aksesueshmërisë dhe heqja e barrierave infrastrukturore në ndërtesa ose godina, ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara shërbimet e ndryshme që ofrohen nga subjektet publike dhe private. Në këtë kontekst, nëse ofruesi i shërbimit ka zgjedhur që të ofrojë shërbimet në një ambient “kioskë” dhe jo në një godinë ose ndërtesë, nuk e zhbën detyrimin e subjektit për të garantuar ofrimin e shërbimeve për të gjithë klientët në baza të barabarta, pa asnjë diskriminim bazuar në aftësinë e kufizuar. Ambienti i zgjedhur nga ofruesi i shërbimit, në rastin konkret Posta Shqiptare sh.a., duhet të jetë i tillë që të mundësojë akses për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri evidenton se, Posta Shqiptare sh.a., ka një kuptim jo të saktë në lidhje me aksesueshmërinë. Sikurse më sipër rezulton nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, aksesueshmëria nuk është e garantuar nëse objekti nuk ka shkallë ose në prezencë të shkallëve objekti është i pajisur me rampë. Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Hardhisht.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Zyra Postare Hardhisht nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Hardhisht. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Hardhisht, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Posta Shqiptare sh.a., deklaroi se Zyra Postare Hardhisht, është vendosur në vitin 2008 dhe në këtë zyrë nuk është kryer asnjë investim, pasi ambienti është “kioskë”. Komisioneri vlerëson se, pavarësisht këtij fakti, Posta Shqiptare sh.a., që prej vitit 2008, kur ka filluar veprimtarinë e saj Zyra Postare Hardhisht e deri në vitin 2022, duhet të kishte marrë masa që të përshtaste ambientin ku ofrohen shërbimet, pavarësisht faktit se, ambienti i zgjedhur prej saj është “kioskë”. Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pabazuar, nuk ka marrë asnjë masë për të përshtatur ambientin ku ofrohen shërbimet, qoftë duke rishikuar standardet e ambientit “kioskë” apo duke vlerësuar mundësinë e zhvendosjes së ambienteve të Zyrës Postare Hardhisht në një godinë apo ndërtesë që plotëson kriteret dhe standardet e aksesueshmërisë. Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Hardhisht, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Hardhisht. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se:

Posta Shqiptare sh.a., ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin Nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit, Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin Nr. 111, datë 10.06.2022, të Komisionerit, Zyra Postare Shijak, konstatuar me vendimin Nr. 115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.

Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a, nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM Nr. 1503/2008, miratimin e VKM Nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e

shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit Nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndaj personave me aftësi të kufizuara është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit në *formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Hardhisht.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:
- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Hardhisht, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*”.
- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

40. Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a., (Zyra Postare Qendër Durrës)

VENDIM NR. 111, DATË 10.06.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në qendër të Bashkisë Durrës.

FAKTET

Fondacioni “Së Bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare në qendër të Bashkisë Durrës, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., diskriminon personat me aftësi të kufizuar. Zyra Postare Qendër Durrës, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a., Durrës. Rezultoi që godina ku ofrohen shërbimet nga ana e kësaj zyre postare, ka në hyrje të saj shkallë. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Posta Shqiptare sh.a., deklaroi se kjo zyrë postare do t’i nënshtrohej rikonstruksionit në vitin 2022 ku është parashikuar ndërtimi i rampës hyrëse.

Posta Shqiptare sh.a., nuk dha asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë të parashikuara nga VKM Nr. 1503/2008 apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUZIONE

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ndërtesa ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Qendër Durrës, ka në hyrje të saj shkallë, të cilat përbëjnë pengesa infrastrukturore dhe nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuar në lëvizje të cilët janë përdorues të karriges me rrota që të hyjnë në ndërtesë dhe të marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Ndërtesa ku ofrohen shërbimet nuk është e pajisur me rampë, që është një nga elementët e parashikuar për eliminimin e pengesave ose barrierave. Shkallët dhe mungesa e rampës, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standartesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr.1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët ngashërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Qendër Durrës. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ndërtesën ku ofrohen shërbimet nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Qendër Durrës, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet akses për të marrë shërbimet e ofruara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa ku ushtron veprimtarinë Zyra Postare Qendër Durrës, pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a., Durrës, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve prej saj. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Durrës.

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se, Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuara

Rezultoi se Posta Shqiptare sh.a., nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike. Komisioneri arrin në përfundimin se Posta Shqiptare sh.a., nuk ka marrë asnjë masë për të planifikuar dhe për të realizuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Në kushtet kur Zyra Postare Qendër Durrës, nuk përmbush kriteret teknike dhe rrjedhimisht nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht investimeve të vazhdueshme që Posta Shqiptare sh.a., deklaron se kryen për krijimin e kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve, faktet dhe provat e administruara tregojnë se, investimet që mund të jenë kryer nuk kanë adresuar në mënyrë të barabartë nevojat midis personave me aftësi të kufizuara dhe pjesës tjetër të qytetarëve që nuk kanë aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Durrës, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a., dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Durrës. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Durrës.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Durrës, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë

19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

- ii. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

41. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Durrës, Bashkisë Shijak, Bashkisë Krujë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

VENDIM NR. 41, DATË 28.02.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë dështuar për të garantuar aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara.

FAKTET

Fondacioni “Së Bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, në Bashkinë Durrës, Bashkinë Shijak dhe Bashkinë Krujë.

Nga monitorimet e kryera pala ankuese ka konstatuar problematika në lidhje me plotësimin e kushteve të QV duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërinë në QV ka sjellë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së votës për Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë. Pala ankuese pretendon gjithashtu se personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar nga udhëzimi Nr. 1, datë 5.12.2021, i KQZ-së, pasi sipas saj ky akt nuk garanton mekanizma kontrollipër plotësimin e kushteve në QV për personat me aftësi të kufizuara.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 1 dhe Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), *mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Udhëzimi i Komisionit Rregullator të KQZ Nr. 1, datë 05.12.2020 *“Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”*;
- Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 33, datë 16.12.2020 *“Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”*.

KONKLUSIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se qendra votimi në Bashkinë Durrës dhe Shijak ishin të vendosura në ndërtesa që nuk përmbushin standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë këto njësi të vetëqeverisjes vendore, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për të shprehur të drejtën e votës në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me

zgjedhësit e tjerë. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nuk u konstatuan shkeljet e ngritura nga pala ankuese në lidhje me Bashkinë Krujë.

Në pamje të praktika që ndiqet gjatë procedit zgjedhor është e njëjtë për të gjithë zgjedhësit, të cilët votojnë dhe hedhin votën e tyre në të njëjtat qendra votimi. Pra nuk ka asnjë trajtim të diferencuar midis zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe atyre pa aftësi të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuar në pamje të parë nuk kanë patur pengesë që të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021 dhe për të hedhur votën e tyre në qendrat e votimit respektive, por në realitet për shkak të barrierave në qendrat e votimit, e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të votuar bëhet e pamundur. Pra, barrierat në qendrat e votimit dhe mungesa e aksesueshmërisë në qendrat e votimit e vendoskategorinë e personave me aftësi të kufizuara në kushte më pak të favorshme në raport me zgjedhësit e tjerë. Barrierat dhe mungesa e aksesit në qendrat e votimit prek në një mënyrë më negative kategorinë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

E drejta e votës është e drejtë thelbësore dhe jo privilegj. E drejta e votës universale kërkon që të gjithë qytetarët të kenë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në jetën politike të vendit, siç parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në të drejtën kombëtare. Aksesueshmëria e plotë në çdo fazë të procesit të votimit në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë rregulli dhe jo përjashtimi. Aksesueshmëria është një kërkesë e pakushtëzuar dhe nuk mund të zbehet duke referuar tek “barra disproporcionale” pasi është parakusht për gëzimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore në pozitë të barabartë me të tjerët.

Në praktikë, aksesit i personave me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre në baza të barabarta me ato të personat pa aftësi të kufizuara shpesh mbetet një mendim i dëshiruar që rezulton i pamjaftueshme, gjë që përkthehet në pjesëmarrje dukshëm më të ulët të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor dhe i margjinalizon më tej këtë pjesë të shoqërisë. Masat alternative ose të përkohshme të aksesueshmërisë nuk duhet të përdoren si zëvendësues i përhershëm, në vend të sigurimit të aksesit të plotë të qendrave të votimit.

Standartet teknike të aksesueshmërisë janë miratuar prej një kohe të gjatë dhe e drejta ndërkombëtare e ratifikuar nga Shqipëria dhe legjislacioni kombëtar vendosin detyrimin për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që të garantohet në baza të barabartë me të tjerët e drejta e tyre për të marrë pjesë në jetën politike të vendit.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve me aftësi të kufizuara duhet t’i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situate janë ndërmarrë hapa për t’i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nga ana e Bashkisë Durrës dhe Bashkisë Shijak, nuk uparashtrua asnjë pretendim në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë në qendrat e votimit në juridiksionin e tyre.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi standarteve të aksesueshmërisë në qendrat e votimit në Bashkinë Durrës dhe në Bashkinë Shijak, ka sjellë mohim të aksesit për personat me

aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në të drejtën e tyre për të votuar në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe për të marrë pjesë në jetën politike. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri nuk gjen asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Durrës dhe Bashkia Shijak, kanë dështuar që të trajtojnë në mënyrë të diferencuar nëvojat e personave me aftësi të kufizuara për të patur akses në qendrat e votimit, duke i vendosuar ata në një situatë diskriminuuese.

Në referim edhe të nenit 31, të Konventës “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, Komisioneri vlerëson se, është e nevojshme që KQZ-ja të përcaktojë dhe të rregullojë mënyrën e mbledhjes së të dhënave në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara që kanë ushtruar të drejtën e votës. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të identifikuar dhe për të adresuar barrierat me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtës së votës. Aktualisht gjatë procesit zgjedhor administrohen të dhëna paraprake në lidhje me identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara të regjistruar, por jo se sa prej tyre kanë ushtruar efektivisht të drejtën e votës. Mbledhja dhe analiza e të dhënave, para dhe pas procesit zgjedhor, janë masa thelbësore për monitorimin e politikave dhe ligjeve kundër diskriminimit. Të dhënat para dhe pas procesit zgjedhor, duhet të ndahen jo vetëm sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale.

Komisioneri gjykon se, pavarësisht efikasitetit të mekanizmave të parashikuar në udhëzimin e miratuar nga ana e KQZ-së, përgjegjësia ligjore për të garantuar aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara i takon njësisve të vetëqeverisjes vendore.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Durrës.
- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Shijak.
- Konstatimi i mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Krujë.
- Konstatimi i mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Durrës, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- Në referim të pikës 2, Bashkia Shijak, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si palë të përfshira në procesin zgjedhor, sipas fushës respektive të përgjegjësisë, duhet të

marrin masa për të mbledhur në mënyrë të saktë dhe të qartë dhe për të monitoruar në mënyrë efektive, të dhënat për personat me aftësi të kufizuara, para çdo procesi votimi, me qëllim adresimin e duhur të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

- Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e masave të mëposhtme:
 - i. të rishikojë Udhëzimin e Komisionit Rregullator Nr. 1, datë 05.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet” me qëllim përfshirjen e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë që duhet të plotësojnë qendrat e votimit, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
 - ii. të miratojë udhëzime të posaçme lidhur me procesin e votimit të personave me aftësi të kufizuara dhe të zhvillojë trajnime të posaçme për administratën zgjedhore lidhur me procesin e votimit nga personat me aftësi të kufizuara;
 - iii. të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e detyrimeve sa i takon personave me aftësi të kufizuara, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;
 - iv. të marrë masa për të mbledhur të dhëna në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuar të regjistruar në zgjedhje dhe atyre që kanë votuar në zgjedhje, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale, duke përfshirë edhe aspektin gjinor.

42. Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 180, DATË 19.09.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë, është përfituese sipas Ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” dhe ka kërkuar të pajiset nga ana e Bashkisë, me një ambient pune ku të ushtrojë veprimtarinë e saj. Bashkia nuk e ka pajisur Shoqatën me zyrë/ambient pune, duke e diskriminuar atë për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Me anë të Vendimit Nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë” (në vijim cituar *Shoqata*), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Tiranë, me kohëzgjatje të papërcaktuar.

Përfaqësuesi i Shoqatës, i është drejtuar disa herë Bashkisë Tiranë për pajisjen me zyrë për përdorim të Shoqatës, për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë së saj, por nuk ka gjetur mbështetje dhe zgjidhje nga ana e Bashkisë. Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, njeh rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve. Në këtë kontekst, shteti financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj mjedise pune, të cilat ua jep në përdorim.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM Nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Plani Kombëtar i Veprimtimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 - 2025.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstaton se, referuar periudhës kohore kur janë nënshkruar një pjesë e kontratave të qirasë, kohëzgjatjes së tyre, si dhe periudhave kohore kur janë paraqitur kërkesat e Shoqatës pranë Bashkisë për pajisjen me ambjente pune, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, Bashkia ka pasur mundësi konkrete për të përmbushur detyrimin e saj ligjor lidhur me kërkesën e përsëritur të Shoqatës.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, Shoqata, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes mosofrimit të një mjedisi pune/zyrë, megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e Shoqatës.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, Shoqatës, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata deri në muajin shkurt 2022, i kishin vënë në dispozicion asaj, mjedise pune (në pronësi të Bashkisë), për përdorim pa kundërshpërblim nga ana e Shoqatës.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur. Mundësia e posedimit të një mjedisi të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqatës, e cila në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është një element i rëndësishëm në garantimin e ushtrimit dhe funksionimit të punës së tyre, për të cilën ajo ekziston si e tillë.

Bashkia nuk solli asnjë parashtrim, dokumentacion, fakt apo provë, lidhur me sa më sipër, megjithë detyrimin e saj për t'u përgjigjur e për të bashkëpunuar insitucionalisht me KMD-në, në funksion të sqarimit e zgjidhjes së problematikës së shqyrtuar, megjithëse kishte marrë dijeni shkresërisht për të.

Referuar kuponëve të shërbimit postar lidhur me marrjen në dorëzim të shkresave të KMD-së, si dhe shkresës me të cilën Bashkia Tiranë dërgoi parashtrimet e veta lidhur me sqarimin e problematikës së Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, dhe jo të subjektit ankues, Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve, Dega Tiranë.

Komisioneri thekson faktin se këto dy shoqata janë subjekte të ndryshme juridike, të cilat operojë veçmas dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pavarura nga njëra-tjetra, bazuar ë statutet dhe aktet rregullatore përkatëse, dhe të njohura si të tilla, sipas vendimeve respektive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri vlerëson si të pranuar prej Bashkisë, faktin se nga ana e saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo hap procedural në përmbushje të së drejtës së Shoqatës për t'u pajisur me një mjedis të përshtatshëm pune/zyrë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Komisioneri konstaton se Bashkia Tiranë, me mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, “Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë Dega Tiranë”, në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për posedimin e një mjedisi të përshtatshëm pa kundërshtim, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

43. Fondacioni “Së Bashku” kundër Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP)

VENDIM NR. 57, DATË 18.03.2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Zbatuar

Personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar nga TKOB lidhur me: çmimin e biletave të shitura për shfaqjen “La Boheme”, të datës 15.12.2021 dhe mungesën e vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të TKOBAP.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin Nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Personat me aftësi të kufizuar (*përfshirë edhe vetë ankuesen, shtetasen S.L.,*) janë trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e TKOB, lidhur me: çmimin e biletave të shitura për

shfaqjen “La Boheme”, të datës 15.12.2021 dhe mungesën e vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të TKOBAP, sipas përcaktimeve respektive ligjore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, neni 4 dhe 5;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka konstatuar se përjashtimi i kategorive të veçanta të personave me aftësi të kufizuar, përveç atyre kategorive që citohen nominalisht në faqen zyrtare të web-it të TKOBAP, nga e drejta e përfitimit të mundësisë për reduktim të çmimit të biletës; i privon ata nga e drejta për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë me kategoritë e PAK të cilët rezultojnë përfitues, që janë: invalidët e punës, të verbërit dhe para e tataplegjikët.

Lidhur me këtë fakt, bazuar në masat e hapat e ndërmarrë nga ana e Teatrit, lidhur me publikimin në faqen zyrtare të masës së reduktimit të biletave të shfaqjeve në raport me tarifatat bazë të biletave, bazuar në kategoritë sociale që e përfitojnë atë (*përfshirë dhe kategorinë ku bën pjesë ankuesja*) dhe konkretizimin e kësaj mase për PAK, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e subjektit ankues, lidhur me pretendimin e parë të saj, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim.

Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e Teatrit, pasi në sallën e shfaqjeve ku ajo ka ndjekur operan, nuk ka patur vende të dedikuara për të, si person me AK, me status tetraplegjiku, në përmbushje të specifikimeve të bëra në VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

Ky pretendim i ankueses rezulton të jetë i vërtetë, pasi një fakt i tillë është pranuar si i mirëqenë nga ana e TKOBAP, madje dhe ka shprehur vullnetin se: “Nëse në të ardhmen me vendimarrje

të përbashkët me Ministrinë e Kulturës mund të vendoset të heqim disa karrige për të mundësuar qëndrimin e personave me aftësi të kufizuara, mund të bëhet e mundur dhe akomodimi i tyre”.

Nisur nga fakti se godina e TKOBAP-së është rikonstruktuar së fundmi, dhe VKM-ja sipërcituar i ka shtrirë efektet ligjore që prej vitit 2008 e aktualisht, përcaktimet e saj lidhur me numrin e vendeve të dedikuara për PAK, në proporcion me numrin total të kapacitetit të vendeve ulur të Teatrit, duhet të ishin marrë në konsideratë paraprakisht nga ana e Institucionit.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues/PAK me status tetraplegjiku, rezultoi i njohur dhe i pranuar nga ana e Teatrit, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata kishin shprehur vullnetin për të përmbushur detyrimin ligjor përsa i takon rimbursimit të biletës së shfaqjes, si dhe për të ndihmuar në akomodimin e saj në ndjekjen e shfaqjes së datës 15.12.2021.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur dhe me dinjitet. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson vullnetin e shprehur nga ana e TKOBAP për të ndërmarrë hapa konkretë lidhur me mundësinë për sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendeve të dedikuara për PAK, proporcionalisht me numrin në total të vendeve të sallës së Teatrit, por, thekson se, mungesa e këtyre vendeve aktualisht, dhe deri në momentin e krijimit të tyre, konform parashikimeve ligjore sipërcituar, i vë ata në pozita të pabarabarta e të pafavorshme me të tjerët që nuk posedojnë shkakun e mbrojtur, duke cënuar dinjitetin e tyre, përmes sistemimit të tyre në vende të tjera, që nuk janë të dedikuara për ta, duke bërë që ata të ndjehen të diferencuar e të ekspozuar në vendet e përshtatura (siç është përshtatja e hapësirave në rreshtin me korridorin më të gjerë/ rreshti I, i protokollit G, cituar në përgjigjen e TKOBAP drejtuar Komisionerit).

Komisioneri arrin në përfundimin se salla e shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, nuk përmbush të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë TKOBAP, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, përfshirë edhe të drejtën për një jetë sociale e kulturore, Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara, me qëllim sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendeve të dedikuara për PAK, në kuadër të aksesueshmërisë dhe eliminimit të barriereve arkitektonike, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara (*përfshirë edhe subjektin ankues si individ i veçantë*) ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me pjesën tjetër të publikut.

Komisioneri konstaton se TKOBAP, me mosveprimin e tij, ka diskriminuar subjektin ankues, dhe të gjithë PAK, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për aksesim në vendet e dedikuara për PAK.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të shtetasve S.L., dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga ana e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e TKOBAP, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë për vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kritereve të përcaktuara në VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.
- Komisioneri i rekomandoi TKOBAP, në kuadër të marrjes së masave pozitive për PAK, të marrë masa konkrete për reduktim të çmimit të biletës, për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

44. Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Bashkisë Shijak

VENDIM NR. 115, DATË 20.06.2022

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat PAK.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjekti ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, për shkak të aftësisë së kufizuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara*”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “*Për statusin e invalidit*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “*Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike*”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Rezultoi e provuar se Zyra Postare Qendër Shijak nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Shijak. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Qendër Shijak, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë së Zyrës Postare Qendër Shijak, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a. dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Shijak. Në këto kushte, Komisioneri konstatoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara,

përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Shijak.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:
- Plotësimin e të gjitha standarteve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

45. Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Njesisë Administrative Sukth.

VENDIM NR. 124, DATË 20. 06. 2022

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim në formën e rëndë të tij
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njesisë Administrative Sukth, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat PAK.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjekti ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njësisë Administrative Sukth, për shkak të aftësisë së kufizuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUSIONE

Komisioneri, në praktikën e tij, ka konstatuar shkelje të ndalimit të diskriminimit të parashikuar nga LMD, në çështje të ngjashme, ku Posta Shqiptare sh.a., nuk kishte marrë masa për heqjen e pengesave/barrierave dhe për të përmbushur detyrimin për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, në një tjetër zyrë postare të saj¹⁶.

¹⁶ Shih: *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi Nr. 10, datë 21.01.2021, i Komisionerit; *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi Nr. 111, datë 10.06.2022, i Komisionerit; *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi Nr. 115, datë 13.06.2022, i Komisionerit.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Sukth, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerësoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Sukth. Në këto kushte, Komisioneri konstatoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Komisioneri konstatoi se:

Posta Shqiptare sh.a., ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a., ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin Nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit; Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin Nr. 111, datë 10.06.2022, të Komisionerit dhe Zyra Postare Qendër Shijak, konstatuar me vendimin Nr. 115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.

Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM Nr. 1503/2008, miratimin e VKM Nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit Nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit *në formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Sukth.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Sukth, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për*

përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

- ii. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
 - iii. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

46. E.L., kundër Shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako”, Divjakë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Divjakë (ZVAP Divjakë).

VENDIM NR. 101, DATË 26. 05. 2022

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

E.L., është diskriminuar nga ana e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Ankuesi është babai i një djali me aftësi të kufizuar të quajtur E.L., Mbështetur në informacionin e bërë publik në media, si dhe referuar Planit të Edukimit Individual (PEI) të vënë në dispozicion nga ana e Shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako”, nxënësi E.L., është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën doën dhe me Epilepsi të gjeneralizuar. Gjithashtu rezultoi se nxënësi E.L., ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Djali i ankuesit, nxënësi E.L., është regjistruar në klasën e 1 (parë) në vitin shkollor 2012- 2013, në shkollën e mesme të bashkuar “Mihal Nako”, Fierseman, Divjakë. Ai ka përfunduar klasën e 8 (tetë) gjatë vitit shkollor 2020-2021. Për vitin shkollor 2021-2022, drejtorja e shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, nuk e ka regjistruar në klasë të 9 (nëntë), nxënësin E.L., për shkak se ka mbushur moshën 18 vjeç pak muaj përpara fillimit të vitit shkollor 2021-2022.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Rregullorja “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MASR me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se, shkolla dhe ZVAP Divjakë nuk duhet të kishin refuzuar regjistrimin e nxënësit E.L., në klasën e 9 (nëntë), duke qenë se ai ka ndjekur arsimin bazë në këtë shkollë që nga klasa e 1 (parë) e deri në klasën e 8 (tetë). Fakti që shkolla dhe ZVAP Divjakë, nuk kanë patur në vëmendje interesin më të lartë të fëmijës dhe detyrimet që qeveria shqiptare është e angazhuar në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik, ka vendosur në kushte të diskriminuese nxënësin E.L., për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar të drejtën për arsim. Në këtë kuadër, veç faktit që nxënësit i është refuzuar e drejta për regjistrimin në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë, atij nuk i është ofruar asnjë alternativë tjetër, e parashikuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si p.sh. regjistrimi në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme. Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se refuzimi për të regjistruar nxënësin E.L., në klasën e 9 (nëntë) nga ana e shkollës dhe ZVAP Divjakë, nuk është një veprim i mbështetur në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri nëpërmjet emisionit investigativ STOP¹⁷, në TV Klan, u njoh me faktin që, pas denoncimit nga ana e familjarëve të nxënësit E.L., lidhur me mosregjistrimin e tij në klasën e 9

¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=0p-ueSnlfU>

(nëntë), ishte arritur që nëpërmjet ndërhyrjes së MAS-it, ai të rikthehej dhe të vijonte të ndiqte mësimin në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë.

Pavarësisht faktit të rikthimit në mësim të nxënësit E.L., Komisioneri konstatoi se Drejtoria e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë, nëpërmjet mosregjistrimit të tij në klasën e 9 (nëntë), i kanë mohuar të drejtën për të ndjekur arsimin bazë të detyrueshëm.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Drejtoria e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar subjektin ankues, nxënësin E.L., për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e tij për tu arsimuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të nxënësit E.L., në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fier-Seman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë.
- Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, ZVAP Divjakë dhe Shkolla e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë, të marrin masa që në të ardhmen të mbahet në vëmendje mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

47. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 197, DATË 27.10.2022

Shkaku: Aftësia e Kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Vendim me gjobë

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në rrugët dhe trotuarët kryesorë të Bashkisë Kamëz, për personat me aftësi të kufizuara, vendos këto persona në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

FAKTET

Nga informacioni i administruar rezulton se, “Bulevardi Nënë Tereza”, që përbën dhe objektin kryesor të ankesës, është e paaksesueshme, në mënyrë të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara.

Aksi rrugor i Bulevardit Nënë Tereza në Bashkinë Kamëz, veçanërisht ishulli për këmbësorë i këtij bulevardi ka bordurë, e cila përbën pengesë infrastrukturore dhe nuk lejon personat me aftësi të kufizuara në lëvizje të cilët janë përdorues të karriges me rrota, që të kalojnë nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Lartësia e bordurës dhe mungesa e fushës relievoe, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- *GjEDNJ Çështjet Molla kundër Greqisë, Fábíán kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar. Çështja Baka kundër Hungarisë* (DHM);
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligji Nr. 108/2012 “*Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Kamëz, kryesisht në gjatësinë e Bulevardit Nënë Tereza, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për

shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Kamëz, parashtroi se është duke marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin, projektimin dhe zbatueshmërinë lidhur me përshtatshmërinë e rrugëve me qëllim funksionimin e tyre nga të gjitha grup-moshat me karakteristika të veçanta. Bashkia Kamëz nuk paraqiti asnjë informacion dhe dokumentacion përpara Komisionerit lidhur me planifikimin e fondeve për përshtatjen/aksesueshmërinë e rrugëve/trotuareve kryesore për personat PAK dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor të Bulevardit Nënë Tereza, të Bashkisë Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Kamëz dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kamëz.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Kamëz nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Bashkisë Kamëz, i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kamëz, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor të Bulevardit Blu.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kamëz, të marrë masa të menjëhershme për:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor të Bulevardit Nënë Tereza, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008.
 - ii. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

48. Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a.,

VENDIM NR. 142, DATË 19.07.2022

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim në formën e rëndë të tij
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Vendim me gjobë

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njesisë Administrative Ishëm vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

FAKTET

Zyra Postare Ishëm, që përbën edhe objektin e ankesës, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a, Durrës. Nga pamjet fotografike të Zyrës Postare Ishëm, të vëna në dispozicion nga pala ankuese, rezulton që godina ku ofrohen shërbimet nga ana e kësaj zyre postare, ka në hyrje të saj disa shkallë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- *GjEDNJ Çështjet Molla kundër Greqisë, Fábían kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligjit Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eleminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Ishëm, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengësive për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Ishëm. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM Nr. 1503/2008, miratimin e VKM Nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengësive në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit Nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Posta Shqiptare sh.a., nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a., i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Komisioneri evidenton ndër të tjera edhe nevojën për kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese nga ana e Postës Shqiptare sh.a., për të gjitha strukturat e saj, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në nenin 9/2/c, i KDPAK, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me aksesueshmërinë, konsiderohet si një nga masat e duhura për eleminimin e pengësive/barrierave dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a., shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit *në formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj, pranë Zyrës Postare Ishëm.
- Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Ishëm, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
 - ii. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
 - iii. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

49. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë

VENDIM NR. 201, DATË 07.11.2022

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori” Prezë, Bashkia Vorë vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjektit ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në, për shkak të aftësisë së kufizuar, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori” Prezë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimtari për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Shkolla e Mesme e Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Bashkia Vorë ka investuar një vlerë të konsiderueshme duke rindërtuar Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në vitin 2018, në kundërshtim me standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, i cili ndalon çdo financim, nëse

objekti nuk përmbush kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë. Pretendimi i Bashkisë Vorë se nuk kanë patur nxënës me aftësi të kufizuara në shkollës dhe për këtë arsye nuk ka patur problematika në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë, është i pabazuar dhe vjen në kundërshtim me detyrimet e mësipërme ligjore.

Bashkia Vorë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë. Rezulton se, Bashkia Vorë nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë e objektit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në juridiksionin e saj për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Vorë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, Bashkia Vorë.
- Bashkia Vorë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshpejtuar aksesueshmërinë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Bashkia Vorë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

50. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë

VENDIM NR. 202, DATË 07.11.2022

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë së trotuareve në territorin e Bashkisë Vorë vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

FAKTET

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin Nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjektit ankues i është mohuar trajtimi i barabartë dhe është diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë së trotuareve në territorin e Bashkisë Vorë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Komisioneri konstatoi se, Bashkia Vorë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj. Gjithashtu, rezulton se rruga “Unaza” që përbën edhe objektin kryesor të ankesës, ndodhet përpara godinës së Bashkisë Vorë, çka

pamundëson aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me personat e tjerë. Rezulton se në aksin rrugor “Unaza”, janë të vendosura dhe ofrojnë shërbime të përditshme institucione publike dhe private që ofrojnë shërbime kryesore të nevojshme për banorët e këtij qyteti si: Bashkia, Posta Shqiptare, etj. Për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të sigurt në punë, arsim dhe jetën e përditshme, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses fizik në të njëjtat hapësira, punësim, mallra, shërbime dhe pjesëmarrje në komunitet, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në rrugën “Unaza”, të Bashkisë Vorë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Vorë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Vorë, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor, rruga “Unaza”.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Vorë, të marrë masa të menjëhershme për:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor, rruga “Unaza”, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
 - ii. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

51. Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës Postare Kamëz

VENDIM NR. 222, DATË 20.12.2022

Shkaku: Aftësia e Kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në proces

Zyra Postare Kamëz nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi duke diskriminuar personat me aftësi të kufizuar, pasi ndërtesa, ku ushtron funksionet e saj nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për këtë kategori.

FAKTET

Fillimisht, Fondacioni “Së Bashku” e bën me dije KMD-në se që prej muajit prill 2022, është duke zbatuar nismën “*Të rinjtë për gjithëpërfshirjen*”, në Bashkitë Kamëz, Vorë dhe Kavajë. Nga takimet e zhvilluara me personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë Kamëz, është konstatuar se godina pranë së cilës ushtron funksionet e saj Zyra e Postës Shqiptare Kamëz nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuar.

Njëkohësisht, ajo ka sjellë edhe foto të ambienteve të brendshme të godinës dhe thekson faktin se në to mungojnë standardet ligjore për garantimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në Vendimin e Nr. 1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*”. Subjekti ankues thekson faktin se në këtë godinë nuk ekzistojnë gjithashtu as standardet e aksesueshmërisë fizike për personat që kanë probleme me shikimin dhe me dëgjimin.

Subjekti ankues pretendon se Zyra Postare Kamëz nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi duke diskriminuar personat me aftësi të kufizuar, pasi ndërtesa, ku ushtron funksionet e saj nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për këtë kategori vulnerabël.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventën e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”
- Ligji Nr. 108/2012 “*Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*”¹⁸,

¹⁸ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDKPAK.

- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Rezulton e provuar se Zyra Postare Kamëz nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Kamëz. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Kamëz, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, mbështetur në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet, kur prezumohet se ka patur diskriminim *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardet e provës, Posta Shqiptare sh.a. kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nështruar personat me aftësi të kufizuara që marrin shërbimet në Zyrën Postare Kamëz, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Sipas KDPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv.

Realizimi progresiv kupton se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Komisioneri e vlerëson të pabazuar pretendimin e Postës Shqiptare, lidhur me pamundësinë për të ndërtuar rampë, qoftë edhe rampë të lëvizëshme, në hyrje të godinës së saj për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuara. Përpos kësaj, kjo shoqëri nuk ka përmendur në asnjë rast plotësimin e kriterëve të aksesueshmërisë fizike për personat e verbër dhe ata që nuk dëgjojnë. Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e kategorive të personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me

aftësi të kufizuar. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se, Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Rezultoi gjithashtu se Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”* dhe është rekomanduar në mënyrë specifike nga ana e Komisionerit me vendimin e tij Nr. 10, datë 21.01.2020.¹⁹

Komisioneri thekson se, në praktikën e tij, ka konstatuar shkelje të ndalimit të diskriminimit të parashikuar nga LMD, të ndryshuar, në çështje të ngjashme, ku Posta Shqiptare sh.a., nuk ka marrë masa për heqjen e pengesave/barrierave dhe për të përmbushur detyrimin për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, në një tjetër zyrë postare të saj²⁰.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Mbështetur në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a., dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Kamëz. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se:

Posta Shqiptare sh.a., ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a. ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin Nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit; Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin Nr. 111, datë 10.06.2022, të Komisionerit dhe Zyra Postare Qendër Shijak, konstatuar me vendimin Nr. 115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.

¹⁹ Nëpërmjet këtij vendimi, KMD ka rekomanduar Postën Shqiptare sh.a. që brenda 6 (gjashtë) muajve të hartonte një plan masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Sipas këtij rekomandimi, pjesë e planit të masave duhet të ishte planifikimiprogresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

²⁰ Shih: *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi nr.10, datë 21.01.2020, i KMD.

Sjellja diskriminuuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM Nr. 1503/2008, miratimin e VKM Nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit Nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria. Komisioneri evidenton ndër të tjera edhe nevojën për kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese nga ana e Postës Shqiptare sh.a., për të gjitha strukturat e saj, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në nenin 9/2/c, i KDPAK, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me aksesueshmërinë, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barrierave dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a., shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit në formën e rëndë të tij, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me mosgarantimin e standardeve të aksesueshmërisë fizike, në godinën ku ushtron funksionet e saj, Zyra Postare Kamëz.
- Në referim të pikës 1, të këtij Vendimi, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme:
 - i. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Kamëz, sipas parashikimeve në Vendimin Nr. 1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe në Vendimin Nr. 1074, datë 23.12.2015 e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
 - ii. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

X. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR

52. A.B., kundër E.H., Drejtore e Shkollës 9 vjeçare Dora D'Istria, Tiranë

VENDIM NR. 14 , DATË 13.01.2022

Shkaku: Çdo shkak tjetër/“ankesat kundër drejtueses së institucionit”

Forma: Viktimizim; Shqetësim

Fusha: Punësim

Statusi: Zbatuar

Ankuesja A.B., është diskriminuar duke u viktimizuar dhe shqetësuar në vendin e punës nëpërmjet proceseve disiplinore dhe marrjes së masës disiplinore jo proporcionale, si pasojë e paraqitjes së ankesës kundër drejtueses së institucionit.

FAKTET

Ankuesja është mësuese e lëndës Histori- Gjeografi, në Shkollën 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë, emëruar në këtë pozicion pune që prej vitit 2015. Në tre vitet e fundit ankuesja ka patur marrëdhënieve konfliktuale dhe klimë jo pozitive me kolegë të tjerë mësues të shkollës. Në lidhje me këtë situatë shqetësuese me kolegët e saj, ankuesja ka paraqitur shqetësimet e saj pranë drejtueses së shkollës, por nuk ka gjetur zgjidhje. Në datë 14.02.2020, ankuesja ka paraqitur një ankesë në ZVA Tiranë kundër E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria, e cila nuk kishte marrë masa në lidhje me shqetësimet që ajo p kalonte në vendin e punës.

Në datën 03.06.2020, ndaj ankueses A.B., është dhënë masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”. Kjo masë disiplinore ndaj ankueses është marrë duke u bazuar në dy vendime të Komisionit të Etikës së kësaj shkolle dhe konkretisht vendimin e datës 17.02.2020, lidhur me ankesën e mësueses I.M., ndaj ankueses dhe vendimin e datës 02.06.2020, lidhur me ankesën e paraqitur nga një nxënëse si dhe prindërit e saj ndaj ankueses. Mësuese I.M., pretendon se ankuesja ka shkelur etikën kur i është drejtuar duke thënë: “*Do ta shihni ju, do t’jua tregoj unë të gjithave*”. Nxënësjë dhe prindërit e saj pretendojnë se ankuesja nuk e ka vlerësuar drejtë nxënësen.

Ankuesja ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se, situata e diskriminimit ka precipituar, pas ankesës së bërë nga ana e saj në datë 14.02.2020, pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë (ZVAT) në drejtim të drejtoreshës së institucionit E.H. Në këtë ankesë ankuesja ngre pretendime se është duke u diskriminuar në vendin e punës.

Në datën 25.02.2020, ZVA Tiranë ka realizuar një monitorim/vëzhgim në shkollë në lidhje me ankesën e ankueses. Raporti i ZVA Tiranë nuk ka konstatuar ose konkluduar në ndonjë përgjegjësi të ankueses në gjithë këtë situatë konfliktuale, por për situatën e konstatuar ka lënë detyra për drejtuesit e institucionit arsimor. Ky rekomandim i vëzhguesve të ZVA Tiranë është administruar në shkollë në datën 02.06.2020 dhe i është komunikuar ankueses vetëm gjatë takimit të Komisionit

të Disiplinës datë 03.06.2020. Sipas ankueses, kjo ankesë ka sjellë për pasojë dhënien e masës disiplinore të padrejtë ndaj saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminim*”;
- Rregullore për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, miratuar me urdhrin Nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

KONKLUZIONE

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë gjithë procedurës disiplinore që është finalizuar me dhënien e masës disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”, me vendimin e datës 03.06.2020 të dhënë nga Komisioni i Disiplinës së Shkollës 9-vjeçare Dora d’Istria”. Komisioneri arrin në përfundimin se, masa disiplinore e marrë ndaj ankueses është produkt i një procesi të zhvilluar në kundërshtim me të drejtën e ankueses për t’u informuar në lidhje me ankesat ndaj saj, në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, në shkelje të të drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Gjatë të gjithë procedurës së ndjekur për marrjen e masës disiplinore, nuk rezulton që pretendimet dhe provat e depozituara nga ankuesja të jenë marrë në shqyrtim dhe të jetë dhënë një vlerësim nga ana e të dy komisioneve, si nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, ashtu edhe nga Komisioni i Disiplinës. Në mënyrë flagrante dhe të pabazuar ndaj ankueses është dhënë një masë disiplinore e rëndë sikurse është “*Paralajmërim për largim nga puna*”, në shkelje të parimit të proporcionalitetit, i cili kërkon dhënien e masës disiplinore në mënyrë të përshkallëzuar.

Ankuesja është ankuar në disa raste ndaj disa mësuesëve në ZVA Tiranë, në lidhje me problematikat e saj në vendin e punës. Për këto ankesa kanë marrë dëgjimin si drejtuesja e institucionit, ashtu edhe mësuesit respektiv për të cilët ankuesja është ankuar. Megjithatë, përpara datës 14.02.2020, ankuesja i ka drejtuar ankesat e saj ndaj mësuesëve të tjerë dhe jo ndaj drejtores së shkollës, ndryshe nga sa ka ndodhur me ankesën e datës 14.02.2020, e cila është paraqitur kundër saj.

E gjithë procedura disiplinore e zhvilluar ndaj ankueses është kryer në kushtet kur Komisioni i Etikës dhe Sjelljes është ngitur në kundërshtim me Rregulloren e Institucioneve Arsimore, ka patur anëtarë të cilët kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit me ankuesen, për shkak të ankesave

që ajo ka bërë ndaj tyre. Drejtuesi i institucionit arsimor nuk është anëtar i Komisionit të Etikës dhe Sjelljes dhe masat disiplinore ndaj mësuesve jepen nga Komisioni i Disiplinës (KD) dhe jo nga Drejtori i institucionit arsimor. Por, drejtuesi i institucionit arsimor, është ai që kryeson KD dhe drejton punën e tij. Drejtori i institucionit arsimor, ka përgjegjësinë për zbatimin në institucionet arsimore të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi dhe ka përgjegjësinë për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe të respektit ndërmjet punonjësve arsimorë në institucion. Moszbatimi i ligjit dhe procedurave të posaçme, të cilat janë përgjegjësi e drejtorit të institucionit arsimor, duke e vendosur ankuesen para një komisioni të njëanshëm dhe jo transparent, vendimi i të cilit parashikohej të ishte i njëanshëm dhe negativ ndaj saj, ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.

Komisioneri gjithashtu vlerësoi se, ky raport vëzhgimi nuk është interpretuar drejtë, duke u paraqitur si një akt i cili ngarkon me përgjegjësi ankuesen në lidhje me situatat konfliktuale të krijuara midis kolegëve.

Komisioneri gjykon se bazuar në të gjitha faktet dhe provat e administruara, krijohet prezumimi se masa disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”, jo vetëm që është e pabazuar dhe disproporcionale, por është pasojë negative që ka ardhur si rezultati paraqitjes së ankesës, kundër E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë. E.H., Drejtore e Shkollës 9- vjeçare Dora d'Istria, Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, kishte barrën e provës që të provonte se masa disiplinore ndaj ankueses nuk është bërë për shkak të ankimit të saj në ZVA Tiranë, ose që masa disiplinore është dhënë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses se masa disiplinore është dhënë për shkakun e pretenduar. Në mungesë të një justifikimi të tillë i vetmi shpjegim për dhënien e masës disiplinore ndaj ankueses, “*Paralajmërim për largim nga puna*”, mbetet fakti i paraqitjes së ankesës pranë ZVA Tiranë, kundër E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë. E.H, Drejtore e Shkollës 9- vjeçare Dora d'Istria, Tiranë, mban përgjegjësi individuale që me veprimet dhe mosveprimet e saj ka lejuar moszbatimin e ligjit dhe procedurave të posaçme, të cilat janë përgjegjësi e drejtorit të institucionit arsimor, duke e ekspozuar ankuesen A.B., ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.B., është diskriminuar nga ana e E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare “Dora d'Istria”, Tiranë, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes së ankesës, në ZVA Tiranë.

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjir dhe nënligjor në fuqi mbi bazën etë cilave normohet dhe rregullohet veprimtaria në një institucion arsimor publik, nga ana e E.H., në cilësinë e drejtores së shkollës, duke përdorur organet e këtij institucioni kanë krijuar një klimë dhe një mjedis armiqësor ndaj ankueses, duke e bërë atë objekt të procedurave disiplinore. Në vijimësi ankuesja është ndjerë e shqetësuar në vendin e saj të punës, por nuk rezulton që të jetë ndërmarrë ndonjë procedurë për verifikimin e tyre, qoftë edhe për të konkluduar se pretendimet e saj kanë qenë të pabaza. Në momentin që ankuesja ka kundërshtuar duke mospranuar sjelljet e padëshiruara në vendin e punës, ajo është vendosur në kushte të pafavorshme dhe përballë proceseve disiplinore, të zhvilluara në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi dhe duke

cënuar rëndë të drejtën e ankueses për një proces të rregullt ligjor. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja A.B., është diskriminuar në formën e shqetësimit.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses A.B., nga ana e E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.
- Konstatimi i diskriminimit në formën e shqetësimit, të ankueses A.B., nga ana e E.H., Drejtore e Shkollës 9-vjeçare Dora d'Istria, Tiranë.
- Në referim të konstatimeve të mësipërme, të merren masa për ndalimin e shqetësimit dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme, të cilat çënojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.
- Komisioneri rekomandon Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, që të trajtojë në mënyrë efektive ankesat që i paraqiten.

53. E.H., kundër Urdhrit të Psikologut (UP)

VENDIM NR. 191, DATË 11.10.2022

Shkaku: Çdo shkak tjetër/ Statusi si *“Psikologe pjesë e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë”*

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesja E.H., është diskriminuar për shkak të statusit të saj si “Psikologe pjesë e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë”, si pasojë e kategorizimit të masës së kuotizacionit për anëtarët e UP.

FAKTET

Ankuesja E.H., është me profesion psikologe dhe është anëtare e UP. Ankuesja është licencuar si “Psikologe Klinike” dhe është e pajisur me licensën përkatëse lëshuar në datën 20.02.2018 nga UP. Ankuesja është gjithashtu pjesë e ekspertëve psikologë, në Regjistrin Elektronik Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë.

Në bazë të vendimit nr. 2, datë 01.03.2017, Këshilli Kombëtar i UP, ka miratuar kuotizacionin vjetor për të gjitha anëtarët e UP në masën 6000 (gjashtë mijë) lekë. Ky kuotizacion nuk ka pësuar ndryshime deri në momentin kur, me vendimin Nr. 17, datë 29.12.2021, Këshilli Kombëtar i UP ka vendosur, që për vitin 2022, kuotizacioni për anëtarët të kategorizohet si më poshtë: Kategoria e psikologëve praktikantë në vlerën 4500 lekë/vit;Kategoria e psikologëve të licencuar 6000 lekë/vit; Kategoria e psikologëve pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë në vlerën 15000 lekë/vit.

Ky vendim i është komunikuar ankueses nëpërmjet postës elektronike në adresën e saj të *e-mail*, në datën 29.12.2021. Brenda të njëjtës ditë, ankuesja, me *e-mail*, ka kërkuar nga UP informacion në lidhje me procedurën dhe arsyet faktike dhe ligjore mbi bazën e të cilave ishte marrë një vendim i tillë, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje. Në datën 05.01.2022, ankuesja, po në rrugë elektronike (me *e-mail*), ka depozituar në adresën zyrtare të *e-mail* të UP një kërkesë tjetër për informacion, po për të njëjtat çështje. Ankuesja nuk ka marrë përgjigje nga UP, në lidhje me kërkesën e parashtruar.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi kundër UP, duke pretenduar se Vendimi Nr. 17, datë 29.12.2021, i Këshillit Kombëtar të UP është diskriminues, pasi diferencon në mënyrë të pafavorshme ankuesen, si pjesë e grupit “*Ekspertë Psikologë në Regjistrimin Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë*”, në raport me dy grupet e tjera të psikologëve të licencuar, përkatësisht, anëtarët psikologë me statusin e praktikantit dhe të gjithë anëtarët e tjerë të urdhrin, që janë psikologë të licencuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, Nr. 20, datë 11.07.2006, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.40/2016 “*Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009, “*Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar ;
- Statuti i Urdhrin të Psikologut;
- Rregullorja për Regjistrimin, Anëtarësimin dhe Liçencimin në Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë
- Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr. 10 619, datë 19.10.2018 “*Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrimit Elektronik për Ekspertët*”, të ndryshuar.

KONKLUSIONE

Pavarësisht rregullave dhe procedurave të ndryshme të regjistrimit dhe ushtrimit të profesionit për kategorinë e praktikantëve dhe kategorinë e psikologëve të licencuar, nuk ka diferencime në lidhje me masën e kuotizacionit që duhet të paguajnë anëtarët e UP, ndërsa nuk ka asnjë diferencim midis psikologëve të licencuar dhe psikologëve pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë. Diferencat e vetme që vendoset nga Statuti i UP, janë midis anëtarit ushtrues dhe anëtarit joushtrues të UP, por këto ndryshime dhe pse nuk kanë të bëjnë me kategoritë në fjalë, nuk vendosin diferenca në lidhje me kuotizacionin, edhe për këto dy kategori, anëtarë ushtrues dhe joushtrues.

Ekspertët psikologë në Regjistrimin Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, janë psikologë të licencuar, me ndryshimin e vetëm që janë bërë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është një regjistër i krijuar dhe i administruar totalisht nga Ministria e Drejtësisë. Përfshirja e psikologëve të licencuar në këtë regjistër është një nismë personale e psikologëve të licencuar që plotësojnë kriteret ligjore për të qënë pjesë e këtij regjistri. Komisioneri vlerëson se, në raport me UP, kategoria e psikologëve të licencuar ndodhet në kushte të njëjta me kategorinë e ekspertëve psikologë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë. Pavarësisht ndryshimeve të mësipërme midis psikologëve praktikantë dhe psikologët pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë (ndryshime këto që janë njësoj edhe me kategorinë e psikologëve të licencuar), në raport me UP, këto dy kategori ndodhen në kushte të ngjashme.

Masa e kuotizacionit vjetor në vlerën 15000 lekë, e përcaktuar për kategorinë e ekspertëve psikologë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, ku bën pjesë ankuesja, e vendos këtë të fundit në kushte më pak të favorshme në raport me dy kategoritë e tjera të psikologëve, psikologëve praktikantë, masa e kuotizacionit vjetor për të cilët është në masën 4500 lekë, dhe kategorinë e psikologëve të licencuar, për të cilët masa e kuotizacionit vjetor është në masën 6000 lekë. Rezulton qartë se, masa e kuotizacionit për kategorinë e psikologëve pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, ku përfshihet ankuesja jo vetëm që është e diferencuar nga dy kategoritë e sipërcituara, por ka pësuar një rritje të konsiderueshme, rritje e cila është në masën 150 %, në raport me masën e mëparshme të kuotizacionit që ka qënë e njëjtë për të gjithë anëtarët e UP, në vlerën 6000 lekë në vit.

Komisioneri vlerëson se një qëllimi për të mbështetur psikologët e rinj të cilët, pas përfundimit të studimeve universitare janë duke përmbushur detyrimin ligjor për kryerjen e praktikës profesionale, që do t'i mundësojë më pas kësaj kategori që të integrohen në tregun e punës dhe të ushtrorjnë profesionin e psikologut, përbën një qëllim të ligjshëm. Komisioneri vlerëson si të ligjshëm edhe qëllimin tjetër të synuar nëpërmjet vendimarrjes së Këshillit Kombëtar të UP me vendimin Nr. 17, të datës 29.12.2021, që është ruajtja e stabilitetit financiar të UP nëpërmjet përcaktimit të kuotizacionit që të lejojë funksionimin normal të UP.

Komisioneri vlerëson se, synimi për vendosjen një barazie sociale për shpërndarjen e ngarkesës buxhetore midis anëtarëve, bazuar në mundësinë për të realizuar të ardhura nga ushtrimi i profesionit, nuk mund të konsiderohet një qëllim i ligjshëm në raport me qëllimin e ligjit që

rregullon profesionin e psikologut dhe misionin që ligji ka përcaktuar për UP. Komisioneri vlerëson se, një qëllim i tillë vjen në kundërshtim me qëllimin e Ligjit Nr. 40/2016 dhe misionin e përcaktuar nga ky ligj për UP Krahasimi, që ky i fundit bën me sistemin fiskal është i pabazuar, pasi legjislacioni që rregullon sistemin tatimor ka qëllime të ndryshme nga qëllimi i ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e profesionit të psikologut dhe misionin e UP.

Në këto kushte, Komisioneri do të vlerësojë nëse, ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimeve të vlerësuara si të ligjshme.

Këshilli Kombëtar ka diskrecion për të përcaktuar masën e kuotizacionit, duke respektuar kriteret e vendosura nga neni 42 i Statutit të UP, pra gjëndjen, kërkesat dhe nevojat për të siguruar funksionimin normal të UP Por nga ana tjetër, diskrecioni ushtrohet ligjërisht, kur është në përputhje me kriteret e vendosura nga neni 11, i K.Pr.Administrative. Pra, ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit kërkon respektimin e parimeve të përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative, sikurse është parimi i proporcionalitetit.

Kategoria e psikologëve praktikantë e mbajnë këtë status për një periudhë të kufizuar gjatë kohës së kryerjes së praktikës profesionale e cila është 1 vit deri në licencimin e tyre nga ana e UP. Në këtë mënyrë, ulja e masës së kuotizacionit nga 6000 në 4500 lekë, për kategorinë e psikologëve praktikantë përfitohet gjatë një periudhe të reduktuar kohe dhe pas licencimit ata do të paguajnë vlerën prej 6000 lekë në vit që parashikohet për psikologët e licencuar. Kategoria e psikologëve praktikantë e kanë të detyruar që të jenë anëtarë të UP në mënyrë që të kryejnë praktikën profesionale, në mënyrë që më pas t'i nënshtrohen provimit të shtetit e të vijojnë më tej me licencimin e tyre nga UP për të ushtruar të pavarur profesionin e psikologut. Nga ana tjetër gjatë periudhës së pritjes për fillimin e praktikës profesionale, gjatë kryerjes së saj e në vijim në pritje të pajisjes me licencën përkatëse, kategoria e psikologëve praktikantë objektivisht nuk kanë mundësi të krijojnë të ardhura nga ushtrimi i profesionit si psikologë, pasi nuk mund ta ushtrojnë këtë profesion ligjërisht në mungesë të pajisjes me licencë.Referuar të dhenave të vendosura në dispozicion nga ana e UP, rezulton se ulja e kuotizacionit për kategorinë e psikologëve praktikantë është në masën 25 % në raport me kuotizacionin e mëparshëm dhe se nga kjo ulje përfitojnë një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të UP rreth 600 të tillë në raport me 1300 anëtarë në total që ka UP Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, Komisioneri vlerëson se ulja e kuotizacionit për kategorinë e psikologëve praktikantë është një masë e cila është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi është e nevojshme, e përshtatshme dhe në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. Komisioneri arrin në përfundimin se, trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankueses në raport me kategorinë e psikologëve praktikantë, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm e rrjedhimisht nuk përbën diskriminim.

UP, bazon pretendimin e tij në faktin se, ekspertët psikologë pjesë e Regjistrisë Elektronike për Ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë kanë më shumë mundësi për të gjeneruar të ardhura pasi si pjesë e këtij regjistri ata kanë mundësinë ekskluzive për t'u thirrur si ekspertë nga organet e drejtësisë e të përfitojnë pagesat përkatëse për aktet hartuara në kuadër të proceseve gjyqësore ku ata thirren si ekspertë.

Thirrja si ekspertë nga organet e drejtësisë, përfshi këtu edhe eksperët psikologë, sikurse është ankuesja, nuk është e rregulluar dhe nuk ka një rregull ose periodicitet në thirrjen e ekspertëve pjesë e Regjistrisë Elektronike për Ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë. Sikurse edhe UP e pranon, se, nuk disponon të dhëna mbi periodicitetin e thirrjes së psikologëve, të cilët janë pjesë e Regjistrisë Elektronike për Ekspertë në Ministrinë e Drejtësisë, nga ana e organeve të drejtësisë dhe se, praktikisht kjo është e pamundur, pasi nuk ka ndonjë database zyrtar apo mënyrë përfitimi të të dhënave në lidhje me shpeshësinë apo sasinë e çështjeve në të cilat është thirrur çdo psikolog në cilësinë e ekspertit dhe se, nuk ka një mesatare orientuese për numrin e çështjeve në të cilat një psikolog thirret në cilësinë e ekspertit nga Gjykata. Në këto kushte përlllogaritjet e bëra nga ana e UP në lidhje me numrin minimal të çështjeve që një ekspert psikologë mund të thirret nga organet e drejtësisë, nuk mund të jenë të bazuara, por hamendësime. Në lidhje me përlllogaritjet e tjera të bëra nga UP në lidhje me shpenzimet që i duhen një psikologu që thirret si ekspertë nga gjykata, pavarësisht se nuk janë të shoqëruar me dokumentacion provues, analiza financiare e UP, tregon se, shpenzimet për të ushtruar profesionin si ekspert psikologë pranë organeve të drejtësisë janë të konsiderueshme dhe në rast se ata nuk marrin çështje nga ana e gjykatës, ata vendosen në kushte të vështira për të ushtruar këtë profesion dhe kuotizacioni i ri në masën 15000 lekë përbën një barrë të shtuar të konsiderueshme. Komisioneri, vlerëson se, të dy kategoritë, psikologët e licencuar dhe psikologët pjesë e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, janë praktikisht në pozita të barabarta në tregun e punës dhe konkurrueshmërisë.

Psikologët pjesë e Regjistrisë Elektronike për Ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit si ekspertë, paguajnë detyrimet e tyre në bazë të të ardhurave të gjeneruara pranë organeve tatimore dhe nuk mund të ngarkohen financiarisht mbi bazën e nivelit të të ardhurave edhe në raport me UP, i cili nuk ka në misionin e tij që të mbedhë të ardhura në baza të të ardhurave të anëtarëve të tij.

Komisioneri konstaton se, rritja e kuotizacionit nga 6000 në 15000 lekë për psikologët që janë pjesë e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, përbën një rritje jo proporcionale dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Mjeti i përdorur nga UP, pra masa e kuotizacionit në vlerën 15000 lekë, nuk është i nevojshëm dhe i përshtatshëm. Duke shpërndarë barrën financiare tek të gjithë psikologët e licencuar, pa diferencuar kategorinë e psikologëve pjesë e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, qëllimi i synuar, pra ruajtja e stabilitetit financiar, mund të sigurohej duke cënuar më pak të drejtat dhe interesat e kësaj kategorie dhe rritja e kuotizacionit për të gjithë psikologët e licencuar do të ishte një rritje më e pranueshme dhe që do të cënonte më pak anëtarët e UP.

Komisioneri konstaton se nga ana e UP nuk është bërë asnjë analizë paraprake për të bazuar dhe përligjur vendimarrjen në lidhje me kategorizimin e kuotizacionit vjetor të anëtarësisë së UP

Komisioneri konstaton se ankuesja E.H., është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, duke u vendosur në kushte më pak të favorshme për shkak se është pjesë e kategorisë “Psikologe pjesë e Regjistrisë Elektronike për Ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë” në raport me kategorinë e “psikologëve të licencuar” dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, si dhe është jo proporcional.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të ankueses E.H., në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të statusit si “*Psikologe pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë*”, lidhur me masën e kuotizimit të miratuar me vendimin Nr. 17, datë 29.12.2021, të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.
- Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Urdhri i Psikologut, duhet të marrë masa të menjëhershme për rishikimin e vendimin Nr. 17, datë 29.12.2021, të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, duke eliminuar trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të kategorisë “*Psikologë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë*”.

54. K.F., kundër Ministrisë së Mbrojtjes (MM)

VENDIM NR. 104, DATË 07.06.2022

Shkaku: Çdo shkak tjetër/ “Statusi si civil, jashtë radhëve të Forcave të Armatosura.”
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi K.F., është diskriminuar në të drejtën për punësim, për shkak të statusit si civil, jashtë radhëve të Forcave të Armatosura.
--

FAKTET

Rezulton se bazuar në urdhrin Nr. 859, datë 23.07.2020 “*Për miratimin e personelit civil që do të ndjekë specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, në vitin akademik 2019-2020*”, të Ministrit të Mbrojtjes, ankuesja K.F., është miratuar për të ndjekur specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë në UMT, në specialitetin “kirurgji plastike”.

Ankuesja ka nënshkruar me Komandantin e Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, kontratën me Nr. 1855/8 Prot., datë 24.7.2020 “*Për ndjekjen e programit të ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes*”. Në pikën 3, të nenit 4, të kontratës përcaktohet: “*Ministria e Mbrojtjes nuk garanton asnjë lloj trajtimi*

financiar për studentët jashtë radhëve të FA-së, të cilët do të ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes”

Pas 1 (një) viti në këtë marrëdhënie kontraktore, ankuesja konstaton si të padrejtë faktin që MM nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studentët specializantë jashtë radhëve të FA, të mbështetur me kuota nga kjo ministri, sikurse është ajo vetë. Sa më sipër, ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar nga ana e MM.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”,
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Rregullore e Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, e cila është miratuar me vendimin Nr. 88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik, të UMT, me ndryshimet përkatëse.

KONKLUZIONE

Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, ankuesja K.F., i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke mos përfitur asnjë trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, për shkak se nuk vjen nga radhët e Forcave të Armatosura, në raport me specializantët të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, për të cilët Ministria e Mbrojtjes garanton trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë.

Ekzistenca e një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri konstaton se, brenda kategorisë së specializantëve që vijnë nga radhët e FA, konstatohen dy nënkategori. Konkretisht specializantët që kanë statusin e ushtarakut dhe specializantët që janë personel civil.

Rezulton se, trajtimi financiar që përfitojnë specializantët që kanë statusin e ushtarakut gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, është një e drejtë që buron nga ligji Nr. 9210, datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Trajtimi financiar që ata përfitojnë gjatë ndjekjes së specializimit

afatgjatë në fushën e mjekësisë, është ngushtësisht i lidhur me statusin që ata gëzojnë si ushtarak. Në bazë të nenit 3, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, shërbimi ushtarak është veprimtari e veçantë, shoqërisht e domosdoshme për shtetin. Masa e trajtimit financiar që përfitojnë specialistët që janë personel ushtarak pjesë e FA, përlllogaritet në raport me pagën mujore që ata përfitojnë për shkak të statusit si ushtarakë, pa humbur gjatë kësaj periudhe asnjë kompesim që buron nga ky status.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, diferenca në trajtim midis ankueses, e cila nuk është pjesë e FA dhe specialistëve të cilët janë pjesë e FA si personel ushtarak, justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme, për shkak të statusit të veçantë të ushtarakut të akorduar me ligj dhe natyrës së veçantë të shërbimit ushtarak.

Ndërkohë, trajtimi financiar që përfiton kategoria tjetër e specialistëve që vijnë nga radhët e FA, por janë personel civil (nuk gëzojnë statusin e ushtarakut), përfitohet në bazë të VKM-së Nr. 555/2011. Kjo kategori nuk është përfituese e trajtimit financiar si pasojë e një të drejte të akorduar me ligj. Të drejtat dhe detyrimet e specialistëve të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë janë të njëjta dhe ndjekja e studimeve është me kohë të plotë dhe me shkëputje nga puna. Të dy kategoritë, si specialistët që vijnë nga radhët e personelit civil të FA ashtu edhe specialistët civilë jashtë radhëve të FA, janë përfitues të kuotave për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga kuotat e mbuluara nga MM.

Referuar kontratës së nënshkruar midis ankueses dhe MM, ndër të tjera, rezulton se, marrëdhënia midis ankueses, e cila nuk është pjesë e FA, rregullohet në bazë të të njëjtit akt, VKM-së nr.555/2011, mbi bazën e të cilit trajtohen edhe specialistët që janë personel civil, pjesë e FA. MM, nuk ofroi asnjë shpjegim se përse nuk ka zbatuar parashikimin e VKM Nr. 555/2011, lidhur me trajtimin financiar për ankuesen, si pjesë e kategorisë së specialistëve civilë jashtë radhëve të FA dhe nuk ngriti pretendime në lidhje me moszbatimin e aktit të sipërshtuar për rastin e ankueses.

Komisioneri konstaton se, nuk ka një kuadër rregullator në lidhje me trajtimin financiar të specialistëve gjatë ndjekjes së studimeve afatgjatë në fushën e mjekësisë. Rregullorja e Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, në UMT, bazohet në dispozitat e Kodit të Punës, por nuk parashikon asnjë rregullim uniform në lidhje me trajtimin financiar të specialistëve, ndërsa vendos detyrimin për specialistët që të angazhohen me kohë të plotë për 40 orë në javë, pranë strukturave ku janë përcaktuar që të ndjekin programin specializues dhe detyrimin e kryerjes e të paktën 24 rojeve klinike në vit. Për specialistët që përfitojë nga kuotat e mbuluara nga ministritë përkatëse, rregulloja parashikon se detyrimet financiare midis specialistëve dhe ministrive parashikohen në kontratat përkatëse që lidhen midis specialistit dhe ministrisë dhe që miratohen me urdhër të ministrit përkatës. Ndërsa për specialistët të cilët ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, të cilët kanë të njëjta të drejta dhe detyrime në kuadër të procesit, nuk ka asnjë parashikim në lidhje me trajtimin e tyre financiar.

Bazuar në informacionin e administruar rezulton se, nuk ka uniformitet lidhur me trajtimin financiar të specialistëve të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë me kuota të mbuluara nga ministritë përkatëse. Rezultoi se, vetëm MSHMS, ofron trajtim financiar për të

gjithë specialistët e mbështetur me kuotata e saj dhe me të cilët ajo ka lidhur kontratat përkatëse. Trajtimi financiar bazohet në pikën 11, të VKM Nr. 555/2011 dhe kryhet nga ana e QSUNT, ku specialistët ndjekin programin e specializimit. Ministrinë e tjera të cilave iu janë akorduar kuota bazuar në vendimin e Senatit Akademik të UMT, MD, MB dhe MD, nuk ofrojnë asnjë asnjë trajtim financiar për specialistët, të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë me kuota të mbuluara nga këto ministri.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se nuk ka një kuadër të përcaktuar ligjor ose nënligjor për trajtimin financiar të specialistëve gjatë kohës që ata ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, në momentin që MM ofron trajtim financiar për studentët të cilët ndjekin specializimet me kuota të mbuluara nga MM, kjo e fundit ka detyrime negative për të mos cënuar të drejtën e personave për mbrojtje nga diskriminimi dhe që sjellja e saj të mos jetë diskriminuese. Në këto kushte, Ministria e Mbrojtjes, nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të ankueses K.F., specializante nga radhët e civilëve jashtë Forcave të Armatosura, në raport me specialistët civilë të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, lidhur me trajtimin financiar gjatë ndjekjes së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, me kuota nga Ministria Mbrojtjes.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Ministria e Mbrojtjes ka trajtuar në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme ankuesen K.F., specializante, e cila vjen nga nga radhët e civilëve që nuk janë pjesë e FA në raport me specialistët të cilët vijnë nga radhët e civilëve pjesë e FA dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Komisioneri konstaton se, Ministria e Mbrojtjes, ka diskriminuar ankuesen K.F, për shkak se nuk vjen nga radhët e FA, duke shkelur parashikimet ligjore të nenit 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1 dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të ankueses K.F., nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të statusit si civil, jashtë radhëve të Forcave të Armatosura.
- Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, Ministria e Mbrojtjes duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - i. Të rivendosë në vend të drejtën e cënuar, duke siguruar trajtim financiar për ankuesen K.F., gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë në specialitetin “kirurgji plastike”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me kuota nga Ministria e Mbrojtjes.
 - ii. Të rishikojë modelin 3, të kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes”, të miratuar me urdhrin Nr. 856, datë 23.07.2020 “Për miratimin e kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i Forcave të Armatosura dhe civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura”, të

Ministrit të Mbrojtjes, me qëllim eliminimin e diferencës në trajtim lidhur me trajtimin financiar të specialistëve civilë jashtë radhëve të FA, të cilët ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë me kuota nga Ministria e Mbrojtjes.

- iii. Të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla diskriminuese.
- Konstatimi i mosdiskriminimit të ankueses K.F., nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të gjendjes ekonomike.

55. L.D., kundër Drejtorit të Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina”, Lushnje

VENDIM NR. 204, DATË 09.11.2022

Shkaku: Çdo shkak tjetër/ankimimi kundër punëdhënësit dhe mosbindje për të përmbushur urdhra të paligjshëm të tij.

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues ka mbajtur detyrën e Përgjegjëses së Financës në Shkollën Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina” Lushnje. Ajo është diskriminuar nga punëdhënësi në marrëdhënien e punësimit, duke e larguar nga puna puna, për shkak të ankimimit të saj për paligjshmëritë e Drejtorit të Shkollës.

FAKTET

Subjekti ankues, ka qenë e punësuar pranë Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina” Lushnje dhe se ka mbajtur detyrën e Përgjegjëses së Financës në këtë Shkollë, nga muaji prill 2019, deri më datë 09.02.2022, kur është liruar nga detyra me motivacionin e shkeljes së rëndë të etikës dhe disiplinës në punë.

Momenti i lirimit nga detyra, nga ana e ish-punëdhënësit, ka ardhur si formë e hakmarrjes ndaj saj, për shkak të ankesave që ka bërë kundër Drejtorit të Shkollës/punëdhënësit të saj, për shkak të denoncimeve të paligjshmërive dhe veprimeve antiligjore të tij. *(Për të cilat ankuesja ka cituar dhe denoncimin e saj kundër Drejtorit në organin epror AKPA).*

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002);
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH*”;
- Ligji Nr. 15/2017 “*Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë*” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Udhëzimi Nr. 14, datë 27.05.2021 “*Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit*”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- Urdhri i Brendshëm Nr. 88, datë 13.04.2021 “*Për miratimin e Kodit të Etikës në AKPA*”, si dhe “*Rregulloren e Brendshme të Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina” Lushnjë 2021-2022*”.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se për sa i takon përkeqësimit të pasojave negative në marrëdhëniet e punësimit të ankueses nga ana e punëdhënësit, Shkollës, rezultoi e provuar se në rend kronologjik ato kanë ardhur pas ankesës së saj me pretendim për shkeljet dhe paligjshmëritë e punëdhënësit, në ushtrim të detyrës nga ana e tij.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Shkollës nuk u arrit të provohej, se ankuesja është trajtuar në mënyrë të drejtë, nga ana e Drejtorit të Shkollës, për sa i takon masave disiplinore, si dhe procedurës së ndjekur për lirimin e saj nga detyra. Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se dhënia e masave disiplinore, si dhe lirimi i saj nga detyra, kanë ardhur pikërisht për shkakun e pretenduar, atë të konfliktit me Drejtorin e Shkollës dhe ankesave të paraqitura në AKPA, kundrejt tij.

Drejtori i Shkollës, ka parashtruar si argumenta para Komisionerit se, arsyeja për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ankuesen ishte për shkak të *shkeljes të rëndë të etikës dhe disiplinës në punë*, prej saj. Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga punëdhënësi për zgjidhjen

e marrëdhënieve të punës me ankuesen, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtat e saj ligjore, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, punëdhënësi nuk ka provuar se: Ankuesja kishte shkelur konkretisht, ndonjë akt ligjor apo nënligjor specifik me etikën apo disiplinën në punë.

Drejtori i Shkollës, në shkelje të pikës 2, të nenit 53, të Udhëzimit Nr. 14, datë 27.05.2021 *“Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”*; ka organizuar procesin për miratimin e ngritjes së KES, të vitit shkollor 2021-2022.

Motivacioni dhe shkeljet e pretenduara nga Drejtori, të cilat kanë shërbyer si shkak për lirim e ankueses nga detyra, janë elementë të parashikuar në Kodin e Etikës dhe Sjelljes (sipërcituar) dhe si të tilla, kompetencën për shqyrtimin e vlerësimin e tyre e ka Komisioni i Etikës e Sjelljes (KES). Drejtori, ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës dhe në shkelje e tejkalim të kompetencave të tij, duke i atribuar vetes kompetencat e Komisionit të Etikës e Komisionit të Disiplinës (KD).

Komisioneri gjykon se, pa marrë në konsideratë faktin nëse pretendimet e punëdhënësit kundrejt ankueses qëndrojnë apo jo, shkelja e procedurës dhe tejkalimi i kompetencës për dhënie e masës ndaj saj, ka cënuar rëndë të drejtat e saj si punëmarrëse për një proces të rregullt, të drejtë e ligjor. Punëdhënësi nuk ka depozituar asnjë provë që të vërtetojë se ndaj ankueses është zbatuar procedura ligjore lidhur me njoftimin e masave disiplinore, të drejtën për t’u njohur me pretendimet e provat e depozituara kundër saj, për t’u dëgjuar, mbrojtur e paraqitur prapësimet e provat në mbrojtje të vetes. Madje gjatë seancës dëgjimore Drejtori i Shkollës ka pranuar se nuk ka ndjekur një procedurë të tillë pasi nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti, por i ka komunikuar ankueses masat përkatëse.

Komisioneri konstaton se, nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e punëdhënësit i kanë ardhur pas dhe për shkak të konfliktit që është krijuar mes tyre për shkak të kundërshtimit të zbatimit të disa praktikave e urdhrave të dhëna prej tij, gjë për të cilën ajo është ankuar edhe pranë AKPA-së.

Në konkluzion, Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit (masat disiplinore dhe lirimi i saj nga detyra) haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga ky konflikt mes tyre dhe si shkak i ankesës së saj kundër Drejtorit pranë AKPA-së, duke e vënë në pozita diskriminuese atë, pikërisht për këtë shkak.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit subjektit ankues, L.D., në të drejtën për punësim, për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Drejtorit të Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina” Lushnje.

- Në referim të pikës 1, Drejtori i Shkollës Mekanike Bujqësore “Hasan D. Gina” Lushnje, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

XI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMËN E SHUMËFISHTË DHE NDËRSEKTORIALE

56. P.B., kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 35, DATË 08.02.2022

Shkaku: Raca dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i shumëfishtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Shërbimet Sociale/Bashkia Tiranë, para 4 vitesh, i kanë marrë fëmijët dhe i kanë dërguar në shtëpitë e fëmijës në qytetet Vlorë dhe Sarandë, për shkak se e kanë gjetur duke lypur në situatë rruge. Ankuesja është diskriminuar nga ana e Bashkisë Tiranë lidhur me mosmarrjen e masave për fuqizimin ekonomik e social të familjes së saj, në mënyrë që të rimarrë sërish fëmijët në banesë, për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike.

FAKTET

Subjekti ankues, është prind i tre fëmijëve: dy vajzave, përkatësisht të moshave 7 dhe 12 vjeç, të cilat jetojnë në “Shtëpinë e Fëmijës” Sarandë, dhe një djali, i moshës 5 vjeç, i cili jeton në “Shtëpinë e Fëmijës”, Vlorë.

Ankuesja shprehet se për shkak të situatës së vështirë ekonomike, ishte e detyruar të dilte të lypse në rrugë, bashkë me fëmijët, pasi bashkëshorti ishte i dënuar me burgim dhe nuk kishte mundësi tjetër për të siguruar të ardhura për familjen.

Para 4 vitesh, Shërbimet Sociale/Bashkia Tiranë, i kanë marrë fëmijët dhe i kanë dërguar në shtëpitë e fëmijës në qytetet Vlorë dhe Sarandë, për shkak se e kanë gjetur duke lypur në rrugë bashkë me ta.

Në momentin që bashkëshorti ka dalë nga burgu, kanë punuar të dy në punë të ndryshme informale: shitje rrobash të përdorura, mbledhje hekurishtesh, etj, në mënyrë që të mund të krijonin të ardhura dhe të siguronin një banesë me qira, që të merrnin fëmijët sërish në shtëpi.

Ankuesja shprehet se kanë hasur vështirësi të mëdha, përsa i takon faktit të gjetjes së një banese të përshtatshme me qira, dhe një pune të rregullt, pasi duke qenë pjesëtarë të minoritetit rom paragjykohe dhe nuk arrijnë të gjejnë një punë të qëndrueshme dhe se pronarët e banesave nuk iu bëjnë kontrata qiraje të noterizuara, siç kërkohen nga Shërbimet Sociale/Bashkia Tiranë.

Nga ana e Shërbimeve Sociale/Bashkia Tiranë, ankuseses nuk i është ofruar asnjë ndihmë lidhur me pagesën e qirasë së shtëpisë apo ndonjë bonus tjetër, dhe as lidhur me punësimin, në mënyrë që të rimerrte fëmijët e saj në banesë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Direktiva për Barazinë Raciale, miratuar në vitin 2000;
- Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore, “Koment i përgjithshëm Nr. 4: e drejta për strehim të mjaftueshëm”, Dokumenti i Kombeve të Bashkuara E/1992/23;
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji Nr. 126/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- VKM Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, për hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;
- Raporti i ECRI-i për Shqipërinë, datë 7 prill 2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit “Për Barazi, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025”;
- “Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022”.

KONKLUSIONE

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar, për fuqizimin e familjes.

Fakti i posedimit së shkaqeve të mbrojtura nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këto shkaqe, (racë dhe gjendje ekonomike) ata kanë patur në monitorim dhe trajtim rastin e saj.

Lidhur me problematikën e subjektit ankues dhe familjes së saj, Komisioneri vlerëson se:

Pavarësisht se nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë (*njësitë e mbrojtjes së fëmijëve*) vihet re se ka patur përpjekje të vazhdueshme për të asistuar dhe ndihmuar familjen Bajramaj (*analizuar më sipër në vendim*), Komisioneri gjykon se, ndihmat e dhëna kundrejt familjes në formën e paketave ushqimore, higjeno-sanitare apo dhe mjekësore, janë një ndihmë e përkohshme, por nuk zgjidhin situatën në vazhdimësi dhe nuk garantojnë siguri financiare dhe sociale tek familja.

Në këtë këndvështrim, Bashkia, duhet të kishte ndërhyrë me masa konkrete, sikurse përcaktohet nga i gjithë kuadri ligjor në fuqi, për sa i takon ofrimin të mundësisë konkrete për punësim dhe strehim të familjes. Vetëm përmes punësimit dhe sigurimit të një banese të përshtatshme, ankuesja dhe familja e saj mund të krijonin një lloj sigurie e pavarësie, qoftë financiare, qoftë sociale, në mënyrë që të mund të përballonin me punën e tyre dhe më dinjitet jetesën e përditshme, duke

krijuar kështu edhe premisat reale për rimarrjen e fëmijëve nga institucionet ku qëndrojnë aktualisht.

Njëherësh ky do të ishte hapi të parë që ankuesja të mund të iniciojë procedurat para gjykatës për rimarrjen e fëmijëve, pasi nga Bashkia është dhënë si shpjegim se pikërisht mosplotësimi i kushteve të përshtatshme për jetesë nga familja Bajramaj, përbën dhe pengesën kryesore që ata të iniciojnë para gjykatës procesin për rikthimin e fëmijëve pranë familjes biologjike.

Në vijim mbetet në vlerësim të gjykatës përmbushja apo jo e kushteve për rikthimin e fëmijëve pranë ankueses dhe famijes së tyre biologjike, por hapi i parë procedural lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me sigurimin e strehimit dhe punësimit të ankueses, në mënyrë që ajo të ketë mundësi reale për iniciimin e kësja procedure.

Komisioneri vlerëson se, përkundrazi, nga ana e Bashkisë jo vetëm nuk është punuar në mënyrë efektive për fuqizimin e familjes (*as për punësimin e tyre dhe as për krijimin e mundësisë për të përfituar nga programet e strehimit social*), por janë nxjerrë pengesa të panevojshme, duke i kërkuar dokumenta të tepërta dhe të pacilësuar në aktet ligjore apo nënligjore, siç kemi analizuar më lart në vendim, kërkesën nga ana e Bashkisë për dorëzimin e një kontrate qiraje banese, kur kjo kërkesë është fakultative dhe jo e domosdoshme për t'u plotësuar nga aplikanti.

Për më tepër, ankuesja, duke qenë pjesë e minoriteti rom, duhet të përfitonte asistencën e nevojshme nga të gjitha strukturat përgjegjëse të Bashkisë për të plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar si për punësimin e saj, ashtu dhe për strehimin.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia, nuk ndërmorri asnjë masë konkrete lidhur me problematikën e strehimit të ankueses, edhe pasi ajo kishte informuar shkresërisht atë, për punësimin e saj dhe të babait biologjik të fëmijëve të saj, dhe për mundësinë se aktualisht banojnë në një banesë me qira, të cilën arrijnë ta paguajnë vetë.

Nuk u sollën fakte e prova nga ana e Bashkisë që minimalisht të tregonin interesimin dhe angazhimin e saj lidhur me verifikimin për sa kishte deklaruar ankuesja apo që të kishte vlerësuar e analizuar situatën aktuale të ankueses dhe famijes së saj, në mënyrë që të hartonte një relacion apo të dilte në konkluzione lidhur me gjendjen e tanishme.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se, Bashkia Tiranë nuk provoi që kishte përmbushur detyrimet e saj ligjore karshi ankueses, dhe nuk solli një justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv lidhur me masat konkrete që duhet të kishte ndërmarrë për punësimin, strehimin e ankueses, në kuadër të fuqizimit të familjes të saj.

Komisioneri konstaton se, Bashkia Tiranë ka diskriminuar subjektin ankues, lidhur me mosmarrjen e masave efektive për fuqizimin e familjes së ankueses, (*kryesisht në kuadër të punësimit dhe strehimit*) për rimarrjen e fëmijëve sërish pranë familjes biologjike.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë vendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Tiranë, dhe kjo mund të realizohet, duke ndërmarrë hapat konkretë në përmbushje të qëllimit për fuqizimin e famijes së ankueses. Vetëm në këtë mënyrë asaj i krijohet mundësia reale për të kërkuar gjyqësisht rimarrjen e fëmijëve nga institucionet e përkujdesjes alternative ku ndodhen aktualisht, dhe e gjithë përgjegjësia e vendimmarrjes i takon gjykatës, e cila vlerëson dhe vendos në respektim të interesit

më të lartë të fëmijëve, nëse ato duhen rikthyer pranë familjes biologjike apo duhet të vijojnë të qëndrojnë në institucionet e përkujdesjes alternative.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të shumëfishtë, të subjektit ankues, P.B., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

57. M.L., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.,

VENDIM NR. 138, DATË 07.07.2022

Shkaku: Bindja politike dhe mosha
Forma: në formën e diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi është liruar nga detyra e Punëtorit të Linjave Hidraulike në UK Vau i Dejës sh.a., duke u diskriminuar për shkak të bindjeve e aktivitetit të tij politik dhe të moshës.

FAKTET

Subjekti ankues ka qënë në marrëdhënie pune me Ujësjetllës Kanalizime sh.a., (UK) Vau i Dejës, dhe ka mbajtur pozicionin e Punëtorit të Linjave Hidraulike, pranë UK Vau i Dejës, deri me datë 22.01.2020, kur është liruar nga detyra. Lirimi nga detyra është i pamotivuar, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mospërmbushje të detyrës nga ana e tij, por ka ndodhur vetëm pak pas largimit të Administratores së mëparshme dhe zëvendësimit të saj me Administratorin aktual, I.B., i cili, është përfaqësues politik i PS në Vau i Dejës, dhe ka bindje të kundërta politike me të, pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë, po ashtu edhe për shkak të moshës së tij, pasi ishte në prag pensioni.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: Vendimi Nr. 31/2021, i Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane”, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, (1966) dhe dy Protokollat e tij Opsionale;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- “Plani Ndërkombëtar të Veprimit të Vjenës për Moshimin (1982)”;
- VKM Nr. 864, datë 24.12.2019, e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”;
- Plani Kombëtar mbi Moshimin 2020-2024.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se UK Vau i Dejës:

Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se cilat detyra funksionale të ankuesit si “Punëtor linjash”, nuk ishin përmbushur konkretisht.

Nuk paraqiti asnjë dokument ku të evidentohet performanca e tij në punë apo ndonjë vlerësim pune, as nga eprori direkt i tij, Përgjegjësi i Sektorit, as nga punëdhënësi.

Nuk paraqiti asnjë dokument apo provë tjetër ku të provohet pretendimi i punëdhënësit lidhur me konsumimin e alkoolit gjatë orarit zyrtar të punës nga ankuesi.

Komisioneri thekson faktin se punëdhënësi nuk argumentoi lidhur me faktin se përse ankuesi vetëm një vit para se të mbushte moshën e pensionit u largua nga detyra, para përfundimit të afatit ligjor të kontratës individuale të punës. Nga krahasimi i dosjeve të tij dhe punonjësit që e ka zëvendësuar atë, E.V., rezultoi se ky i fundit është i datëlindjes 24.02.1983.

Për më tepër, megjithëse shkarazi, në parashtrimet para KMD-së, UK Vau i Dejës citon se largimi i ankuesit nga puna është bërë edhe në kuadër të ristrukturimit të Shoqërisë, nuk UK Vau i Dejës, nuk depozitoi asnjë akt shkresor për të provuar se: ristrukturimi i Shoqërisë do të ishte strukturor apo do të prekte edhe organikën e Shoqërisë duke shkurtuar numrin e punonjësve dhe për më tepër sa do të ishte numri i punonjësve që do të largoheshin nga puna; cilat do të ishin kriteret mbi bazët e të cilave do të realizohej ristrukturimi dhe përzgjedhja e punonjësve të cilët do të vazhdonin punën dhe atyre që do të largoheshin nga puna; cila ishte procedura, afatet dhe strukturat/personat e ngarkuar me procesin e ristrukturimit; dhe si ishte vlerësuar përmbushja e kriterëve, kualifikimi dhe performanca në punë e paditësit në raport me personat e tjerë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se nevoja për rivlerësimin e marrëdhënies së punës me ankuesin kishte si shkak ristrukturimin e Shoqërisë.

UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin ishte ristrukturimi.

Komisioneri vlerëson se, shkak i shtuar në shpjegimet e sjella para KMD-së nga ana e punëdhënësit, ai i ristrukturimit të Shoqërisë, nuk është cituar në asnjë nga shkresat në procedurën e ndjekur prej saj, për largimin e ankuesit nga puna. Ato janë shtuar si argumenta shtesë gjatë prapësimeve para Komisionerit, për rrjedhojë nuk mund të kenë shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna.

Lidhur me këtë motivacion të cituar nga punëdhënësi, i cili sipas tij ka shërbyer për të larguar ankuesin nga puna, Komisioneri vëren se, UK Vau i Dejës, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë për t'u dëgjuar, parashtruar argumentat e tij e mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

UK Vau i Dejës, ka parashtruar si argumenta para Komisionerit se, arsyet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, ishin për shkak të *performancës së dobët në punë, mungesës së bashkëpunimit me titullarin, si dhe ristrukturimi i ndërmarrjes*; ndërkohë që, punëdhënësi, nuk arriti t'i provojë e faktojë pretendimet e veta kundrejt ankuesit.

Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga *mosha e bindjet politike* të ankuesit, dhe se atij i është cënuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e ushtrimit të profesionit. UK Vau i Dejës, në cilësinë e punëdhënësit të ankuesit është një shoqëri aksionere e cila funksionon në bazë të Ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, me aksioner të vetëm Bashkinë Vau i Dejës.

Rezulton se, M.B., është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste e Shqipërisë. Pas konstituimit të Këshillit Bashkiak, ai ka bërë betimin si Kryetar i Bashkisë Vau i Dejës më datë 09.08.2019. Gjithashtu, bazuar në jetëshkrimin e publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me aktivitetin politik të M. B, rezulton që ai ka mbajtur pozicionin e koordinatorit elektoral të PS, në Bashkinë Vau i Dejës, aktiviteti politik i të cilit është i njohur. Kompetencën për të emëruar dhe liruar nga detyra, Administratorin e UK, e ka Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme që në rastin e Shoqërive Aksionere Ujësjiellës Kanalizime është Kryetari i Bashkisë. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për vetqeverisjen vendore. (*Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"*).

Bazuar në të dhenat e pasqyruara në ekstraktin historik të shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a., pak kohë pas emërimit të tij në detyrë në shoqërinë UK Vau i Dejës, kanë ndodhur disa ndryshime në organet e saj drejtuese dhe ndër të tjera, në pozicionin e Administratorit të UK Vau i Dejës, me datë 10.10.2019, është emëruar I.B.

Administratori i ri, një muaj pas emërimit në detyrë ka filluar procedurën e për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.

Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit/Shoqërisë në dëm të subjektit ankues kanë ardhur menjëherë pas zgjedhjes dhe emërimit të Administratorit të Shoqërisë.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se UK Vau i Dejës deklaroi motivacione dhe shkaqe të ndyshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Nga dokumentacioni i sjellë nga UK Vau i Dejës, rezultoi se vendi i punës së ankuesit nuk është shkurtuar dhe pas largimit të tij nga puna ky vend pune është plotësuar me punonjës Z.K., i cili, nga të dhënat e disponuara rezultoi se, i ka të ekspozuara bindjet politike si përfaqësues i PS, si kandidat dhe anëtar i Këshillit Bashkia Vau i Dejës (*në vitet paraardhëse*).

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përse i takon procedurës së ndjekur për largimin e tij nga puna, si dhe shkaqeve bazuar mbi të cilat i është zgjidhur marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim, trajtimi i pabarabartë ka nisur menjëherë një muaj pas emërimit në detyrë të Administratorit të UK Vau i Dejës dhe 4 muaj pas emërimit të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës. Komisioneri gjykon se largimi i punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës, të cilët kishin të ekspozuara bindjet e kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, ka ndikuar në veprimet e ndërmarra nga ana e Administratorit të UK Vau i Dejës.

Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar, aktivist dhe pjesë e strukturave drejtuese të subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që UK Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Kjo bindje përforcohet më shumë, pasi punëdhënësi ka zëvendësuar ankuesin me një punonjës tjetër, bindjet e majta të të cilit, si pjesë e strukturave të PS/Vau i Dejës janë të ekspozuara e të njohura botërisht.

Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga bindjet politike të ankuesit dhe moshë e tij.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, M.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike dhe të moshës, *në formën e udhëzimit për diskriminim*, si dhe *në formën e diskriminimit ndërsektorial*, nga ana e Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës.

58. F.N., kundër Shoqërisë “Albcontrol” sh.a.,

VENDIM NR. 102, DATË 07.06.2022

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim ndërsektorial, si dhe në formën e rëndë të tij.
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues është diskriminuar nga ana e Shoqërisë “Albcontrol”, në të drejtën për punësim, duke e larguar nga detyra, për shkak të qënies së saj si përfaqësuese, pjesë e Kryesisë së SPKTA si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore.

FAKTET

Subjekti ankues, F.N., ka lidhur marrëdhënien e punës me Shoqërinë “Albcontrol” sh.a në vitin 2002, marrëdhënie e cila ka vijuar për rreth 20 (njëzet) vite. Ankuesja ka ushtruar detyrat funksionale në cilësinë e Kontrolllores së Trafikut Ajror, pranë kësaj Shoqërie.

Punëdhënësi/“Albcontrol” sh.a. në mënyrë të njëanshme ka vendosur uljen e pagave të punëmarrësve/KTA, në masën nga 60-70% të saj, si dhe ka pezulluar pa afat të caktuar edhe disa të drejta të fituara me Kontratën Kolektive dhe Individuale të Punës, vendim i cili është kundërshtuar gjyqësisht nga Sindikata e Pavarur e Kontrollorëve të Trafikut Ajror SPKTA. (*Në Kryesinë e së cilës bën pjesë edhe subjekti ankues*), pasi cënonte një element thelbësor të kontratës siç është paga.

Në vijim, ankuesja gjatë ushtrimit të detyrës, ka ndjerë mungesë të theksuar të përqendrimit. Duke qenë se gjatë orarit të punës nuk ka ndjerë përmirësime, pas përfundimit të orarit zyrtar të turnit të punës, bazuar në Skemën e Kompetencës ka tërhequr Formularin përkatës të paaftësisë së përkohshme, dhe e ka plotësuar atë.

Pasi ankuesja ka plotësuar formularin e ka dorëzuar atë pranë punëdhënësit. Po të njëjtën ditë, pas këtij momenti teksa po largohej nga ambjentet e punës, është thirrur dhe i është njoftuar urdhri për fillimin e procedurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Të nesërmen e këtij njoftimi, punëdhënësi ka paraqitur kallëzim penal ndaj ankueses (*si dhe ndaj dy KTA të tjerë A.F., dhe M.M.*), për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

Më tej pas arrestimit të ankueses, bazuar mbi kallëzimin penal, dhe zbatimin e masës së shtrëngimit personal; punëdhënësi me një urdhër të brendshëm të tij, ka urdhëruar, përpos pezullimit të urdhrit për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, edhe heqjen e të drejtës së pagës dhe të hyrjes së ankueses në ambjentet e punës, deri në një vendim penal të formës së prerë të organeve gjyqësore. Ndërkohë, pa pritur vendimin e formës së prerë, Albcontrol sh.a ka zgjidhur marrëdhënien e punës me ankuesen.

Masat e ndërmarra nga punëdhënësi në dëm të saj kanë ardhur pikërisht për shkak të veprimtarisë së saj sindikaliste, si përfaqësuese e kësaj Sindikate, pasi është etiketuar nga punëdhënësi si nxitëse ndaj KTA-ve të tjerë që edhe ata të plotësonn formularin e paaftësisë së punë, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: vendimi Nr. 31/2021; vendimi Nr. 4, datë 21.02.2022; Nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: çështja Zakharova and të tjerët kundër Ruisisë, *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Ruisisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. RepublikësÇeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178);
- “Karta Sociale Evropiane”, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Konventa Nr. C087 “Për lirinë e asocimit dhe mbrojtjen e së drejtës së organizimit”;
- Konventa Nr. C098: “Zbatimi i parimeve të së drejtës së organizimit dhe marrëveshjeve kolektive”;
- Konventa Nr. C135: “Për mbrojtjen dhe krijimin e lehtësirave për përfaqësuesit e punëtorëve”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, (1966) dhe dy Protokollat e tij Opsionale;
- Direktiva dhe Rregullore të Eurokontrollit (rregullorja e Komisionit 340/2015 dhe 373/2017);
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 91, datë 21.2. 2019 “Për miratimin e Rregullores mbi Përcaktimin e Kërkesave Teknike dhe Procedurave Administrative në lidhje me Licencat dhe Certifikatat e Kontrolloreve të Trafikikut Ajror” dhe “Skemën e kompetencës për KTA”.

KONKLUSIONE

Albcontrol sh.a ka pranuar se trajtimi i subjektit ankues është bazuar pikërisht në shkakun e pretenduar prej tij, atë të deklarimit të paaftësisë së përkohshme në punë (*gjendjes shëndetësore*), dhe në këto kushte, kishte barrën e provës që të provonte, se megjithëse trajtimi i pafavorshëm dhe i pabarabartë është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses për diskriminim, lidhur me këtë shkak. Po ashtu, lidhur me shkakun tjetër të pretenduar, atë të përkatësisë në sindikatë, “Albcontrol” sh.a kishte barrën e provës të provonte që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.

Komisioneri ka vlerësuar në arsyetimin e tij se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë krahasuar me 44 KTA-të e tjerë që aktualisht vijojnë të jenë në marrëdhënie pune dhe të ushtrojnë privilegjet e licencës së KTA-së, përsa i takon ndërprerjes së marrëdhënies të punës me të, si dhe dërgimit për ndjekje penale nga ana e Albcontrol sh.a.

Fakti i trajtimit të ankuesit në mënyrë të pabarabartë me 44 KTA-të e tjerë është pranuar nga ana e punëdhënësit, me argumentimin se ata ishin tërhequr nga deklarata e paaftësisë në punë në ndryshim nga ankuesja e cila përveç se kishte sjellë vështirësi në menaxhimin me burime njerëzore të Sallës Operacionale të Shoqërisë, edhe kishte cënuar parimin e mirëbesimit, pasi kishte nxitur KTA-të e tjerë për deklarimin e paaftësisë në punë, duke cënuar kështu sigurinë e vazhdimësinë e lundrimit ajror në mënyrë të sigurt e të pandërprerë.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënies të punës me ankuesen, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtat e saj ligjore, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “Albcontrol” sh.a., nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të pabarabartë dhe të padrejtë krahasuar me 44 KTA-të e tjerë.

Pra në përfundim, Komisioneri konstaton se:

- Ankuesja nuk kishte shkelur ndonjë akt ligjor apo nënligjor me deklarimin e paaftësisë së përkohshme në punë;
- Ankuesja nuk kishte bërë një deklaram të pavërtetë të gjendjes shëndetësore;
- “Albcontrol” sh.a., nuk ka marrë asnjë masë, si dhe nuk ka ndjekur asnjë procedurë për verifikimin e paaftësisë në punë të ankueses, apo 44 KTA-ve të tjerë.
- “Albcontrol” sh.a nuk ka marrë asnjë masë, si dhe nuk ka ndjekur asnjë procedurë për verifikimin e aftësisë në punë të 44 KTA-ve (*deklaruar prej tyre respektivisht në datat 08-09-10-11-12-13 prill 2021*).
- Ankuesja nuk është vënë në dijeni nga punëdhënësi se deklarimi i paaftësisë së saj për punë do të shërbente si shkak për zgjidhjen e marrëdhënies të punës me të, si dhe nuk i janë krijuar kushtet e mundësitë reale për të deklaruar aftësinë për punë, pasi kanë iniciuar menjëherë pas dorëzimit të deklaratës së paaftësisë nga ana e saj procedurën për largimin

nga puna, si dhe e kanë kallëzuar penalisht, për shpërdorim detyre në prokurori; praktikë e cila rezulton të mos jetë ndjekur për 44 KTA-të e tjerë, që vijuan punën normalisht.

- “Albcontrol” sh.a., nuk provoi se ankuesja, me plotësimin e deklaratës së paaftësisë kishte sjelle vështirësi operacionale apo të kishte vështirësuar shërbimin në lundrimin ajor (*duke bllokuar lundrimin ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë*), pasi ajo nuk kishte qenë fare në punë në datën e pretenduar.
- “Albcontrol” sh.a., duhet të kishte pritur që gjykata të shprehej me vendim të formës së prerë, (*sikurse vetë ishte shprehur në Urdhrin respektiv të pezullimit nga detyra për subjektin ankues*) përse i takon kallëzimit penal që kishte depozituar, në mënyrë që pretendimet e ngritura prej tyre për nxitje të KTA-ve të tjerë nga ankuesja, apo pengimin e shërbimit të lundrimit ajror në mënyrë të sigurt e të pandërprerë nga ana e saj të merrnin përgjigjen përfundimtare, nga organi kompetent, Gjykata e Apelit.
- “Albcontrol” sh.a., nuk provoi se ankuesja kishte cënuar parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës me punëdhënësin, përse kohë nuk ishte vërtetuar me vendim të formës së prerë (*pavarësisht faktit se në momentin e largimit të saj nga puna, punëdhënësi ishte njohur vetëm me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*), vendim për të cilin vetë punëdhënësi ishte shprehur se do të bazohej tek ai për rikthimin e ankueses në detyrë (*referuar Urdhrit të pezullimit nga detyra për ankuesen*).
- “Albcontrol” sh.a., duke mos pritur që gjykata të shprehej me vendim të formës së prerë, ka konsumuar edhe një shkelje tjetër ligjore, duke cënuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi ka konsideruar dhe marrë të mirëqenë faktin se ankuesja ka cënuar besimin e punëdhënësit për shkak të nxitjes së KTA-ve të tjerë për deklarimin e paaftësisë në punë, duke vënë në vështirësi operacionale dhe cënuar sigurinë e lundrimit ajror me datë 07.04.2021 (*shkak mbi të cilin ka justifikuar edhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të*). Pra, punëdhënësi ka konsideruar se ankuesja kishte konsumuar veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit” e kryer në bashkëpunim, dhe në këtë kontekst ka vlerësuar edhe se ajo kishte cënuar besimin e punëdhënësit.
- Sipas Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (*neni 30 i Kushtetutës*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t’u mbrojtur në një gjykim të drejtë. (*shih vendimet Nr. 4, datë 21.02.2022; Nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).
- Ankuesja kishte zbatuar të drejtën dhe detyrimin ligjor për deklarimin e paaftësisë në punë, *individualisht*, dhe nga ana e Albcontrol sh.a nuk është provuar në asnjë moment që ajo të kishte nxituar KTA-të e tjerë, që kolektivisht të deklarinin paaftësinë e përkohshme në punë, përse kohë ky deklarim është individual dhe bazohet në diskrecionin e KTA-së për vetëdeklarim.

Nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e “Albcontrol” sh.a., i kanë ardhur pas deklarimit të paaftësisë së përkohshme në punë, pasi punëdhënësi e ka etiketuar e cilësuar si nxitëse dhe ndikuese tek KTA-të e tjerë, që dhe ata të deklaronin paaftësinë në punë me qëllim vënien në vështirësi operacionale të punëdhënësit. Pra, në këtë mënyrë, duke e etiketuar dhe cilësuar si ndikuese e nxitëse, punëdhënësi njihet e pranon këto cilësi e attribute të saj, të lidhura pazgjydhshëmrisht me cilësinë e tagrin e saj të përfaqësueses së Sindikatës, pasi ajo është edhe pjesë e Kryesisë së saj (*fakt ky i njohur nga punëdhënësi*).

Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkaku i gjendjes shëndetësore (*deklarimi i paaftësisë së përkohshme në punë*) dhe ai i përkatësisë në një grup të veçantë (*Përkatësisë sindikaliste, pjesë e Kryesisë së SPKTA, sekretare e saj*), kanë bashkëvepruar me njëri tjetrin, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuar, duke bërë që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm e i pabarabartë i ankueses, të lidhet drejtpërdrejtë me këto shkaqe/cilësi të saj.

Komisioneri konstaton se Shoqëria “Albcontrol” sh.a., ka diskriminuar ankuesen në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm por është bërë për shkaqe të mbrojtura nga LMD, gjendjen shëndetësore dhe përkatësinë në grup të veçantë.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, F.N., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në një grup të veçantë, në formën e diskriminimit ndërsektorial, si dhe në formën e rëndë të tij, nga ana e Shoqërisë “Albcontrol” sh.a.
- Shoqëria “Albcontrol” sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës, si dhe për ushtrimin e privilegjeve të licencës së KTA-së”.

59. A.F., kundër Shoqërisë “Albcontrol” sh.a.,

VENDIM NR. 140, DATË 07.07.2022

Shkaku: Përkatësia në sindikatë dhe gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim ndërsektorial; Diskriminim në formën e rëndë.
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi A.F., është diskriminuar nga ana e Shoqërisë “Albcontrol”, në të drejtën për punësim, duke e larguar nga detyra, për shkak të qënies së tij Kryetar i Sindikatës së Pavarur të Kontrollorëve të Trafikut Ajror (SPKTA) dhe gjendjes shëndetësore.

FAKTET

Ankuesi A.F., ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Albcontrol” sh.a., për rreth 20 (njëzet) vite, deri me datë 11.01.2022 dhe ka ushtruar detyrat funksionale në cilësinë e Kontrollorit të Trafikut Ajror, pranë kësaj Shoqërie. Që prej vitit 2016 ankuesi është zgjedhur Kryetar i Sindikatës së Pavarur të Kontrollit të Trafikut Ajror (SPKTA).

Në prill 2020, gjatë periudhë së pandemisë Covid-19, punëdhënësi/“Albcontrol” sh.a., në mënyrë të njëanshme ka vendosur uljen e pagave të punëmarrësve/KTA, në masën nga 60-70% të saj, si dhe ka pezulluar pa afat të caktuar edhe disa të drejta të fituara me Kontratën Kolektive dhe Individuale të Punës, vendim i cili është kundërshtuar gjyqësisht në korrik të vitit 2020 nga Sindikata e Pavarur e Kontrollorëve të Trafikut Ajror SPKTA, përfaqësuar nga ankuesi në cilësinë e Kryetarit, pasi cënonte një element thelbësor të kontratës, siç është paga. Ndërkohë, gjatë gjithë kësaj periudhe dhe në mënyrë të vazhdueshme, ankuesi, në cilësinë e Kryetarit të SPKTA ka kërkuar nga punëdhënësi rishikimin e vendimit me të cilin ishin ulur pagat duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim.

Me datë 05.04.2021, ankuesi kishte qenë i parashikuar në grafik për të punuar turni i tretë, por për shkak të gjendjes shëndetësore *post covid 19*, kishte njoftuar eprorin se për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mund të paraqitej në punë. Të nesërmen, në datën 06.04.2021, ankuesi, nuk ka qenë i parashikuar në grafik për të punuar, por bazuar në Skemën e Kompetencës ka plotësuar deklaratën e paaftësisë së përkohshme, në të cilin ka deklaruar se *prej një muaji kishte kaluar covidin dhe po përjetonte pagjumësi dhe humbje përqëndrimi, si dhe njoftimi që kishin marrë po atë ditë për largimin e 5 kolegëve nga puna kishte rritur së tepërmi stresin dhe ankthin. Nisur nga këto rrethana ankuesi ka deklaruar se e kishte të pamundur të ofronte shërbim të sigurt.*

Përpara ankuesit, deklaratën e paaftësisë së përkohshme e kishin plotësuar 5 kontrollorë të tjerë të trafikut ajror, ndërsa pas tyre jo vetëm ankuesi por edhe një pjesë e madhe e kontrollorëve kanë plotësuar deklaratën e paaftësisë së përkohshme, gjithsej 47 kontrollorë (duke përfshirë ankuesin dhe 5 kontrollorët e parë)

Në datën 07.04.2021, punëdhënësi ka paraqitur kallëzim penal ndaj ankueses (*si dhe ndaj dy KTA të tjerë A.F., dhe M.M.*), për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në bazë të kallëzimit penal të bërë nga punëdhënësi ankuesi dhe 2 KTA e tjerë janë arrestuar dhe ndaj tyre është marrë masa e sigurimit personal “arrest në burg”. Në datën 12.04.2022, punëdhënësi ka urdhëruar, pezullimin e ankuesit nga puna dhe heqjen e të drejtës së pagës dhe të hyrjes së ankuesit në ambjentet e punës, deri në një vendim penal të formës së prerë të organeve gjyqësore. Ndërkohë, me datë 11.01.2022, Albcontrol sh.a., ka zgjidhur marrëdhënien e punës me ankuesin, ndërkohë që vendimi penal nuk kishte marrë formë të prerë. Gjykata nuk ka konstatuar përgjegjësi penale për ankuesin dhe 2 KTA e tjerë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: vendimi Nr. 31/2021; vendimi Nr. 4, datë 21.02.2022; Nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolle 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: çështja Zakharova and të tjerët kundër Rusisë, *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H ., dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178);
- “Karta Sociale Evropiane”, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Konventa Nr. C087 “Për lirinë e asocimit dhe mbrojtjen e së drejtës së organizimit”;
- Konventa Nr. C098: “Zbatimi i parimeve të së drejtës së organizimit dhe marrëveshjeve kolektive”;
- Konventa Nr. C135: “Për mbrojtjen dhe krijimin e lehtësirave për përfaqësuesit e punëtorëve”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, (1966) dhe dy Protokolle të tij Opsionale;
- Direktiva dhe Rregullore të Eurokontrollit (rregullorja e Komisionit 340/2015 dhe 373/2017);
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 91, datë 21.2. 2019 “Për miratimin e Rregullores mbi Përcaktimin e Kërkesave Teknike dhe Procedurave Administrative në lidhje me Licencat dhe Certifikatat e Kontrolloreve të Trafikut Ajror” dhe “Skemën e kompetencës për KTA”.

KONKLUSIONE

Albcontrol sh.a ka pranuar se trajtimi i ankuesit është bazuar pikërisht në shkakun e pretenduar prej tij, atë të deklarimit të paaftësisë së përkohshme në punë (*gjendjes shëndetësore*), dhe në këto kushte, kishte barrën e provës që të provonte, se megjithëse trajtimi i pafavorshëm dhe i pabarabartë është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses për diskriminim, lidhur me këtë shkak. Po ashtu, lidhur me shkakun tjetër të pretenduar, atë të përkatësisë në sindikatë, “Albcontrol” sh.a.,

kishte barrën e provës të provonte që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.

Komisioneri ka vlerësuar në arsyetimin e tij se, ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë krahasuar me 44 KTA-të e tjerë që aktualisht vijojnë të jenë në marrëdhënie pune dhe të ushtrojnë privilegjet e licencës së KTA-së, përse i takon ndërprerjes së marrëdhënies të punës me të, si dhe dërgimit për ndjekje penale nga ana e Albcontrol sh.a.

Fakti i trajtimit të ankuesit në mënyrë të pabarabartë me 44 KTA-të e tjerë është pranuar nga ana e punëdhënësit, me argumentimin se ata ishin tërhequr nga deklarata e paaftësisë në punë në ndryshim nga ankuesi, i cili përveç se kishte sjellë vështirësi në menaxhimin me burime njerëzore të Sallës Operacionale të Shoqërisë, edhe kishte cënuar parimin e mirëbesimit, pasi kishte nxitur KTA-të e tjerë për deklarimin e paaftësisë në punë, duke cënuar kështu sigurinë e vazhdimësinë e lundrimit ajror në mënyrë të sigurt e të pandërprerë.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënies të punës me ankuesin, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtat e tij ligjore, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “Albcontrol” sh.a., nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të pabarabartë dhe të padrejtë krahasuar me 44 KTA-të e tjerë. Pra në përfundim, Komisioneri konstaton se:

- Ankuesi nuk kishte shkelur ndonjë akt ligjor apo nënligjor me deklarimin e paaftësisë së përkohshme në punë;
- Ankuesi nuk kishte bërë një deklaram të pavërtetë të gjendjes shëndetësore;
- “Albcontrol” sh.a., nuk ka marrë asnjë masë, si dhe nuk ka ndjekur asnjë procedurë për verifikimin e paaftësisë në punë të ankueses, apo 44 KTA-ve të tjerë.
- “Albcontrol” sh.a., nuk ka marrë asnjë masë, si dhe nuk ka ndjekur asnjë procedurë për verifikimin e aftësisë në punë të 44 KTA-ve (*deklaruar prej tyre respektivisht në datat 08-09-10-11-12-13 prill 2021*).
- Ankuesi nuk është vënë në dijeni nga punëdhënësi se deklarimi i paaftësisë së tij për punë do të shërbente si shkak për zgjidhjen e marrëdhënies të punës me të, si dhe nuk i janë krijuar kushtet e mundësitë reale për të deklaruar aftësinë për punë, pasi kanë iniciuar menjëherë pas dorëzimit të deklaratës së paaftësisë nga ana e saj procedurën për largimin nga puna, si dhe e kanë kallëzuar penalisht, për shpërdorim detyre në prokurori; praktikë e cila rezulton të mos jetë ndjekur për 44 KTA-të e tjerë, që vijuan punën normalisht.
- “Albcontrol” sh.a., nuk provoi se ankuesi, me plotësimin e deklaratës së paaftësisë kishte sjellë vështirësi operacionale apo të kishte vështirësuar shërbimin në lundrimin ajror (*duke bllokuar lundrimin ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë*), pasi ai nuk kishte qenë fare në punë në datën e pretenduar.
- “Albcontrol” sh.a., duhet të kishte pritur që gjykata të shprehej me vendim të formës së prerë, (*sikurse vetë ishte shprehur në Urdhrin respektiv të pezullimit nga detyra për*

ankuesin) përsa i takon kallëzimit penal që kishte depozituar, në mënyrë që pretendimet e ngritura prej tyre për nxitje të KTA-ve të tjerë nga ankuesi, apo pengimin e shërbimit të lundrimit ajror në mënyrë të sigurt e të pandërprerë nga ana e tij të merrnin përgjigjen përfundimtare, nga organi kompetent, Gjykata e Apelit.

- “Albcontrol” sh.a., nuk provoi se ankuesi kishte cënuar parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës me punëdhënësin, përsa kohë nuk ishte vërtetuar me vendim të formës së prerë (*pavarësisht faktit se në momentin e largimit të saj nga puna, punëdhënësi ishte njohur vetëm me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*), vendim për të cilin vetë punëdhënësi ishte shprehur se do të bazohej tek ai për rikthimin e ankuesin në detyrë (*referuar Urdhrit të pezullimit nga detyra për ankuesit*).
- “Albcontrol” sh.a., duke mos pritur që gjykata të shprehej me vendim të formës së prerë, ka konsumuar edhe një shkelje tjetër ligjore, duke cënuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi ka konsideruar dhe marrë të mirëqenë faktin se ankuesi ka cënuar besimin e punëdhënësit për shkak të nxitjes së KTA-ve të tjerë për deklarimin e paaftësisë në punë, duke vënë në vështirësi operacionale dhe cënuar sigurinë e lundrimit ajror me datë 07.04.2021 (*shkak mbi të cilin ka justifikuar edhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të*). Pra, punëdhënësi ka konsideruar se ankuesi kishte konsumuar veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit” e kryer në bashkëpunim, dhe në këtë kontekst ka vlerësuar edhe se ai kishte cënuar besimin e punëdhënësit.
- Sipas Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (*neni 30 i Kushtetutës*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t’u mbrojtur në një gjykim të drejtë. (*shih vendimet Nr. 4, datë 21.02.2022; Nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).
- Ankuesi kishte zbatuar të drejtën dhe detyrimin ligjor për deklarimin e paaftësisë në punë, *individualisht*, dhe nga ana e Albcontrol sh.a nuk është provuar në asnjë moment që ai të kishte nxituar KTA-të e tjerë, që kolektivisht të deklaronin paaftësinë e përkohshme në punë, përsa kohë ky deklarim është individual dhe bazohet në diskrecionin e KTA-së për vetëdeklarim.

Nisur nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e “Albcontrol” sh.a i kanë ardhur pas deklarimit të paaftësisë së përkohshme në punë, pasi punëdhënësi e ka etiketuar e cilësuar si nxitës dhe ndikues tek KTA-të e tjerë, që dhe ata të deklaronin paaftësinë në punë me qëllim vënien në vështirësi operacionale të punëdhënësit. Pra, në këtë mënyrë, duke e etiketuar dhe cilësuar si ndikues e nxitës, punëdhënësi njih e pranon këto cilësi e attribute të tij, të lidhura pazgjidhshmërisht me cilësinë e tagrin e tij si përfaqësues i Sindikatës, pasi ai është kryetar i saj (*fakt ky i njohur nga punëdhënësi*).

Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkaku i gjendjes shëndetësore (*deklarimi i paaftësisë së përkohshme në punë*) dhe ai i përkatësisë në Sindikatë (*Kryetar i SPKTA*), kanë bashkëvepruar me njëri tjetrin, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuar, duke bërë që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm e i pabarabartë i ankuesit, të lidhet drejtpërdrejtë me këto shkaqe/cilësi të tij.

Komisioneri konstaton se Shoqëria “Albcontrol” sh.a., ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm por është bërë për shkaqe të mbrojtura nga LMD, gjendjen shëndetësore dhe përkatësinë në grup të veçantë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të ankuesit A.F., në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në sindikatë, në formën e diskriminimit ndërsektorial, si dhe në formën e rëndë të tij, nga ana e Shoqërisë Albcontrol sh.a.
- Në referim të pikës 1, Shoqëria Albcontrol sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin A.F., në pozicionin e mëparshëm të punës, si dhe për ushtrimin e privilegjeve të licencës së KTA-së.

60. Z.Ll., kundër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.,

VENDIM NR. 139, DATË 07.07.2022

Shkaku: Bindja politike, mosha
Forma: Udhëzim për diskriminim dhe diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Vau i Dejës sh.a., deri në vitin 2019. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi është liruar nga detyra e Përgjegjës të Sektorit, në UK Vau i Dejës sh.a., për shkak të bindjeve e aktivitetit të tij politik.

FAKTET

Subjekti ankues ka qënë në marrëdhënie pune me Ujësjetllës Kanalizime sh.a., (UK) Vau i Dejës, dhe ka mbajtur pozicionin e punëtorit Teknik STP, pranë UK Vau i Dejës, deri me datë 22.12.2019,

kur është liruar nga detyra. Lirimi nga detyra i ankuesi ishte i pamotivuar, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mospërmbushje të detyrës nga ana e tij. Gjithashtu, largimi i tij nga puna ka ndodhur vetëm pak pas largimit të Administratores së mëparshme dhe zëvendësimit të saj me Administratorin e ri, I.B., i cili, i cili është përfaqësues politik i PS në Vau i Dejës, dhe ka bindje të kundërta politike me të, pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: Vendimi Nr. 31/2021, i Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se UK Vau i Dejës:

Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se cilat detyra funksionale të ankuesit si “Teknik STP”, nuk ishin përmbushur konkretisht.

Nuk paraqiti asnjë dokument ku të evidentohet performanca e tij në punë apo ndonjë vlerësim pune, as nga eprori direkt i tij, Përgjegjësi i Sektorit, as nga punëdhënësi.

Komisioneri thekson faktin se punëdhënësi nuk argumentoi lidhur me faktin se përse ankuesi rreth dy vite para se të mbushte moshën e pensionit u largua nga detyra, para përfundimit të afatit ligjor të kontratës individuale të punës. Nga krahasimi i dosjeve të tij dhe punonjësit që e ka zëvendësuar atë, E. V., rezultoi se ky i fundit është i datëlindjes 24.02.1983.

Për më tepër, megjithëse shkarazi, në parashtrimet para KMD-së, UK Vau i Dejës citon se largimi i ankuesit nga puna është bërë edhe në kuadër të ristrukturimit të Shoqërisë, UK Vau i Dejës, nuk depozitoi asnjë akt shkresor për të provuar se: ristrukturimi i Shoqërisë do të ishte strukturor apo do të prekte edhe organikën e Shoqërisë duke shkurtuar numrin e punonjësve dhe për më tepër sa do të ishte numri i punonjësve që do të largoheshin nga puna; cilat do të ishin kriteret mbi bazët e të cilave do të realizohej ristrukturimi dhe përzgjedhja e punonjësve të cilët do të vazhdonin punën dhe atyre që do të largoheshin nga puna; cila ishte procedura, afatet dhe strukturat/personat e ngarkuar me procesin e ristrukturimit; dhe si ishte vlerësuar përmbushja e kriterëve, kualifikimi dhe performanca në punë e paditësit në raport me personat e tjerë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se nevoja për rivlerësimin e marrëdhënies së punës me ankuesin kishte si shkak ristrukturimin e Shoqërisë.

UK Vau i Dejës nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin ishte ristrukturimi.

Komisioneri vlerëson se, shkak i shtuar në shpjegimet e sjella para KMD-së nga ana e punëdhënësit, ai i ristrukturimit të Shoqërisë, nuk është cituar në asnjë nga shkresat në procedurën e ndjekur prej saj, për largimin e ankuesit nga puna. Ato janë shtuar si argumenta shtesë gjatë prapësimeve para Komisionerit, për rrjedhojë nuk mund të kenë shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna.

Lidhur me këtë motivacion të cituar nga punëdhënësi, i cili sipas tij ka shërbyer për të larguar ankuesin nga puna, Komisioneri vëren se, UK Vau i Dejës, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë për t'u dëgjuar, parashtruar argumentat e tij e mbrojtur efektivisht lidhur me masën më ekstreme, atë të zgjidhjes së kontratës së punës.

Komisioneri vërejt se veprimet e Administratorit të UK Vau i Dejës, kundrejt ankuesit, kanë ardhur menjëherë pas emërimit të tij në detyrë dhe pas nisjes së procedurave të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, për largimin e punonjësve të cilët kishin bindje të kundërta politike me të. Bazuar sa më sipër, Komisioneri gjykon se largimi i punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës, të cilët kishin të ekspozuara bindjet e kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, ka ndikuar në veprimet e ndërmarra nga ana e Administratorit të UK Vau i Dejës.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike, Dega Vau i Dejës. Por jo detyrimisht trajtimi i padrejtë ndaj të cilit është ekspozuar ankuesi mund të vijë si pasojë e bindjeve politike. Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e UK Vau i Dejës, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet bindjeve politike si anëtar i Partisë Demokratike, për të cilin ankuesi pretendon diskriminim, dhe trajtimit të padrejtë.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se UK Vau i Dejës, deklaroi motivacione të pambështetura në prova e fakte, si dhe deklaroi shkaqe të tjera, të ndyshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar e aktivist i subjektit politik Partia Demokratike/Dega Vau i Dejës dhe faktit që UK Vau i Dejës, nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Komisioneri vlerësoi se nga ana e punëdhënësit, duhet të ishte marrë në konsideratë fakti që ankuesi kishte vetëm 1 vit për të plotësuar moshën e daljes në pension dhe njëherësh konstaton se UK Vau i Dejës, përveç afatit të parashikuar në Kontratën Individuale të Punës e dispozitat e Kodit të Punës, që garantojnë mbrojtjen e punëmarrësit për shkak të moshës, ka shkelur nenin 12 të LMD, duke diskriminuar subjektin ankues, pikërisht për këtë shkak.

Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara, pikërisht nga *mosha e bindjet politike* të ankuesit, dhe se atij i është cënuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e ushtrimit të profesionit.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, Z.Ll., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike dhe të moshës, *në formën e udhëzimit për diskriminim*, si dhe *në formën e diskriminimit ndërsektorial*, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës.

61. 36 familjet që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane të qytetit të Kavajës, të cilët përfaqësohen nga Shoqata “Drejtësi Sociale”, kundër Bashkisë Kavajë.

VENDIM NR. 126, DATË 20.06.2022

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë në formën e rëndë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Sanksion me gjobë/Në gjykatë

Konstatimin e diskriminimit për shkak të “racës”, “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, në formën e rëndë të tij, të familjeve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, banuese në godinën e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë dhe banesave rreth saj, nga ana Bashkisë Kavajë.

FAKTET

Disa familje që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane jetojnë në varfëri ekstreme dhe në kushte shumë të vështira jetese në lagjen Nr. 2, në godinat e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit (në kapanone) Kavajë. Shoqata “Drejtësi Sociale” ka sqaruar se këto familje janë zhvendosur nga banesat e tyre, për shkak se trojet, ku ishin ndërtuar këto banesa, i janë kthyer ish-pronarëve. Zhvendosja e tyre është kryer pas një marrëveshjeje me Bashkinë Kavajë, pjesë e së cilës ishte

edhe garantimi i furnizimit me energji elektrike nga ky institucion. Pala ankuese pretendon se prej disa ditësh, këtyre familjeve iu është ndërprerë energjia elektrike nga OSHEE sh.a., me arsyetimin se Bashkia Kavajë nuk mund të garantojë më furnizimin e tyre me energji elektrike. Në këto kushte, është kërkuar që familjet egjiptiane të lidhin kontrata individuale me OSHEE sh.a. Pala ankuese thekson faktin se ndërprerja e energjisë elektrike gjatë stinës së dimrit është jo normale dhe familjet që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane po kalojnë kohë tepër të vështira. Për sa më sipër, Shoqata “Drejtësi Sociale” thekson faktin se familjet që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, po diskriminohen për shkak të etnisë, duke mos u siguruar banim të përshtatshëm, sipas Ligjit Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, duke iu cënuar të drejtat themelore të njeriut. Këto familje kërkojnë të strehohen në banesa të përshtatshme, për të patur një jetë normale dhe dinjitoze, si dhe kërkojnë lidhjen e energjisë elektrike në godinat, ku jetojnë aktualisht.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.)
- Raporti i ECRI-i për Shqipërinë²¹, i datës 7 prill 2020
- Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (PKVBPPR) në Republikën e Shqipërisë (2021-2025),
- Plani Kombëtar i Integritimit European 2015-2020 dhe Udhërrëfytyesi për plotësimin e 5 Prioriteteve
- Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara
- Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar” .

KONKLUZIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i palës ankuese nga ana e Bashkisë Kavajë, pasi ky institucion ka reflektuar mosveprim, neglizhencë dhe pasivitet në marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm të familjeve egjiptiane, që jetojnë në godinën e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë, si dhe për zgjidhjen e në mënyrë sa më të përshtatshme çështjes së energjisë elektrike, për familjet që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, duke marrë masat e nevojshme dhe duke mbështetur financiarisht familjet egjiptiane që nuk kanë mundësi të përballojnë tarifën e lidhjes së shërbimit me OSHEE sh.a. Njëkohësisht, Bashkia Kavajë edhe pse ka patur dijeni mbi gjendjen ekonomike të këtyre familjeve, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk ka vepruar në zbatim të

²¹ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-ECRI-t-për-Shqipërinë.pdf>

kompetencave të saj për të zgjidhur problematikat respektive. Gjatë hetimit administrativ, është konsideruar si rrethanë rënduese për Bashkinë Kavajë edhe mosgarantimi i pagesës së energjisë elektrike, që ka sjellë si pasojë ndërprerjen e saj, për këto familje përgjatë muajit dhjetor 2021. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Bashkia Kavajë, me anë të mosveprimeve të saj, ka vendosur familjet egjiptiane para një situatë diskriminuese, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike. Për sa më sipër, KMD gjykoi se gjendja e rëndë e jetesës së familjeve egjiptiane, që banojnë në godinën e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë dhe banesave përreth, ka një kohëzgjatje disavjeçare, ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për to, si dhe diskriminimi është konsumuar për disa shkaqe të përcaktuara të nenin 1 të LMD-së, të ndryshuar. Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndaj grupit të ankuesve është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Bashkisë Kavajë, pasi përmbushen parashikimet e sipërcituara të nenit 3/1 të LMD-së, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit për shkak të “racës”, “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, në formën e rëndë të tij, të familjeve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, banuese në godinën e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë dhe banesave rreth saj, nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Kavajë të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, për secilën prej tyre, nëpërmjet programeve të strehimit, që ky institucion zbaton.
- Në referencë të pikës 2, të këtij vendimi, Bashkia Kavajë të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e investimeve provizore në infrastrukturën e godinës së ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë dhe banesave përreth saj, ku banojnë familjet egjiptiane, si dhe ndërtimin e kanalizimeve për ujrat e zeza, kryerjen e furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike.
- Brenda afatit ligjor 30 ditor, Bashkia Kavajë të dërgojë një plan veprimi për sistemimin e familjeve egjiptiane, që janë subjekte të kësaj ankese, ku të evidentohen masat e nevojshme, që ky institucion ka planifikuar për strehimin e tyre, përgjatë 12 muajve të ardhshëm, nëpërmjet programeve të strehimit që kjo bashki zbaton dhe do të zbatojë në muajt në vijim.

62. B.K., kundër Bashkisë Berat.

VENDIM NR. 147, DATË 21.07.2022

Shkaku: Shtatzënisë, mëmësisë²², bindjeve politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është larguar nga puna për shkak të bindjeve të saj politike, pasi është anëtare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim dhe shtatëzania e saj, pasi pozicioni i saj i punës është zënë gjatë periudhës kohore, që ajo ka qenë me leje lindje.

FAKTET

B.K., ka filluar punë në pozicionin e specialistes në Sektorin e Pronave dhe Strehimit pranë Bashkisë Berat. Në vijim, ankuesja është emëruar në pozicionin e punës specialist jurist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike.

Në vijim të disa ndryshimeve strukturore që Bashkia Berat ka pësuar ndër vite, ankuesja është konfirmuar në pozicione të ndryshme pune. Referuar strukturës së vitit 2019, për Bashkinë Berat, pavarësisht se në urdhërin e emërimit, pozicioni i saj i punës është specialist jurist në Sektorin e Planifikimit, Rekrutimit dhe Procedurave të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, emërtimi “specialist jurist” është lapsus i bërë në aktin e emërimit, pasi mbështetur në strukturën e sipërcituar nuk ka patur pozicion të tillë pune, por 2 (dy) pozicione pune me emërtesën “specialist të burimeve njerëzore”.

B.K. sqaron se nëpërmjet Vendimit Nr. 120, datë 21.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe të njëjësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat” është miratuar struktura organike për vitin 2020. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Juridike është ristrukturuar, duke ndryshuar emërtesë si Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Ristrukturimi nuk ka prekur numrin e specialistëve të Burimeve Njerëzore, po ka suprimuar pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Planifikimit, Rekrutimit dhe Procedurave në Shërbimin Civil.

Ankuesja informon se ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë për shkak të disa problemeve me shtatëzaninë. Nga data 20.01.2020 deri në datën 18.01.2021, ka qenë me raport barrë lindjeje. Në përfundim të lejes së barrë lindjes është rikthyer në punë dhe në të njëjtën ditë, Sekretarja e Përgjithshme pranë Bashkisë Berat e ka njoftuar për takim në zyrën e saj, ku i ka komunikuar verbalisht se do të lirohej nga detyra, pasi pozicioni i saj i punës është suprimuar në kuadër të ristrukturimit të institucionit. Ankuesja pretendon se ky komunikim është kryer ende para se Komisioni i Ristrukturimit të kishte shqyrtuar mundësinë e sistemimit të saj në një pozicion

²² Shkaku i mëmësisë u shtua në pretendimet e ankueses gjatë seancës dëgjimore;

tjetër vakant, si dhe në kushtet kur Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk kishte dhënë ende një vendimmarrje për rastin e saj.

Edhe pse pozicioni i saj është konsideruar i suprimuar nga Komisioni i Ristrukturimit, B.K., thekson faktin se në këtë pozicion është transferuar një punonjës tjetër i këtij institucioni. Në këto kushte, ajo pretendon se pozicioni i saj i punës nuk është suprimuar, por është zënë nga një punonjës tjetër, ndërkohë që ajo ka qenë me lejen e barrë lindjes. Ky emërim është kryer 5 (pesë) ditë para se ankuesja të kthehej në vendin e saj të mëparshëm të punës, nga leja e barrëlindjes.

Ankuesja shprehet se Komisioni i Ristrukturimit pranë Bashkisë Berat ka patur si detyrë të sistemojë punonjësit, pozicioni i punës së të cilëve është suprimuar si pasojë e ristrukturimit të strukturës së këtij institucioni. Pavarësisht se rasti i saj nuk përputhet me sa më sipër, ankuesja thekson faktin se Bashkia Berat ka patur si detyrim ta sistemojë në një tjetër pozicion pune vakant. Ajo sqaron se pranë këtij institucioni ka 4 (katër) pozicione të lira pune në kategorinë ekzekutive, përkatësisht në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Drejtorinë e Integritetit Europian dhe Planifikimit Strategjik, si dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurat. Nga ana e Komisionit të Ristrukturimit nuk është marrë në konsideratë fakti i sistemimit të saj në një nga këto pozicione.

B.K., pretendon se ka kryer ankim administrativ pranë Bashkisë Berat, e cila i ka kthyer përgjigje ankimit të saj duke e bërë me dije se pozicioni i saj i punës i është nënshtruar ristrukturimit.

Përveç sa më sipër, ankuesja pretendon gjithashtu se në vijim i është dërguar gjithashtu edhe Urdhëri “Për dhënie mase disiplinore nëpunësit civil”, nëpërmjet së cilit, ndaj saj është dhënë masa disiplinore “vërejtje” me motivacion “shkelje të rregullave të etikës në komunikim me kolegët”. Ankuesja sqaron se masa disiplinore është dhënë vetëm ndaj saj dhe një kolegeje tjetër dhe jo ndaj të gjithë punonjësve të përfshirë në mosmarrëveshje dhe debatin e ndodhur, që u bë shkak për masë disiplinore. B.K., pretendon se një masë e tillë ndaj saj është ndërmarrë, më qëllim që të pengohet konkurrimi i saj, për 2 vjet, në shërbimin civil.

Për sa më sipër, B.K., pretendon se shkak për largimin e saj nga puna ka qenë bindja e saj politike, pasi është anëtare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integritet dhe shtatëzania e saj, pasi pozicioni i saj i punës është zënë gjatë periudhës kohore, që ajo ka qenë me leje lindje.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (2014).
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të datës 27.11.2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të datës 05.07.2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”, të cilat synojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e gjinisë “femër”, sidomos në marrëdhëniet e punës.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj).

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës²³ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri gjykon se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nga ana e Bashkisë Berat, në cilësinë e punëdhënësit të saj.

Rezultoni se ankuesja i gëzon të dy shkaqet e mbrojtura, përkatësisht shtatëzanisë dhe mëmësisë. Argumentimi i Bashkisë Berat, se marrëdhëniet e punës me ankuesen, kanë përfunduar për shkak të shkurtimit të pozicionit të saj të punës nuk qëndron dhe është tërësisht i pabazuar ligjrisht. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se pozicioni i punës së ankueses nuk ishte suprimuar nga ristrukturimi i kryer nëpërmjet Vendimit Nr. 827, datë 15.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe të njëjstëve shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021”, pasi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk kishte pësuar suprimim të pozicioneve të punës dhe numri i specialistëve të burimeve njerëzore ishte i pandryshuar, përkatësisht dy të tillë. Njëkohësisht, KMD konstatoi se pozicioni i punës “specialist jurist” është i njëjtë me pozicionin e punës “specialist i burimeve njerëzore”, pasi pozicioni “specialist jurist” nuk ekzistonte as në strukturën e vitit 2019, të miratuar me Vendimin Nr. 925, datë 26.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Berat për vitin 2019”, në bazë të së cilës B.K., është emëruar, nëpërmjet Urdhërit Nr. 125, datë 07.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, në pozicionin “specialist jurist” në Sektorin e Planifikimit, Rekrutimit, Procedurave të Burimeve Njerëzore, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Juridike.

Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se nëpërmjet Urdhërit Nr. 20, datë 12.01.2021 “Për fillimin e marrëdhënieve financiare të punës së nëpunësit në shërbimin civil”, të Kryetarit të Bashkisë Berat, R.H., është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin specialist i burimeve njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, ndërkohë që vetëm disa ditë më pas B.K., e cila u kthye në punë nga leja e barrëlindjes, iu komunikua largimi nga puna për shkak të suprimimit të pozicionit të punës. Pozicioni i punës për emërimin e R.H., është liruar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës²⁴ me M.L.L., dhe transferimit të saj në një pozicion

²³ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

²⁴ M.L.L., është emëruar me lëvizje paralele në një pozicion tjetër në shërbimin civil, nëpërmjet Urdhërit Nr. 731, datë 23.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat.

tjetër pune në muajin tetor 2020. R.H., ka punuar më parë në pozicionin e punës së specialistit të burimeve njerëzore.

KMD ka konstatuar gjithashtu se ndërkohë që ankuesja ka qenë me leje barrë lindjeje dhe pozicioni tjetër i punës së specialistit të burimeve njerëzore ka qenë i zënë nga M.Ll., nëpërmjet Urdhërit Nr. 193, datë 30.03.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat është kryer transferimi i përhershëm i SH.P., në pozicionin specialist për burimet njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, fakt që dëshmon se pozicioni i ankueses është plotësuar që gjatë periudhës që ajo ka qenë me leje barrë lindjeje²⁵.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Bashkia Berat ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ky institucion ka marrë vendim për të larguar punëmarrësen, që gjatë periudhës së lejes së lindjes, pavarësisht se zbatimi *de jure* i këtij vendimi ka qenë menjëherë pas kthimit të saj në punë, fakt që sërisht është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërpërmendura dhe në kundërshtim me praktikën e GJED-së²⁶.

Gjithashtu rezultoi e provuar se ankuesja është anëtare e Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe aktiviste e saj, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e saj, politike dhe ekspozimin e tyre publikisht. Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit në dëm të subjektit ankues kanë ardhur menjëherë pas ardhjes në detyrë të Kryetarit të Bashkisë Berat, pas zgjedhjeve të vitit 2019. Kryetari i Bashkisë Berat, E.D., është përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë, e cila aktualisht është subjekti politik në pushtet, ndërkohë që ankuesja, sikurse edhe bashkëjetuesi dhe vëllai i saj janë anëtarë dhe aktivistë të Lëvizja Socialiste për Integrim, subjekt ky që aktualisht nuk është në aleancë me partinë në pushtet.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues është diskriminuar, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të shtatëzanisë dhe mëmësisë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit për shkak të shtatëzanisë, mëmësisë dhe bindjeve politike, në formën e diskriminimit të shumëfishtë, të B.K., nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Berat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer B.K., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

²⁵ N.M., bija e ankueses B.K., ka lindur në datën 22.02.2020;

²⁶ Case 0460/06 Nadine Paquay v Société d'architectes Hoet + Minne SPRL;

63. M.N., kundër Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit të Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 216, DATË 12.12.2022

Shkaku: Bindjet politike dhe çdo shkak tjetër (ankimi në gjykatë)
Forma: Diskriminim ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

M.N., ka qënë në marrëdhënie pune pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Komsumatorit, Bashkia Tiranë, dhe i janë ndërprerë për shkak të bindjes politike dhe ankimit në gjykatë.

FAKTET

M.N., në vitin 2012 është emëruar në pozicionin si specialist në AMK. Pas largimit nga puna në vitin 2013, është emëruar sërish në detyrën e specialistit në vitin 2015.

Në vitin 2021, nga Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore të AMK-së, është mbajtur procesverbali, lidhur me kontrollin e ushtruar në terren, në të cilin është konstatuar se punonjësi M.N., nuk ishte prezent në vendin e punës. Në këtë procesverbal është propozuar marrja e masës disiplinore “Vërejtje” për mungesë gjatë orarit të punës, mosnjofimit të përgjegjësit të sektorit dhe mungesës së etikës në komunikim.

Në vijim, AMK ka urdhëruar marrjen e masës disiplinore “Vërejtje” për punonjësën M.N., me arsyetimin: *“Nuk ka qenë prezent në vendin e punës sipas planit përkatës të punës duke mosnjofuar përgjegjësin e sektorit dhe mungesë etike në komunikim”*.

Në vitin 2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të Transportit Publik dhe Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore të AMK-së, është mbajtur procesverbali, lidhur me kontrollin e ushtruar në terren, në të cilin është konstatuar se punonjësi M.N., nuk ishte prezent në vendin e punës me grupin përkatës dhe nuk kishte njoftuar eprorin përkatës për arsyen e lëvizjes.

Më pas, AMK ka urdhëruar marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësën M.N., me arsyetimin: *“Nuk ka qenë në vendin e punës sipas planit përkatës, duke mosnjofuar përgjegjësin e sektorit për arsyen e lëvizjes”*.

Një muaj më vonë, nga Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të Transportit Publik të AMK-së, është mbajtur procesverbali, në të cilin është përshkruar se: *“M.N., është paraqitur në zyrën e burimeve njerëzore për të tërhequr një vërtetim në të cilin kërkonte kriteret për tu bërë specialist me kategorinë III-b, gjë e cila nuk i takon pasi në dosjen e tij figurojnë 2 masa disiplinore, njëra masë me Nr. 215, datë 21.12.2021 “Vërejtje” dhe masa tjetër me nr. 73, datë 21.02.2022 “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”. Pasi i është bërë komunikimi, M.N., e ka grisur shkresën me nr. 874/1, datë 09.03.2022 dhe ka ofenduar përgjegjësen e sektorit të burimeve njerëzore duke përdorur termin “idiote” dhe specialistët e zyrës duke bërtitur me ton të lartë zëri, kjo një sjellje e përsëritur disa herë. M.N., ka thyer kodin e etikës duke ushtruar dhunë verbale. Këtë sjellje e ka bërë dhe kundrejt përgjegjësit të Sektorit të*

Kontrollit të Shërbimeve të Transportit Publik. Bazuar në ligjin për rregullat e etikës në administratën publike, kërkoj marrjen e masave disiplinore sipas legjislacionit në fuqi”.

Përsa më lart, AMK ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me M.N., me arsyetimin se ka thyer kodin e etikës së komunikimit, nëpërmjet ushtrimit të dhunës verbale kundrejt eprorëve dhe kolegëve të tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”,
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,
- Ligjit Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;
- Vendimit Nr. 10, datë 12.10.2011 të Këshillit Bashkiak Tiranë “*Për krijimin e AMK pranë Bashkisë Tiranë*”;
- Gjykata Kushtetuese, Vendimi Nr. 69, datë 16.10.2000, Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015.

KONKLUZIONE

Në bazë të provave të administruara, si dhe kronologjisë së ngjarjeve dhe fakteve rezulton se: Ankuesi ka paraqitur Kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar, detyrimin e të paditurit (AMK) ti paguajë paditësit (M.N) diferencën mbi pagë, 10 mijë lekë, si specialist i parë i trajnuar.

AMK ka marrë dijeni për padinë e ankuesit.

Në kronologjinë e ngjarjeve të ndodhura pas paraqitjes së ankimit në gjykatën e apelit nga M.N., rezulton se pasojat ndaj ankuesit janë përshkallëzuar duke i dhënë masën “*paralajmërim për largim nga puna*” dhe më vonë, pasi ka kërkuar kriteret e kalimit në kategori më të lartë page, ka ardhur masa e largimit nga puna. Pra rezulton se masat disiplinore ndaj ankuesit janë marrë në një periudhë të shkurtër kohore (tri muaj) dhe përkohë me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë dhe ankimit të M.N., në shkallën e dytë.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, AMK, jo vetëm që nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike dhe

ankimit në gjykatë, por ky subjekt, mbajti një qëndrim nënvlerësues, duke mos paraqitur shpjegimet apo informacionin dhe dokumentacionin që i'u kërkua zyrtarisht nga Komisioneri.

Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e AMK, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin M.N., mbeten shkaqet e diskriminimit të pretenduara, pra bindjet politike dhe ankimi në gjykatë.

Në rastin konkret bindjet politike dhe ankimi në gjykatë përbëjnë shkaqe diskriminuese për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi AMK ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit nuk është bërë për shkak të bindjeve politike dhe ankimit në gjykatë ose se largimi është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkak i bindjes politike dhe ai i ankimit në gjykatë, kanë bashkëvepruar me njëri tjetrin, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuar, duke bërë që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm e i pabarabartë i ankuesit, të lidhet drejtpërdrejtë me këto shkaqe të tij.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka diskriminuar ankuesin M.N., në të drejtën e tij për punësim, pasi dhënia e masave disiplinore dhe zgjidhja e kontratës së punës nuk ka ndodhur bazuar në shkak të ligjshëm, por për shkak të bindjeve politike dhe ankimit në gjykatë të punëdhënësit.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit, të ankuesit M.N., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike dhe ankimit në gjykatë të punëdhënësit, në formën e diskriminimit ndërsektorial, nga ana e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë.
- Në referim të pikës 1, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

XII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË

64. F.K., kundër Universitetit të Mjekësisë Tiranë

VENDIM NR. 79, DATË 26.04.2022

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë

Forma: Diskriminim i tërthortë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka konkuruar për pozicionin e punës vakant “Personel Akademik” në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Onkologji, në Fakultetin të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe është vendosur në pozita diskriminuese për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

FAKTET

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Onkologjik (Shërbimi i Onkologjisë) të QSUT-së, ka kërkuar nga ana e Departamentit të Kirurgjisë shtimin e strukturës me personel akademik.

Pas kërkesës së Shërbimit të Onkologjisë dhe miratimit nga ana e Departamentit të Kirurgjisë, nga ana e Fakultetit të Mjekësisë, janë përcjellë për miratim tek Rektori i UMT-së kriteret për 1 (një) vend personel akademik, në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;

Rektori i UMT-së, ka miratuar kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve dhe dokumentacionin përkatës për pozicionin e punës vakant “personel akademik” në lëndën Onkologji, në Departamentin e Kirurgjisë, ku ndër kriteret specifike është kërkuar që kandidati: “... 2. Të ketë eksperiencë pune në Onkologji mbi 15 vite; ...”;

Me shkresë, Rektori i UMT-së ka përcjellë për publikim në Agjencinë e Prokurimeve Publike (në vijim APP), kriteret e punësimit për 1 (një) vend personel akademik, në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Referuar njoftimit të bërë në faqen e APP, është shpallur pozicioni vakant për 1 (një) vend personel akademik, në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;

Kandidatja, F.K., pasi është vënë në dijeni të këtij njoftimi të publikuar në Buletinin e Prokurimeve Publike, fillimisht ka paraqitur një kërkesë/ankesë për diskriminim drejtuar Rektorit të UMT-së, pasi ka konsideruar si diskriminues kriterin specifik “Të ketë eksperiencë pune në Onkologji mbi 15 vite”. Brenda afateve të përcaktuara në njoftimin e bërë, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj dhe dokumentacionin përkatës, si kandidate për pozicionin vakant të publikuar;

Në vijim, Rektori i UMT-së i ka përcjellë ankesën e F.K., Fakultetit të Mjekësisë dhe Departamentit të Kirurgjisë, duke i kërkuar të trajtohet dhe të përcillet informacioni, mbi arsyet të cilat justifikojnë vendosjen e këtij kriteri për këtë pozicion pune;

Në vijim me Urdhër të Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, është ngritur Komisioni Ad-hoc për punësimin e personelit akademik në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Onkologji në Fakultetin e Mjekësisë, UMT;

Kandidatja, F.K., ka paraqitur një kërkesë drejtuar Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, për vënie në dijeni të Anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e dosjeve për Personel Akademik, lidhur me kërkesën e mëparshme për diskriminim për shkak të moshës, drejtuar Rektorit të UMT-së;

Në vijim, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Kandidaturave për Personel Akademik, i është drejtuar Rektorit dhe për dijeni Drejtorisë Juridike të UMT-së, duke i kërkuar interpretim juridik për vijimësinë e procedurave të konkurimit, duke iu referuar ankesës së F. K.

Rektori i UMT-së, i është drejtuar Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë dhe Departamentit të Kirurgjisë, duke e vënë në dijeni të ankesës së F.K., si dhe duke i kërkuar *informacion mbi arsyet e vendosjes së kriterit specifik të kontestuar*;

Në përgjigje përsa më lart, Departamenti i Kirurgjisë i është drejtuar Rektorit të UMT-së me duke i sqaruar se *ka konsideruar kërkesat e Shërbimit të Onkologjisë lidhur me kriteret e vendosura për vendin vakant*;

Më pas, Rektori i UMT-së i është drejtuar, Fakultetit të Mjekësisë, Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit Ad-Hoc dhe Departamentit të Kirurgjisë, duke i kërkuar vijimin me procedurat e vlerësimit për rekrutimin e personelit akademik në Departamentin e Kirurgjisë për lëndën e Onkologjisë, në Fakultetin e Mjekësisë të UMT-së me qëllim përfundimin e këtij procesi;

Nga Procesverbali i Komisionit Ad-hoc, rezulton se në konkurim për vendin e lirë punës për personel akademik në Departamentin e Kirurgjisë, lënda Onkologji, në Fakultetin e Mjekësisë të UMT-së, kanë qënë 6 (gjashtë) kandidat, nga të cilët asnjë prej tyre nuk plotësoi kriteret e publikuara në Buletinin e APP-së, përkatësisht:

- Dr. A.P., Nuk ka në dosje vërtetim për mësimdhënie;
- Dr. E.Ç., Nuk ka në dosje vërtetim për mësimdhënie;
- Dr. A.P., Nuk ka në dosje vërtetim për mësimdhënie;
- Dr. E.K., Nuk ka në dosje vërtetim për mësimdhënie;
- Dr. F.K., Nuk plotëson kriterin specifik nr. 2 të APP-së (15 vite eksperiencë pune në Onkologji);
- Dr. O.S., Nuk plotëson kriterin e mesatares së ponderuar. Mesatarja e Ponderuar 7.37 nga 8 sipas Statutit të UMT-së.

Fakulteti i Mjekësisë, ka përcjellë pranë Rektoratit të UMT-së, Procesverbalin e sipërcituar, nëpërmjet të cilit ka njoftuar se për këtë procedurë konkurimi nuk ka patur asnjë kandidat të kualifikuar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;

- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”;
- Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë;
- Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë Tiranë;
- Rregullorja e Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me Miratuar me Vendimin Nr. 88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik të UMT-së.

KONKLUZIONE

Nga analiza e bërë, Komisioneri konstatoi se:

nuk rezultoi në asnjë moment të jetë kërkuar nga ana e Spitalit Onkologjik (Shërbimi i Onkologjisë) të QSUT-së që kandidatët për vendin vakant për personel akademik në Departamentin e Kirurgjisë të kenë 15 vite eksperiencë pune në Onkologji;

Departamenti i Kirurgjisë, nuk ka vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë akt, procesverbal apo dokumentacion tjetër, në të cilin të citohen arsyet të cilat kanë çuar në vendosjen e kriterit që kandidati të ketë eksperiencë pune në Onkologji mbi 15 vite;

në njoftimin për shpalljen e konkursit për vend të lirë pune, për personel akademik në Departamentin e Kirurgjisë, në Fakultetin e Mjekësisë, nuk rezultoi të jetë përcaktuar cikli për të cilën kërkohet të angazhohet personeli akademik;

nuk rezultoi që në asnjë nga aktet ligjore apo nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës së personelit akademik në UMT, të përcaktohet se në procesin e mësimdhënies në të tre ciklet e studimit të kërkohet angazhimi i një personeli akademik me përvojë pune në shërbimin përkatës me një eksperiencë më shumë se 10 (dhjetë) vite;

nuk rezultoi që edhe në strukturat drejtuese të njësisë kryesore apo njësisë bazë të kërkohet një përvojë pune më shumë se 10 (dhjetë) vite;

UMT dhe Fakulteti i Mjekësisë, nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim dhe nuk kanë vendosur të njëjtat kriteret për pozicione të tjera të ngjashme për personel akademik të publikuara më parë, si në rastin konkret.

Sa më sipër Komisioneri vlerësoi se vendosja e kriterit specifik të *eksperiencës në punë në Onkologji mbi 15 vite*, nuk është proporcional në raport me qëllimin e synuar/nevojën për vendosjen e tij, nga ana e Fakultetit të Mjekësisë dhe Departamentit të Kirurgjisë, të Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Si pasojë vendosja e tij vlerësohet si diskriminues.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankuesja dhe *grupi i specializantëve që kanë përfunduar ciklin e Studimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, Programi i Studimit Onkologji, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë*, në të cilin ajo bën pjesë, diskriminohen në mënyrë të tërthortë për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, përmes vendosjes së kriterit specifik që kandidatët duhet të kenë *eksperiencë në punë në Onkologji mbi 15 vite*, duke sjellë skualifikimin e menjëhershëm të tyre nga konkurimi.

KMD gjykoj që praktika e rekrutimit e ndjekur nga strukturat e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që në momentin e hartimit të kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Kirurgjisë dhe miratimit nga ana e Rektorit të UMT-së, vendos në pozita diskriminuese ankuesen për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të tërthortë, i ankuses F.K., në të drejtën për punësim, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.



KONTAKTE:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Tiranë

Adresa: Rruga "Durrësit" Nr.27, 1001, Tiranë

Tel: + 355 4 243 1078

web: www.kmd.al

e-mail: info@kmd.al

Zyra Rajonale e KMD në Shkodër

Adresa: Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1. Në godinën e Bashkisë Shkodër, (Kati II).

Kodi Postar: 4001

Mob: +355 67 449 6586

Zyra Rajonale e KMD në Korçë

Adresa: Pranë Ish Bashkisë Korçë, Rr:28 Nentori, Nr.1

Kodi Postar: 7001

Tel: +355 69 620 7371

Zyra Rajonale e KMD në Fier

Adresa: Rruga "Ramiz Aranitasi". Në godinën e Këshillit të Qarkut Fier, (Kati 1).

Kodi Postar: 9301

Mob: +355 69 516 1864

NUMRI JESHIL: PA PAGESË

08000606